



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën administrative - territoriale

PROCESVERBAL

Tiranë, më 7.4.2026, ora 14:00

Drejton mbledhjen:

Arbjan Mazniku – bashkëkryetar i Komisionit

Luçiano Boçi – bashkëkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datës 11 dhe 25 mars 2026.
2. Seancë dëgjimore me ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, zotin Ervin Demo, për t'u njohur me gjendjen e pushtetit vendor dhe sfidat e tij.
3. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Arbjan Mazniku, Luçiano Boçi, Damian Gjikhuri, Romina Kuko, Ermal Elezi, Jorida Tabaku, Bledion Nallbati, Xhelal Mziu, Ramadan Likaj, Enno Bozdo Klevis Jahaj, Edmond Haxhinasto, Vangjel Dule, Etleva Budini, Aulona Bylykbashi, Agron Malaj, Igli Cara dhe Artan Luku.

Mungojnë:

Blendi Klosi, Ermal Pacaj, Klevis Jahaj dhe Marjana Koçeku.

Të ftuar:

Ervin Demo - ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor

Silvana Merdani - drejtor i kabinetit të ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor

Aida Gjika - këshilltar

Mariel Frroku - këshilltar

Stiljan Llavdaniti - këshilltar

HAPET MBLEDHJA

Arbjan Mazniku - Të nderuar anëtarë të komisionit, duke ju falënderuar për prezencën, fillojmë mbledhjen e radhës së komisionit, me këtë rend dite: miratimi i procesverbalit të datave 11 dhe 25 mars të vitit 2026. Procesverbalet janë ndarë tashmë nga sekretariati. Nëse nuk ka komente për procesverbalet, mund t'i miratojmë, dhe të kalojmë pastaj te pika e dytë.

A ka ndonjë koment, sugjerim apo shqetësim për procesverbalet? Nuk ka.

Miratohen.

Pika e dytë e rendit të ditës është seancë dëgjimore me ministrin e Shteti për Pushtetin Vendor, zotin Demon, në lidhje me një kërkesë, e cila, siç jeni në dijeni, të të gjithë anëtarëve, në fakt, por me fokus të veçantë të anëtarëve të opozitës, për të kuptuar situatën, gjendjen, rezultatet, ecuritë, sfidat që ka pushteti vendor.

Jemi dakordësuar me bashkëkryetarin, që, pasi ministri të bëjë një prezantim, të kemi një seancë pyetjesh nga secili prej grupeve në komision dhe pastaj përgjigjet e ministrit për secilën prej pyetjeve.

Luçiano Boçi – Të nderuar anëtarë, ju përshëndes!

Zoti ministër, mirë se keni ardhur!

E fillojmë këtë seancë dëgjimore me vetëdijen e plotë që reforma territoriale nuk është një çështje teknike, as një ushtrim i izoluar i riformatimit të një harte të caktuar, por ka të bëjë drejtpërdrejtë me mënyrën si përfaqësohen qytetarët, me mënyrën si u shërbehet atyre, dhe me mënyrën si realizohet demokracia lokale në Shqipëri. Për këtë arsye unë mendoj se kjo reformë nuk duhet të jetë një vendimmarrje e mbyllur në zyrat e qeverisë, as një proces i parapërcaktuar politik, i cili në fund fare kërkon vulën e institucioneve, midis tyre të komisionit tonë, apo të opinionit publik.

Vijmë në këtë reformë, të themi, pas 10 vjetësh të të bërit të një reforme tjetër. Në fakt, ne kemi gjykuar, prandaj e kemi kërkuar këtë dëgjuesë, që më e ndershme për një qeveri është që, para se të nxjerrë variantet e reformës, së pari, të ndërtojë një dëgjuesë dhe një bilanc të modelit ekzistues dhe t'u japë përgjigje disa pyetjeve: a u afrua pushteti me qytetarin, apo u largua? A u krijua diskriminimi midis bashkive? A u rrit autonomia vendore, apo u rrit varësia qendrore? Pa u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, unë mendoj se kjo reformë nuk do të jetë reformë, por thjesht përsëritje e gabimeve në një format të ri.

Prandaj, sot është shumë e rëndësishme, që ne, si anëtarë të komisionit, por jo vetëm ne, edhe qytetarët, edhe opinionit publik presim njëllonj sqarimi për disa shtylla kryesore, midis

të cilave mendoj se më kryesoret janë: cila është analiza që çoi në këtë konkluzion, në bërjen e një reforme, pra analiza administrative, demografike, analizë e funksioneve, që na çoi pikërisht në këtë reformë? Pyetja tjetër është: cili është objektivi kryesor i kësaj reforme, të rrisë autonominë e pushtetit vendor, apo të rikonfigurojë varësinë edhe një herë tjetër nga pushteti qendror?

Meqenëse kemi dhe përfaqësuesit e qeverisë, unë dua të di a ka konsultime, a janë bërë konsultime me bashkitë, me ekspertët, me grupet e interesit për të arritur në kërkesën për një reformë? Cilat janë garancitë për të respektuar në këtë proces parimet kushtetuese të decentralizimit, të autonomisë dhe të pjesëmarrjes në demokracinë e qeverisjes lokale.

Këto janë arsyet që na shtynë ne që dëgjesat t'i nisim nga Kuvendi dhe me ministrin e Pushtetit Vendor.

Nëse nuk ka ndërhyrje të tjera, po ia kalojmë fjalën zotit Demo.

Ervin Demo - Faleminderit!

Në fakt, u parashtruan disa pyetje. Unë do të mundohem t'i përmbahem një prezantimi të përmbledhur të asaj që ne kemi evidentuar si situatë, sidomos duke marrë në konsideratë reformën e 10 vjetëve të fundit. Ne kemi sjellë disa materiale, që besoj do të jenë me vlerë për komisionin.

Është kënaqësi të jem me të gjithë ju, të nderuar anëtarë të komisionit të posaçëm! Patjetër, unë vij si një koleg juaji, por në të njëjtën kohë edhe si partner në këtë proces. Komisioni i posaçëm është një organ, i cili do të trajtojë atë që në fund do të ketë dhe një produkt të caktuar, por nuk diskutohet që ministria e Shtetit për Pushtetin Vendor, përveçse është partnere gjatë këtij procesi, mbi të gjitha, ka përgjegjësinë e madhe që, cilido të jetë produkti, më pas ai duhet përkthyer jo thjesht nga pikëpamja e kornizës ligjore, por, mbi të gjitha, e implementimit në territor.

Gjithsesi, siç e përmenda pak më parë, ne kemi një mori materialesh, që besoj se do të jenë me vlerë për komisionin. Unë nuk dua të ndalem në shumë detaje, sepse, siç mund ta shikoni edhe vetë, vetëm materiali i fundit për sa i përket matjes së performancës në vitin 2024 është shumë voluminoz. Unë mendoj se ka të dhëna me shumë vlerë për atë që ne do të flasim sot, dhe patjetër punën në vazhdimësi të vetë komisionit. Po ashtu kemi dhe raportin për sa i përket matjes së performancës për vitin 2023. Janë dy vite, ku një analizë e thelluar falë edhe bashkëpunimit të AMVV-së me partnerët ndërkombëtarë, besoj se jep një panoramë shumë të qartë të asaj që është duke ndodhur në territor, duke iu referuar sidomos reformës, që është implementuar në vitin 2015.

Unë do të mundohem që gjatë këtij diskutimi të parë të përmend shtyllat kryesore për sa i përket reformës së fundit, që Parlamenti ka kaluar në vitin 2014, pasi është implementuar edhe në territor, duke iu referuar një analize që përfshin: organizimin territorial, decentralizimin funksional dhe kuadrin ligjor, si dhe performacën në qytete dhe në fshat. Në vitet '90-'92 janë krijuar rrethet nga 26 në 36, më pas janë përfshirë 12 qarqe, ku ka pasur 12 qarqe, 65 bashki dhe 390 komuna dhe më pas reforma e 2014-ës, që është edhe sot në fuqi, bëri 61 bashki dhe 12 qarqe. Ky është një rrugëtim, nëse e shikojmë nga pikëpamja skematike, që ka një lloj përputhje për sa i përket mënyrës se si është organizuar territori gjatë këtyre dekadave.

Unë besoj se është për t'u nënvizuar fakti që, nëse ne i referohemi një dekade më pas, ne tashmë kemi një pasqyrë të qartë mbi atë që ka funksionuar dhe ku duhet të ketë përmirësime të domosdoshme.

Reforma e vitit 2015, siç e përmenda më parë, krijoi një konsolidim të hartës territoriale, krijoi një zgjerim të funksioneve vendore, ku u shtuan 7 funksione bazë për bashkitë. Ne besojmë se, nga të dhënat që kemi, dhe unë do të ndalem më pas, përmirësoi mirëqeverisjen vendore dhe krijoi kushtet e duhura për të pasur një mirëmenaxhim dhe të bazuar mbi performancën.

Sot ne kemi një sistem vendor, i cili funksionon, dhe kjo është falë edhe pozitivitetit që vetë reforma solli. Duke thënë këtë, ne kemi kushte, të cilat tashmë kanë ndryshuar pas 10 vjetësh, dhe janë kushte që janë të pamohueshme, duke filluar që nga lëvizja demografike ose ndryshimet demografike në tërësi; kemi një territor që në vetvete, sfidat që sot ballafaqohet janë ndryshe, nga ato që mund të kenë qenë 10 vjet më parë, aq më tepër ajo që ne mund të eidentojmë si sfida që do të kemi në vitet e mëpasshme janë të atilla, të cilat detyrimisht kërkojnë një përmirësim të të gjithë sistemit që ne kemi në nivel vendor.

Nëse unë mund të përmend vetëm një pjesë të treguesve financiarë, që qartazi treguan se reforma pati një efekt pozitiv, dhe pastaj do të ndalemi në disa prej efekteve, që mbase nuk janë përkthyer, siç duhet në territor. Të ardhurat vendore në krahasim me vitin 2015 janë rritur me 166%. Këto janë të ardhura që vetë bashkitë gjenerojnë në nivel lokal. Pesha në buxhet e të ardhurave vendore, po ashtu është rritur nga 36% në 51%, si mesatare kombëtare. Investimet për frymë janë rritur në 78% dhe detyrimet e prapambetura, të cilat u trashëguan në vitin 2015, janë ulur nga 12 miliardë lekë, që ishte për të gjitha bashkitë në vend me 3,2 miliardë lekë. Kjo është falë edhe performancës financiare, që vetë bashkitë kanë, por edhe mbështetjes financiare, që u është dhënë bashkive nga buxheti qendror.

Në aspektin territorial, ne kemi eliminuar fragmentimin formal, por barazitë janë shumë të theksuara në nivel lokal midis bashkive. Në decentralizimin funksional, pushteti vendor tashmë ka 41 funksione, siç përmenda më parë, 7 prej tyre janë kaluar bashkive në reformën e fundit, por jo gjithmonë të shoqëruara me kapacitete njerëzore, shpeshherë mbase edhe me paqartësi ligjore. Në decentralizimin financiar progresi është i dukshëm, siç përmenda edhe të dhënat pak më lart, por problematike mbetet varësia nga transfertat e buxhetit qendror dhe kapacitetet e kufizuara nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik.

Kuptohet, këto kufizime janë më të dukshme për bashkitë më të vogla, dhe ne do të kemi tregues, të cilët e tregojnë qartazi këtë problematikë në nivelin lokal. Në 10 vjetët e fundit analiza, e cila është bërë për tre dimensionet që unë përmenda pak më parë: riorganizimin territorial, decentralizimi dhe performanca e shërbimeve mirëqeverisëse rezultatet, duke iu referuar dhe asaj që përmenda është eliminimi i copëtimit territorial, duke siguruar bashkitë që janë më të mëdha, më të krahasueshme dhe më të afta për të funksionuar. Ne kemi një rritje të impaktit në territor përmes fuqisë financiare, të ardhurat kundrejt produktit të brendshëm bruto janë rritur nga 0,82% në 1,37%, këto janë të ardhura që gjenerohen nga vetë bashkitë dhe shpenzimet, po ashtu, janë rritur nga 2,4% në 3,2%, gjë që tregon edhe peshën e rëndësishme që kanë bashkitë sa i përket ekonomisë së vendit në tërësi.

Riorganizimi territorial nuk e ka zgjidhur pabarazinë e kapaciteteve. Madhësia e bashkive vazhdon të ndikojë ndjeshëm në performancë, ku, qartazi, bashkitë që janë mbi 50 mijë banorë, janë mbi mesataren kombëtare, dhe bashkitë, të cilat janë nën 50 mijë banorë, përgjithësisht, për shumicën e treguesve të matur, janë nën mesataren. Kjo lidhet automatikisht me vetë potencialin që kanë bashkitë, qoftë për të gjeneruar të ardhura lokale, qoftë për të pasur potencial zhvillimi ekonomik, aq më tepër për të pasur kapacitetet e duhura, për të ndërtuar strategji të qarta sa i përket zhvillimit të territorit.

Reforma uli fragmentimin formal, por nuk e eliminoi plotësisht fragmentimin funksional. Disa bashki mbeten shumë të vogla për të qenë eficiente në përdorimin e ekonomisë së shkallës.

Sa i përket pikëpamjes së kuadrit ligjor, Shqipëria tashmë ka ndërtuar një bazë ligjore të avancuar. Raporti i Këshillit të Europës evidenton se Shqipëria i përmbush kërkesat e nenit 2 të Kartës Europiane për vetëqeverisjen vendore; ka të harmonizuar 80% të legjisllacionit të pushtetit vendor dhe, po ashtu, edhe krijimin e mekanizmave të dialogut, siç ishte prezantimi i këshillit konsultativ, i cili është një organ ku të gjithë aktorët janë të përfaqësuar si në nivel vendor, ashtu edhe në nivel qendror, por edhe aktorë apo *stakeholder*-at e tjerë, të cilët janë të rëndësishëm sa u përket proceseve në nivel lokal.

Sa i përket decentralizimit funksional dhe kuadrit ligjor, pra nevojës për ndërhyrje, mendojmë se zbatimi i kuadrit ligjor në tërësi duhet parë me përparësi dhe shërbimet që ushtrohen si përgjegjësi të përbashkëta me qeverinë qendrore, patjetër, kanë nevojë për t'u mbajtur në fokus për një qartësim të mëtejshëm sa i përket kuadrit ligjor.

Gjithashtu, kemi ndërtuar një kuadër ligjor, i cili është i avancuar edhe nga pikëpamja e decentralizimit, por sfida e dekadës së dytë është ta kthejmë decentralizimin nga një akt ose nga një formë normative, në atë që jep realisht produkt lokal, që të jetë më funksional.

Besoj se, nëse i referohemi mirëqeverisjes vendore, duke e krahasuar me mesataren sa i përket performancës së shërbimeve në nivel lokal, 47% e bashkive të vogla në këto 10 vjet, kanë sfida të theksuara sa i përket nivelit të shërbimeve; 64% e bashkive me 10 deri në 50 mijë banorë e kanë akoma edhe më të theksuar një pjesë të madhe të shërbimeve dhe, kuptohet, bashkitë më të mëdha, në nivelin e shërbimeve lokale, kanë një performancë më të lartë.

Ndërkohë, një tregues i rëndësishëm për pushtetin vendor në tërësi (kuptohet, kjo edhe falë shumë nismave që kanë të bëjnë edhe partnerët), është rritja e transparencës lokale, ku mbi 91% e vendimeve tashmë publikohen *online* dhe 88% e konsultimeve publike realizohen të hapura për publikun e gjerë.

Sa u përket disa treguesve kryesorë të funksioneve bazë që ne kemi në nivel vendor, duke filluar me arsimin parashkollor, çerdhet, me raportin që kemi, fëmijë- mësues, shërbimet sociale, strehimin social, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen nga zjarri, pyjet dhe kullotat e të tjera me radhë, qartazi evidentohet se, duke u nisur edhe nga ajo që u përmend më lart, sa më e madhe të jetë bashkia, ka mbulim më të madh në territor, raporte më të mira sa u përket raporteve në krahasim me treguesit e Bashkimit Europian, ndërkohë që, vetvetiu, bashki më të vogla kanë sfida më të mëdha, sidomos për të ofruar disa prej shërbimeve bazë në nivel vendor.

Këtu do të doja ta riktheja vëmendjen, ne do të kemi edhe pyetjet, por besoj se është e rëndësishme për komisionin (ne kemi sjellë të gjithë materialin), sepse, sa i përket sidomos raportit të matjes së performancës për vitin 2024, i cili merr një mori treguesish në konsideratë, duke iu referuar qoftë raporteve kombëtare, por edhe krahasimeve midis bashkive, është me shumë vlerë për ecurinë e punës në këtë komision.

Nevojat për ndërhyrje janë që nga garantimi i standardeve të njëjta me shërbimet në të gjithë territorin. Unë besoj se është e rëndësishme, për vetë faktin se çdo qytetar, pavarësisht qytetit apo zonës ku ai jeton, duhet të ketë akses të barabartë dhe, patjetër, akses në shërbime cilësore.

Sa u takon përcaktimit të standardeve minimale të funksioneve, besoj se është e domosdoshme që bashkitë të kenë një standard kombëtar për shërbimet bazë, të cilat ofrohen në nivel lokal, si dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe financiare për secilin shërbim.

Te kapacitetet njerëzore do të doja të nënvizoja faktin që sot ne duhet ta pranojmë që, në territor, tashmë është një sfidë për bashkitë sa i përket rekrutimit të burimeve njerëzore me arritjet dhe konsolidimin personal, të cilat u ofrojnë vetë bashkive mundësi zhvillimore dhe aq më tepër rritjen e cilësisë së shërbimeve. Ky është një fakt i pamohueshëm. Kuptohet që, për bashkitë, të cilat janë më të thella në territor, pra mbulojnë një pjesë të vogël të territorit dhe kanë një popullsi të vogël, kjo është një sfidë, e cila tashmë është kthyer në një nga pengesat kryesore sa u përket ofrimit të shërbimeve në nivel vendor.

Sa i përket progresit të mirëqeverisjes dhe matjes së performancës, shërbimet nuk kanë ende uniformitet dhe qytetarët nuk marrin një standard vetëm se jetojnë në bashki me kapacitete të ndryshme.

Duk vlerësuar edhe studimet që kanë bërë OECD-ja dhe BE-ja, apo SIGMA në tërësi, theksojmë se sfida kryesore mbetet kapaciteti administrativ dhe garantimi i standardeve të njëjta të shërbimeve. Besoj se kjo është një ndër elementet kryesore që duhet marrë në konsideratë për çdo analizë që ne bëjmë në kuadër të reformës, për të garantuar jo thjesht shërbime më të mira, por shërbime që ofrohen me një standard unik në të gjithë territorin.

Disa prej sfidave që duhen adresuar në kuadër të reformës

Besojmë se, së pari, zhvillimi ekonomik lokal, ku bashkitë më të vogla kanë kapacitete të kufizuara për të gjeneruar rritje, është një faktor i cili duhet marrë në konsideratë sa i përket asaj çfarë bashkitë sot duhet të kenë si prioritet, që është rritja e mirëqenies në nivel lokal, duke e garantuar këtë jo thjesht duke ofruar shërbime më të mira, por edhe duke pasur një strategji të qartë sa i përket zhvillimit ekonomik lokal.

Sa i përket modernizimit të qeverisjes, digjitalizimi dhe standardet nuk janë të njëjta në të gjithë territorin, kjo edhe për shkak të investimeve kapitale që duhen sa i përket digjitalizimit të shërbimeve. Në këtë kontekst, ne jemi duke marrë iniciativa që të jemi pranë bashkive sa i takon digjitalizimit të të gjitha shërbimeve lokale.

Sa i përket performancës së shërbimeve, secila bashki duhet të sigurojë standard minimal kombëtar për të gjithë qytetarët në të gjithë territorin. Po ashtu, sa u takon kapaciteteve njerëzore vendore, bashkitë duhet të arrijnë të ndërtojnë ekspertizë të qëndrueshme edhe në kuadër të sfidave që parashikon vetë integrimi europian.

Besoj se këto janë katër pikat, të cilat janë shumë të rëndësishme, sa i përket objektivit ose misionit të këtij komisioni.

Sa u përket raporteve që përmenda më parë, si nga Komisioni Europian, OECD-ja, SIGMA dhe Këshilli i Europës, po ashtu, edhe raportet që janë prodhuar nga institucionet vendase, besoj fort se i mbështesin qartazi, duke i marrë shërbimet një nga një, por duke parë në të njëjtën kohë edhe problemet strukturore që vetë bashkitë kanë, evidentojnë qartazi nevojën e një rishikimi të situatës në territor dhe, patjetër, duke krijuar mundësi të reja sa u përket bashkive, në mënyrë që të kapin atë çfarë është qëllimi i përbashkët i të gjithë anëtarëve të komisionit sa u përket shërbimeve më të mira vendore dhe zhvillimit ekonomik lokal në të gjithë territorin.

Për pikën që lidhet me Bashkimin Europian, besoj se është një sfidë e pamohueshme, sepse, sa më shumë avancojmë në proceset integruese të Shqipërisë, kuptohet që përgjegjësia dhe detyrimet që do të lindin për bashkitë në tërësi, do të jenë shumë e madhe. Rreth 70% e *acquis*-së në tërësi impakton direkt ose indirekt pushtetit vendor. Agjenda që ne kemi sa i takon procesit të integritimit, e cila është një agjendë ambicioze, patjetër, do të kërkojë, në nivel lokal, institucione të përgatitura me të gjitha kapacitetet e duhura për të absorbuar detyrimet dhe përgjegjësitë e reja që lindin si rrjedhojë e reformës.

Besoj se kjo është një ndër shtyllat që duhet pasur në fokus sa i përket mënyrës se si do të operojnë bashkitë nesër në territor, aq më shumë, kur flasim për mundësinë e fondeve, të cilat do të jenë të aksesueshme për bashkitë në vend, në kontekstin e resurseve të domosdoshme për të aplikuar dhe për të plotësuar standardet e kërkuara nga Bashkimi Europian, duke filluar me fondin e kohezionit, por jo vetëm.

Besoj se pyetjet do të jenë më të detajuara. Nuk dua t'ju marrë shumë kohë, por besoj se një bashkëbisedim do të ishte më i vlefshëm për të gjithë anëtarët, aq më tepër që vetë kryetari e filloi me shumë pyetje, që në hapje të seancës.

Arbjan Mazniku – Zoti ministër, shumë faleminderit për prezantimin e qartë!

Mendoj të bëjmë një proces në të cilin të kemi pyetje nga secila prej palëve. Siç e kemi zakon, unë ia jap fjalën zonjës Tabaku, dhe më pas zoti Boçi ua jep fjalën anëtarëve tanë.

Zonja Tabaku, fjala për ju.

Jorida Tabaku – Faleminderit, kryetar!

Së pari, i uroj suksese komisionit, pasi kjo është mbledhja e parë reale që po bëjmë, pas shumë muajsh pritjeje për të pasur diskutime!

Më vjen mirë që e kemi nisur me një analizë të situatës ku jemi dhe se çfarë ka prodhuar reforma e 10 vjetëve më parë.

Nga analiza që bëri ministri, në fakt, më erdhi mirë që e pranoi vetë se reforma e vitit 2015 nuk ka ofruar maksimumin për qytetarët, dhe këtu po përdor një fjalë diplomatike, sepse, në gjykimin tonë, ka akoma edhe më shumë probleme.

Ju iu referuat një raport monitorimi të Këshillit të Europës për sa i përket një analize, që është kryer nga bashkëreporterët për Shqipërinë. Disa nga elementet, që unë i kam lexuar, ju përmendët një pjesë pozitive, që janë problematike janë të dhënat financiare, burimet financiare, të cilat nuk janë përmbushur, financimi nuk përputhet me detyrat, nga ana tjetër, ka probleme shumë të mëdha për sa i përket autonomisë reale, rolit real të pushtetit vendor. Të tria këto elemente i konsideron si problematike.

Në një sërë të dhënash, që ju përmendët dhe në një sërë analizash që ju kryet, pavarësisht se të ardhurat e pushtetit vendor janë rritur, nga pothuajse 32 miliardë, kanë shkuar në 64 miliardë, 45% e këtyre të ardhurave vazhdojnë të vijnë nga transfertat e qeverisë qendrore, dhe vetëm 10 bashki e plotësojnë kriterin që 50% e tyre duhet të vijnë nga të ardhurat e veta. Në gjykimin tuaj, si mund të zgjidhet, edhe me një model të ri të një reforme territoriale, ky problem, ku vetëm 10 bashki e kanë këtë kriter, edhe sipas ndarjes aktuale? Vetëm po e quajtmë Shqipërinë një bashki, unë mendoj se mund t'i plotësojmë kriteret minimale.

Së dyti, një nga kritikant kryesore që kishte përpara reformës të vitit 2015 ishin shpenzimet e administratës, shpenzimet e personelit, të dhëna që lidheshin me një reformë, që do t'u kursente qytetarëve shqiptarë 60 deri në 80 milionë euro. Kush ka qenë atëherë, e mban mend fjalinë "60 deri në 80 milionë euro", e cila u bë në çdo diskutim në Parlament. Sot shpenzimet e personelit janë rritur me 142% në periudhën 2014-2022, ndërkohë që shpenzimet kapitale janë rritur vetëm me 4%. Në gjykimin tuaj, cila ka qenë problematika që qeveria shqiptare ka dështuar që të rrisë shpenzimet kapitale, ndërkohë që janë rritur shpenzimet e personelit?

Ervin Demo – Mos është më mirë t'i bëjmë pyetjet një nga një, sepse po bëhen shumë.

Jorida Tabaku – Mund t'i grupojmë bashkë, por si ta gjykoni. Kryetarët e dinë.

Në vitin 2010 rreth 83% e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat përktheheshin në investime, ndërkohë që sot janë 37% e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat që shkojnë në investime. Cila ka qenë problematika që nuk kanë shkuar të ardhurat nga taksat dhe tatimet në investime?

Luçiano Boçi – Zoti ministër, mund të japësh përgjigje për këto pyetje, që u parashtruan dhe më pas të vazhdojë Jorida me grupin tjetër të pyetjeve.

Ervin Demo – I kërkoj ndjesë koleges nëse më shpëton diçka. Jam shumë i hapur për të ma rikujtuar.

Për sa u përket raporteve, edhe gjatë prezantimit unë e bëra të qartë që ne nuk kemi uniformitet të territorit për sa i përket performancës së bashkive. E rëndësishme është të kuptohet pse nuk e kemi këtë uniformitet për sa i përket performancës së bashkive, qoftë financiare, qoftë nga pikëpamja e cilësisë së shërbimeve që ofrohen në nivel vendor. Unë besoj se ky është një ndër treguesit që shpeshherë do të evidentohet në momentin kur ne do ta bëjmë këtë analizë terriroresh, patjetër do të jetë edhe përmasa apo shkalla e ekonomisë që bashkia ka për sa u përket mundësive për të gjeneruar të ardhura dhe për të krijuar një model të zhvillimit ekonomik.

Është e vërtetë që në territor kemi bashki që, jo vetëm të ardhurat e tyre, por edhe një pjesë e transfertës së pakushtëzuar, i përdorin për fondin e pagave, ky është realitet, nuk është në të gjitha bashkitë, por përgjithësisht është në bashkitë e vogla.

Për sa i përket rritjes së shpenzimeve për burimet njerëzore, unë besoj se duhen marrë edhe dy momente në konsideratë: e para, funksionet e reja detyrimisht kanë kërkuar që bashkitë të shtojnë personel, pastaj mund të diskutojmë se sa e arrirë është performanca që ne presim nga burimet që janë shtuar në nivel vendor, por, nëse bashkitë shtojnë shërbime në territor, patjetër që do të punësojnë individë, të cilët duhet t'i ofrojnë këto shërbime ose, nëse funksione të caktuara janë deleguar, patjetër do të kërkohet që ato të shoqërohen me burime njerëzore.

Ndërkohë, në territor evidentohet që bashkitë që e kanë rritur në mënyrë agresive kapacitetin e burimeve njerëzore, arrijnë të mbulojnë të gjithë territorin me shërbime, por ka edhe raste kur bashkitë, të cilat kanë tentuar t'i rrisin kapacitetet e burimeve njerëzore, përsëri nuk arrijnë dot të ofrojnë shërbimet bazë, si: menaxhimi i mbetjeve, apo të mbulojnë të gjithë territorin që kanë në administrim. Këto raste janë evidentuar qartë edhe në raportet e partnerëve ndërkombëtarë, por edhe të vetë institucioneve, si AMVV-ja për sa i përket një disbalance të performancës në territor, duke filluar jo thjesht nga pikëpamja financiare, por edhe nga pikëpamja e shërbimeve në nivel vendor.

Unë mendoj se pikat që zonja Tabaku ngriti, me të drejtë, janë argumente, që shkojnë për një analizë që duhet bërë për sa i përket gjendjes që ne kemi sot në territor. Në të njëjtën kohë unë besoj fort se nuk mund të ketë reformë territoriale pa bërë një analizë të detajuar të të gjitha funksioneve që kanë bashkitë. Jam dakord që sot në territor ne kemi funksione, që bashkitë mund t'i kenë të deleguara ose nga pikëpamja rregullative i kanë përgjegjësi të tyre, por, për arsye të mungesës së kapaciteteve, që mund të jenë financiare dhe jo vetëm, ato nuk arrijnë t'i ushtrjnë këto funksione. Në të njëjtën kohë sfida që një pjesë e bashkive kanë, sidomos për sa përket cilësisë së burimeve njerëzore, është një ndër faktorët e mungesës së performancës në nivel vendor.

Në të njëjtën kohë ka pasur disa qasje nga Parlamenti për sa i takon një analize të reformës territoriale të vitit 2014-2015, kjo është e dyta, dhe vetë fakti që ne kemi 2 momente kur janë ngritur komisione për reformën territoriale, qartazi tregon nevojën për një analizë të thelluar dhe rishikim të saj. Unë besoj se nuk ka reforma perfekte. Tashmë ka kaluar një dekadë dhe, me kalimin e dekadës, është krejt normale që kushtet kanë ndryshuar, por edhe vetë reforma ka hapësirat e saj për të qenë më e përshtatshme për panoramën në territor.

Luçiano Boçi – Po, zonja Tabaku.

Jorida Tabaku – I ngrita këta tregues për faktin se kanë qenë baza e të gjithë retorikës që ju keni kryer 10 vjet më parë, të cilat do të përmirësoheshin. Sot ndodhemi para faktit që këto nuk janë përmirësuar, përkundrazi, janë përkeqësuar. Tani ju po presupozoni që do të ndryshohet dhe do të krijohet një reformë tjetër, bazuar mbi po të njëjtin model, sepse po të njëjtat justifikime po jepni edhe tani. Me të njëjtin model që dështoi një herë, që i solli të ardhurat në këtë nivel, tani thuhet që do të ngrihet përsëri një reformë tjetër dhe presim një rezultat ndryshe, sepse herën e parë nuk e arritët, e provuat për 10 vjet dhe tani do ta provoni për së dyti.

Në rrafshin administrativ, reforma e ka ulur numrin e bashkive nga 373 në 61, me argumentin se kjo do të përmirësonte shërbimet dhe do ta afronte qytetarin me administratën. Në pjesën më të madhe, nga të dhënat që kemi, qytetarët sot raportojnë më pak shërbime dhe më shumë burokraci. A keni një analizë tuajën për sa i përket askesit në shërbime, përvojën e deritanishme? Si ka qenë nga pikëpamja e territorit? A keni një analizë të matshme për shërbimet publike, për kohën mesatare të udhëtimit, për shpërndarjen territoriale të shërbimeve për 61 bashkitë që kemi sot?

Në mungesë të kësaj analize, sepse Parlamenti ka analizat e veta, kurse ju keni ardhur këtu si përfaqësues i qeverisë, jo të na thoni se çfarë ka bërë Komisioni i mëparshëm i Reformës Territoriale, a keni një analizë për sa i takon rolit të njësive administrative? Çfarë kompetencash kanë ata? Çfarë përgjegjësish kanë në territor? Çfarë buxhetesh kanë? Në gjykimin tonë ato janë thjesht zgjatime, delegime të pushtetit qendror në terren. A e pranoni këtë si një problem, që kishte modeli aktual, që ju keni ndjekur, por edhe faktin që sot njësitë administrative nuk përfaqësojnë vullnetin e qytetarëve në terren?

Mund të vazhdoni me këtë grup pyetjesh, pastaj vazhdojmë me disa të tjera.

Ervin Demo – Së pari, treguesit që ju përmendët qartazi janë përmirësuar, janë një mori treguesish. Nëse ne i marrim këta tregues në tërësi, është krejtësisht e qartë që situata e nivelit vendor sot është shumë më mirë se në vitin 2014, dhe ky është fakt. A duhet të jemi të kënaqur me këtë? Absolutisht, jo, sepse, nëse do të ishim të kënaqur, nuk ka nevojë që të diskutojmë se

çfarë mund të përmirësohet. A ka vend për përmirësim? Absolutisht, po. Unë nuk do të doja kurrë t'i referohesha punës që bën Kuvendi, por besoj se është e rëndësishme qasja që duhet të kemi, dhe, bazuar në të dhënat dhe treguesit e 10 vjetëve të fundit, duhet të jetë e tillë që, nëse ka hapësira për përmirësim, cilado që të jetë... Ne nuk po vijmë këtu me një formulë që do ta rregullojmë në këtë lloj mënyre, por unë besoj te puna e komisionit dhe besoj se komisioni do të jetë gjithëpërfshirës dhe procesi në vetvete duhet të nxjerrë se cilat janë modelet që ne të mund t'u japim përgjigje disa sfidave me të cilat përballemi.

Unë sot, si përfaqësues i qeverisë, kam ardhur për të ofruar informacion për sa i përket sistemit që ne kemi sot në territor, duke iu referuar studimeve dhe raporteve të ndryshme, të cilat do t'ju vihen në dispozicion, jo thjesht të partnerëve ndërkombëtarë, sepse ne kemi institucione si AMVV-ja, e cila ka prodhuar gjatë gjithë kohës, duke iu referuar disa prej elementeve që ju përmendët, në mënyrë të detajuar të gjitha funksionet dhe të gjitha shërbimet në nivel lokal për sa i përket asaj që ofrojnë bashkitë.

Ajo që do të doja të nënvijëzoja për sa i përket aksesit të shërbimeve, unë e preka pak a shumë, do të ishte shumë voluminoze, nëse në këtë moment do t'i merrnim të gjitha bashkitë me radhë, sepse raporti që kemi, i merr të gjitha bashkitë një për një. Përmbledhja që u mundova t'i ofroja komisionit, ishte pikërisht ajo që përmenda pak më parë, pra ajo çfarë ne e identifikojmë në shumicën e problematikave që hasim në nivel vendor, përgjithësisht ka të bëjë edhe me kapacitetet që bashkitë kanë, duke filluar që nga numri i popullsisë dhe territori që ato mbulojnë, mundësitë financiare që ato kanë, të cilat, rrjedhimisht, përkthehen më pas në problematika në nivel lokal.

Për sa u përket njësive administrative, mendoj se, patjetër, ka hapësirë, ku edhe njësitet administrative duhen fuqizuar dhe mund të fuqizohen. Kjo nuk do të thotë që detyrimisht të kalojnë në struktura *rigide*, qoftë nga pikëpamja e buxhetimit e të tjera me radhë, por edhe me kuadrin ligjor që kanë sot bashkitë, pse jo, duke parë edhe mundësi të tjera për t'u dhënë hapësira të tjera njësive administrative, mund të krijohet në territor kapaciteti në njësitet administrative, ku disa prej shërbimeve të jenë më pranë qytetarit. Kjo është një çështje që duhet marrë në konsideratë dhe nuk ka asnjë lloj kompleksi nga ana jonë për ta diskutuar këtë.

Arbjan Mazniku – Po, zonja Tabaku.

Jorida Tabaku – Unë besoj, zoti Demo, se, kur flasim si ekonomistë, flasim edhe me shifra, se kur thuhet se janë rritur shpenzimet për personelin me 143% dhe për investime vetëm 4%, kjo nuk do të thotë se janë përmirësuar, se mua më duket përkeqësim. Bëra disa pyetje cilësore dhe mora një përgjigje të përgjithshme, pra nuk besoj se u sqarua ndonjëri prej kolegëve.

Pjesa më e madhe e të dhënave që ju prezantuat, kanë një problem shumë të madh, sepse janë në nivel bashkie ose në nivel qarku, pra nuk ka asnjë të dhënë në nivel njësie administrative dhe nuk ka asnjë të dhënë që na tregon pabarazinë, sepse për këto të dhëna kemi nevojë që të marrim vendime, për të parë pabarazitë.

Ju folët gjatë për zhvillimin ekonomik, për pabarazinë ekonomike, njëkohësisht, folët gjatë edhe për mekanizmat që duhet të ishin ngritur, por edhe për procesin e integritit, në fakt.

Tani, prej 3 vjetësh ekziston ligji për të zgjidhur çështjet e pabarazisë territoriale. A ka marrë ndonjë vendim qeveria shqiptare apo Këshilli i Ministrave për këtë? A është zbatuar ndonjëherë ky ligj, se po bëhemi gati për të bërë ndryshime, edhe për të propozuar modelet e reja, pa parë ende në terren, nëse janë zbutur pabarazitë ekonomike lokale? A kemi sot më pak pabarazi, sepse e ndryshuat modelin e pushtetit vendor? A keni ndonjë analizë nga pikëpamja e pabarazive?

Së dyti, është fakt se Tirana prodhon një të tretën e të ardhurave (e thoni ju, por edhe pjesa më e madhe e informacioneve që kemi), si dhe pjesën më të madhe të burimeve. A kemi një sistem të decentralizuar apo kemi vetëm një sistem të përqendruar në disa bashki të mëdha? Me logjikën që ju keni, me modelin që doni të ndërtoni, nëse reflektojmë të dhënat dhe nëse zbatojmë parimet që ju thoni, atëherë i bie që Shqipëria ka nevojë vetëm për tri bashki. Për asnjë nga pyetjet që ju bëra pak më parë, për sa i përket afërsisë së shërbimit, cilësisë së shërbimit dhe administratorëve të deleguar në pushtetin vendor, nuk mora përgjigje, por ndoshta mund ta kemi përgjigjen tek informacioni që ju do të sillni.

Gjithashtu, përmendët edhe transferimin e kompetencave të bashkitë. Pjesa më e madhe e këtyre kompetencave (kush është deputet i vjetër në Parlament, e di) nuk është e shoqëruar me burime financiare dhe me burime njerëzore. Më vjen keq t'ju korrigjoj, por rritja me 40 mijë e numrit të punonjësve në bashki, nuk vjen, në asnjë rast, si rezultat i delegimit të kompetencave, sepse vjen edhe si krahasim... për shembull, le të marrim arsimin ose ujitjen dhe kullimin, ku pjesa më e madhe e këtyre kompetencave janë deleguar nga viti në vit, sipas buxheteve që kanë kaluar në Parlament, pa buxhetin real. Si e shpjegoni këtë? Në fakt, kjo është një anomali, por a nuk bie ndesh edhe me parimet e decentralizimit? Cili është koncepti juaj për delegimin e kompetencave? Cilat kompetenca mendoni se duhen lënë në nivel rajoni, në nivel bashkie dhe më pas në nivelin më të afërt lokal? A keni një analizë të kompetencave?

Ju dëgjova të thoshit se ka pothuajse 41 funksione, si dhe për prezantimin në lidhje me përgjegjësitë e funksionet e përbashkëta. A keni bërë një ndarje të përgjegjësisë, sepse sot, të jemi realistë, qarqet nuk kanë as buxhetin, as kompetencat dhe nuk kanë të decentralizuar as përgjegjësinë për të kryer funksionet e tyre?

Një nga objektivat kryesorë që kishte reforma territoriale e vitit 2015, ishte ndalimi i boshatisjes së zonave rurale dhe krijimi i zhvillimit të balancuar territorial, ndërkohë që emigrimi i brendshëm ka vazhduar, të dhënat e INSTAT-it janë shqetësuese për ne, si opozitë, dhe besoj se juve, si qeveri, nuk duhet t'ju zërë gjumi nga këto të dhëna. A është ky një tregues se modeli aktual, që ju propozuat, ka dështuar për ta ndalur emigrimin, për të krijuar zhvillim ekonomik në secilën prej këtyre bashkive dhe për t'i bërë ato pole me të vërtetë tërheqëse të investimeve të huaja?

Për sa i përket dimensionit rajonal, ju jeni njëkohësisht edhe negociatori i Kapitullit 22, për bashkëpunimin rajonal. Në fakt, kam nevojë për pak informacione se ku ndodhemi sa u përket negociatave, për cilin model të NUTS-it është duke shkuar qeveria shqiptare? A përputhet kjo, jo vetëm me punën e këtij komisioni, por edhe me të dhënat që ju keni, si ministër, për sa i përket funksionit dhe rolit që kanë rajonet?

Ervin Demo – Janë shumë pika, por do të mundohem t'i rikujtoj të gjitha.

Së pari, për sa i përket Kapitullit 22, ne jemi në fazën e ndërtimit jo thjesht të planit përfundimtar të punës, duke rakorduar me të gjitha institucionet dhe në bashkëpunimin me komisionin, por, në të njëjtën kohë, edhe me propozimin dhe qëndrimin që do të ketë Shqipëria sa i përket Kapitullit 22. Ky nuk është momenti për t'i publikë informacionet, por besoj se shumë shpejt do të ketë një qëndrim publik dhe zyrtar të Shqipërisë, aq më shumë kur jemi në fazë diskutimesh me komisionin.

U ngritën shumë çështje.

Së pari, nuk po prezantoj një model të caktuar për sa i përket reformës ose formës që duhet të marrë reforma, sepse besoj se i takon komisionit për ta diskutuar këtë gjë. Nuk ka një qëndrim nga ana e qeverisë, që reforma duhet të ketë formë ose këtë format.

Komisioni ka disa muaj që është konstituar dhe besoj se vetë procesi që duhet ndjekur nga komisioni është evidentimi i problematikave dhe, patjetër, komisioni duhet të diskutojë se cilat mund të jenë zgjidhjet për to. Ajo çfarë do të bëjmë gjatë gjithë rrugëtimit, është mbështetja me sa më shumë informacione dhe me çdo të dhënë tjetër që është e domosdoshme për komisionin, për të arritur një vendimmarrje sa më të shëndetshme.

Pra, dua ta nënvizoj këtë fakt, që nuk po prezantojmë një model të formës që duhet të ketë reforma, këtu jemi për të përmendur disa fakte dhe disa analiza, të cilat janë evidentuar ndër vite, jo tani, që janë publike, të cilat, patjetër, do të ishte me vlerë që edhe komisioni t'i kishte në dispozicion.

Për sa i përket rritjes së numrit të punonjësve, duke iu referuar edhe eksperiencës sime në nivel vendor, duhet të kuptojmë se rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore në territor,

nuk lidhet detyrimisht me funksione të reja, por me fuqizimin e disa funksioneve. Për shembull, nëse një bashki, për një shërbim që e ka ushtruar në territor me palë të treta, vendos ta ofrojë vetë, me kapacitetet e veta, detyrimisht duhet të rrisë personelin. Edhe sot, bashki të ndryshme, disa prej shërbimeve në territor kanë zgjedhur t'i ofrojnë vetë dhe janë "detyruar" të krijojnë struktura të reja, për të ofruar shërbime të caktuara, si: pastrimi, ushqimi për sistemin parashkollor apo funksione të ndryshme. Pra, kur merren vendime të tilla nga bashkitë, do të shoqërohen me rritje të personelit; nuk ua delegojnë më këto shërbime palëve të treta, nëpërmjet procedurave të prokurimit, por i ofrojnë vetë dhe, në momentin kur e bëjnë këtë, janë të detyruara të ngrenë një strukturë të tërë, të re, për të ofruar këto shërbime. Në këtë kontekst e kisha pak më parë, pra rritja e numrit të personelit duhet parë rast pas rasti. Ne mund të bëjmë një analizë, për të parë nëse ajo rritje, në një bashki të caktuar, ka sjellë efektet e duhura në rritjen e cilësisë së shërbimit apo në zgjerimin e shërbimit në të gjithë territorin, e të tjera me radhë.

Për funksionet që u janë deleguar bashkive, shtatë funksionet që u përmendën pak më parë, financimi nga qeveria qendrore kundrejt bashkive është shtuar me 10 miliardë lekë. Nëse u referohemi treguesve të tjerë financiarë, për sa u përket të ardhurave vendore, janë të gjithë pozitivë, në këndvështrimin e 10 viteve të fundit, qoftë të ardhurave si peshë specifike me PPB-në, por edhe duke marrë në konsideratë të gjithë buxhetin që bashkitë administrojnë sot.

Jorida Tabaku – Si mund të konsiderohet i qëndrueshëm një model ekonomik, kur rritja e të ardhurave vendore nuk vjen nga zgjerimi ekonomik lokal...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe dy pyetje kam dhe përfundova.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të them të drejtën, nuk mora asnjë përgjigje, me gjithë bashkëbisedimin e këndshëm me ministrin.

Si mund të konsiderohet një model ekonomik i qëndrueshëm, kur baza e të ardhurave nuk vjen nga zgjerimi i aktivitetit ekonomik lokal ose nga një bazë e qëndrueshme tatimore, por vjen vetëm nga një e ardhur e paqëndrueshme në të paktën 10 bashki të tilla.

Taksa e infrastrukturës ka pasur një rritje të të ardhurave nga 9% në 41%. Ndërkohë, taksa e ndikimit në infrastrukturë, si dhe pesha e taksave normale të pronës kanë pësuar një rënie, duke kaluar nga 25% në nivelin 15%-16%. Si mendoni se mund të ofroni një model? Çfarë modeli mund të ofrohet për ta kompensuar këtë? E ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë do të ndalet për disa vite, pasi unë nuk besoj se Shqipëria do të vazhdojë të mbetet

përjetësisht një ekonomi e tullës dhe e llaçit. Mendoj se do të kemi një model ekonomik që do të prodhojë diçka, sepse sot nuk po prodhon.

Së fundi, të gjithë këta tregues, së bashku me të dhënat financiare që ne kemi, por edhe me ato që ndoshta ju do të na i vini në dispozicion, na çojnë në tri elemente të përbashkëta.

Së pari, çdo reformë territoriale duhet të ketë të paktën afërsinë e shërbimeve me qytetarin, përfaqësimin e rritur dhe një bazë të qëndrueshme financiare. Të tria këto elemente, që në momentin e krijimit të reformës, por edhe sot, janë me deficienca. Cili është modeli që ju mendoni se mund t'i zgjidhë këto tri probleme? Ju kam dëgjuar me shumë interes në daljet tuaja publike, ku thoni se konsolidimi nga 61 bashki në një numër më të vogël, do t'i zgjidhë këto tri probleme, pasi këto janë tri shtyllat që mbajnë një reformë territoriale në këmbë.

Faleminderit!

Ervin Demo – Së pari, për sa i përket vlerësimit të përgjigjeve, unë besoj se është relative dhe mendoj se u kam dhënë përgjigje pyetjeve tuaja. Megjithatë, kur flasim për modelin ekonomik, kuptohet që vetë bashkitë në territor kanë ndërtuar modele ekonomike si rrjedhojë e specifikave që bashki të ndryshme kanë. Është e vërtetë që për disa bashki taksa e infrastrukturës zë një peshë më të madhe, ndërsa për disa të tjera ajo ka një peshë shumë modeste.

Ajo që mund të diskutojmë për të ardhmen është, gjithashtu, relative, sepse unë besoj se bashkitë që kanë kapacitetet e duhura, kanë edhe mundësitë e duhura për t'u adaptuar me kushtet e reja që ka territori nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik. Ne nuk mund të ndërtojmë ose të bëjmë ndërhyrje në reformë duke marrë parasysh çdo supozim për zhvillimin ekonomik që mund të ndodhë pas 10 vjetësh. Ne i referohemi faktit dhe u referohemi të dhënave që kemi sot, sepse mund të kemi ndryshime teknologjike pas 10 vjetësh, që nuk mund t'i parashikojmë dot sot. Si mund të bëjmë reformën? Prandaj, unë besoj se ka mundësi në territor, siç është taksa e pasurisë, dhe ju me të drejtë e ngrini atë. Në fakt, taksa e pasurisë është rritur, dhe më vitin 2026 taksa e pasurisë në nivel vendor do të ketë peshën më të madhe që ka pasur gjatë 10 vjetëve të fundit. Kjo është edhe falë një sistemi të ri që është ngritur, sidomos me mbështetjen e partnerëve suedezë, për të bërë një ndërthurje të sistemeve që kanë bashkitë në nivel vendor me ato të Agjencisë së Kadastrës, me ASHK-në, në mënyrë që të kemi një rritje të efikasitetit të mbledhjes së taksës së pasurisë.

Besoj se bashkitë në territor kanë mundësi të ndryshme për të krijuar kapacitete të reja financiare, jo vetëm për të gjeneruar më shumë të ardhura, por edhe për të përmirësuar shërbimet.

Unë nuk do të doja të mbaja një qëndrim për modelin, dhe do të mundohem ta nënvizoj këtë fakt. Nëse do të kishim një model të konsoliduar, unë besoj se do të ishte e paarsyeshme përballë komisionit. Besoj se komisioni i ka të gjithë mundësitë, jo vetëm nga pikëpamja formale për të ndërtuar reformën, por, mbi të gjitha, për të ndërtuar një proces, ku të gjithë të kenë zë dhe ne, patjetër, të kemi një sistem sa më të konsoliduar, pavarësisht se cili do të jetë konkluzioni që vetë komisioni do të marrë.

Faleminderit!

Luçiano Boçi – Atëherë, vazhdojmë me pyetje nga pjesa e mazhorancës.

Fjala për zonjën Kuko.

Romina Kuko – Faleminderit, kryetar!

Ministër faleminderit për prezantimin tuaj!

Unë do të doja t'ju bëja disa pyetje shkurt, por që besoj se do të na jepni një përgjigje shteruese. Ministria juaj ka filluar prej dy vjetësh punën për matjen e performancës së bashkive, duke u bazuar në disa indikatorë të rëndësishëm, që prekin fushat e financës, burimeve njerëzore dhe shërbimeve kryesore që bashkitë ofrojnë. Sipas jush, cilat janë gjetjet kryesore që ju keni konstatuar nga raportet e performancës? A ka dallime mes bashkive të mëdha, atyre të mesme dhe të vogla?

Do të doja gjithashtu që këtë përgjigje ta lidhni edhe me eksperiencën tuaj si ish-kryetar bashkie, për të parë nëse gjetjet e raportit të performancës përkojnë me eksperiencën tuaj, si një bashki që ka treguar një efikasitet të lartë. Gjithashtu, mbi kapacitetet e bashkive të vogla, ju i përmendët ato, dhe gjithashtu kolegja Tabaku e përmendi; jemi të vetëdijshëm që disa bashki të vogla kanë staf teknik shumë të kufizuar, mungojnë inxhinierët, urbanistët, juristët, arkitektët.

Raporti i performancës tregon se në bashkitë e vogla ka 4 zjarrfikës për 1 500 banorë, ndërsa në ato me mbi 50 mijë banorë ka vetëm 0,6. Si e sheh qeveria mundësinë që bashkitë e vogla të ofrojnë shërbime me standard të njëjtë, pa pasur masën kritike të stafit profesional? Kjo më çon në pyetjen tjetër lidhur me standardet kombëtare. Pra, një nga kriteret shumë të rëndësishme të Kapitullit 22 ka të bëjë me standardet kombëtare në pushtetin vendor, duke filluar që nga mënyra e urbanizimit deri te stafi i funksioneve të caktuara. Në çfarë përqindjeje kemi sot standarde kombëtare të vendosura në pushtetin vendor? Duke u kthyer sërish te bashkitë me stafe teknike shumë të kufizuar, sidomos ato të vogla, a mendoni se është momenti për të riparë sistemin e pagave në nivel vendor?

Deri tani ne kemi një sistem. ku bashkitë e vogla kanë paga më të ulëta e kështu me radhë, pasi pagat rriten në mënyrë progresive. sipas madhësisë së bashkive, dhe kjo ndoshta ka

shkaktuar mungesën e stafit. A mendoni, në pikëpamjen tuaj, se duhet të kemi paga standarde për pushtetin vendor, edhe për t'i inkurajuar profesionistët e mirë dhe me nivel të lartë, si: arkitektë, juristë, inxhinierë, që të kontribuojnë në vendin e tyre, pa u diskriminuar në lidhje me numrin e banorëve të bashkisë përkatëse?

Faleminderit!

Ervin Demo – Faleminderit!

Siç e përmenda edhe më parë, vetë sistemi i matjes së performancës tashmë ka krijuar një bazë të detajuar informacioni për sa i përket situatës në bashki. Nëse do ta përmbledhja atë çfarë qartazi evidentohet në këtë raport, së pari, performanca rritet me madhësinë e bashkive, dhe ky është fakt. Bashkitë e mëdha, patjetër, kanë kapacitete më të konsoliduara për sa i përket ndërtimit të modeleve të qëndrueshme të zhvillimit ekonomik lokal, por, mbi të gjitha, edhe për të ofruar shërbime cilësore në territor.

Ju e përmendët me të drejtë, një ndër faktorët që i bën bashkitë e vogla të vuajnë për sa i përket nivelit të performancës që ato kanë, është kufizimi në burime njerëzore. Kur flasim për kufizim, e kemi fjalën sidomos për sa u përket burimeve njerëzore cilësore, ato që mbulojnë detyra specifike në nivel vendor, siç mund të jetë planifikimi urban, kapacitetet e zyrave të projektimit e të tjera me radhë. Ky është një fakt, që evidentohet qartësisht në nivel vendor.

Për pagat, ka pasur një rritje të fundit që u bë për sa i përket pushtetit vendor, por pati një ngushtim, po e quajmë, të nivelit të pagave mes bashkive, që janë kategori të ndryshme. Gjithsesi, unë besoj se edhe qasja e qeverisë është që administrata të trajtohet më mirë financiarisht, dhe kjo do të ishte absolutisht e mirëpritur në nivel vendor nga ana e bashkive. Por, unë besoj se disa prej problematikave janë strukturore, nuk mund të adresohen thjesht me rritje page, sidomos kur flasim për ato problematika që hasen në bashki të caktuara me kapacitete shumë të kufizuara, ose me territore të kufizuara, ose me numër popullsie shumë të vogël.

Duke iu referuar eksperiencës personale si ish-kryetar bashkie, por edhe duke e diskutuar me shumë ish-kolegë të mi, që kanë qenë kryetarë bashkie, disa prej të cilëve janë prezentë sot, kuptohet që situata në territor është komplekse dhe bashkitë përballen me sfida të ndryshme, aq më tepër me presione për sa u përket zhvillimeve, qofshin ato në nivel makro, që janë realisht sfiduese për bashkitë. Besoj se ajo çfarë evidentohet lehtësisht në territor është mungesa e kapaciteteve në disa bashki të caktuara, sidomos kur flasim për madhësinë e tyre, e cila shpeshherë i bën ato që një pjesë e madhe e këtyre sfidave të jenë shumë të vështira për t'u adresuar, qoftë për shkak të kufizimeve financiare, qoftë për sa i përket cilësisë së burimeve

njerëzore në nivel lokal, por patjetër më pas edhe për sa i përket kontrollit të territorit, që bashkitë mund të ofrojnë, aq më shumë për të ndërtuar një model ekonomik të qëndrueshëm.

Unë besoj se vetë komisioni, kur të kryejë seancat dëgjimore apo turin e vizitave në territor dhe kur të takojë kryetarë bashkish apo edhe aktorë të tjerë lokalë, do të shohë se ato çfarë janë faktuar në këtë raport, do të jenë lehtësisht të evidentueshme edhe në territor.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Po, zoti Bozdo.

Enno Bozdo – Faleminderit!

Zoti ministër, nuk do të doja të isha kaq optimist, sa jeni ju, kur shikoj reformën territoriale të vitit 2015. Të dhënat që kemi përpara, ajo që dimë, njohim nga terreni dhe takimet ku ushtrojmë aktivitetin tonë, por jo vetëm, për fat të keq, na japin një panoramë komplet të ndryshme nga ajo që ju prezantoni.

Reforma territoriale, së pari, nisi në vitin 2015 me premisën e madhe të reformimit total të sistemit territorial. Një ndër premtimet e mëdha ishte kursimi 60 deri në 80 milionë euro që do të bëhej për hir të pagave, të shkurtimit të administratës, kjo me premtimin tjetër që do të kthehen në financime, investime për pushtetin vendor, financime për dhënien e shërbimeve, dhe këtë e thonë të dhënat, nuk e themi ne. Por jo vetëm që nuk ka ndodhur një kursim nga 60 deri në 80 milionë euro në vit, por shikojmë që shpenzimet për të gjitha bashkitë e pushtetit vendor janë rritur në mënyrë stratosforike.

Më lejoni t'ju jap disa shifra, të cilat janë marrë nga Ministria e Financave.

Në vitin 2015 shpenzimet për paga dhe sigurime ishin 10 580 milionë lekë, janë bërë 34 014 milionë lekë (pra janë pothuajse 3 herë e gjysmë më shumë); shpenzimet operative ishin 9 900 janë 21 000; shpenzimet kapitale nga 12 800 në 14 mijë e 500. Pra, po i kthehem asaj që tha zonja Tabaku, nëse kemi rritje stratosferike për shpenzime operative dhe shpenzime për paga, që rezulton edhe nga të dhënat, sepse nga 20 mijë të punësuar, kur sistemi ishte shumë keq dhe shumë problematik në vitin 2015, tani kemi 40 mijë të punësuar, shikojmë që investimet kanë ngelur pothuajse në vend. Ky është një problem i madh, kur vjen puna për të diskutuar se sa funksional është ky sistem që kemi ne sot, sepse nga investimet varet gjithçka. Siç e thatë edhe ju, në 47% të territorit, nëse nuk gaboj, nuk ka shërbime, se nuk ka burime njerëzore, por mua me këto shifra më rezulton se burime njerëzore duhet të ketë, por shërbime nuk e kuptoj pse nuk ka! Gjithashtu, në shifrat që gjenden lehtësisht në Ministrinë e Financave apo tek *Open Data*, nëse do të shikojmë se ku janë përqendruar investimet në 10 vjet të reformës, do të shikojmë që 90% e investimeve në bashki janë në zonat urbane dhe 10% e këtyre investimeve shkojnë në zonat rurale. Kjo hap një temë shumë të rëndësishme: pse ka

ndodhur braktisja e zonave rurale?! Sipas të dhënave, braktisja e zonave rurale është 2,8 herë më e shpejtë se braktisja e zonave në gjithë braktisjen e madhe që ka përjetuar Shqipëria, 1,1 milionë të ikur. Pra, edhe sikur t'i marrim të mirëqena të dhënat e censit, përsëri do të shikojmë që në zonat urbane kjo braktisje është 3 herë më pak sesa në zonat rurale, në një kohë kur 40% apo 45% e popullatës jeton në zonat rurale. Kjo është një pikë shumë e debatueshme për cilësinë e reformës.

Dua të ndalem në disa të dhëna të tjera, që, realisht, më shqetësojnë. Një nga arsytet e mëdha dhe premtimet e mëdha, që u ndërmor reforma e vitit 2015, kishte të bënte me çështjet e uljes së varësisë së pushtetit vendor nga pushteti qendror. Nëse shikojmë çështjet e decentralizimit fiskal, do të vëmë re se të dhënat teknike në letër tregojnë që ka një avancim, dhe është e vërtetë ajo që thoni ju, por kemi problemin se në përlogaritje futen (nuk them se nuk duhet futur, por duhet disektuar kjo e dhënë për të kuptuar se në çfarë niveli jemi) të gjitha të ardhurat që kanë ardhur pothuajse nga 13-ishimi i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturës e Bashkisë së Tiranës, pra vetëm Bashkia e Tiranës. Më lejoni t'u jap disa shifra pse e bëj këtë gjë, sepse, si rregull, nuk duhet ta bëja. Ne e dimë që të ardhurat nga ndikimi në infrastrukturë, taksa, nuk është një taksë e cila do të vazhdojë të mbajë të njëjtat nivele, përkundrazi, këtë vit kemi rënie të ndjeshme të të hyrave në Bashkinë e Tiranës dhe opinioni i përgjithshëm i ekspertëve është që flluska ka marrë tashmë një formë. Gjithsesi, autonomia fiskale, pa Bashkinë e Tiranës, në vitin 2015 vlerësohej me indeksin 38,5% dhe në vitin 2025 vlerësohej me indeksin 37,9%, një rënie e lehtë dhe rreth 60% e bashkive kanë përkeqësuar të autonomisë fiskale. Këto janë të dhënat reale. Nëse heqim atë, që është burimi kryesor sot, do të shikojmë se autonomia fiskale është përkeqësuar. Edhe qëndrimi në vend apo po të kishte një rritje të lehtë, përsëri do ta quaja përkeqësuar kundrejt pritshmërive shumë të mëdha, që u theksuan në vitin 2015 për këtë reformë.

Marrim një të dhënë tjetër, që ka të bëjë me atë se sa i varur nga qendra është pushteti vendor, marr vetëm transfertat në buxhetin e shtetit. Në vitin 2015 transfertat në buxhetin e shtetit përbënin 46,7% të të ardhurave; në vitin 2024 46,1% të të ardhurave, pra e shikojmë që jemi pothuajse në të njëjtin nivel. Kemi një strukturë të deformuar për sa u përket të ardhurave vendore. Në vitin 2015 9% e të ardhura vendore vinin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, sot janë 41% (argument që e shtjellova, rritje 13 herë). Taksa e biznesit të vogël është minus 97%, por kjo ka ardhur nga zerimi i taksës së biznesit të vogël.

Taksa e pronës në vitin 2015 zinte 25,7%, sot 16,9%, që tregon se në burimet e rëndësishme të të ardhurave të qëndrueshme pushteti vendor ka rënie dhe jo rritje. Shpenzimet janë zhvendosur në administratë dhe përsëri do t'ju jap të dhëna. Në vitin 2015 investimet në

të gjitha bashkitë dhe komunat ishin 1,2 herë më të larta se pagat. Në vitin 2024 pagat janë 2,3 herë më të larta se investimet.

Pra, njerëz në punë ka, jo më kot janë 40 mijë të punësuar në pushtetin vendor, por nuk ka investime, sepse i gjithë kahu ka lëvizur në drejtim të pagesës së stafit, duke lënë mënjanë shërbimet. Ky është shërbim që impakton në performancën e të gjitha bashkive.

Në lidhje me mënyrën se si ju e ngrini diskursin tuaj, ju thoni se bashkitë e vogla në përgjithësi kanë dështuar dhe po në përgjithësi bashkitë mbi 50 mijë banorë, nëse nuk gabojnë, kanë qenë të suksesshme. Në fakt, nuk është ekzaktësisht kështu, por të dhënat që kemi, tregojnë se bashkitë e mëdha kanë një autonomi financiare më të lartë se bashkitë e vogla, por në modelin që kemi sot, fut edhe Bashkinë e Tiranës me projeksionet, asnjë nga strukturat e bashkive nuk është mjaftueshmërisht e pavarur, që tregon se reforma e vitit 2015 fut ujë në të tjerë indikatorë.

Së dyti, në dhënien e shërbimeve patjetër që një bashki e vogël është e disfavorizuar, por, nga ana tjetër, realiteti europian na tregon që bashki të vogla ekzistojnë kudo, me 3 mijë, 5 mijë, 7 mijë banorë. Kam një të dhënë që mesatarja e banorëve për bashkitë e Bashkimit Europian është 5 900 – 6 000 banorë, në një kohë që mesatarja jonë është 40 mijë banorë. Pra, jo domosdoshmërisht madhësia e njësisë përcakton suksesin e saj. Nëse këto njësi, siç është historia e njësisë të Veriut, ku futet një qytet i madh, siç është Shkodra, e lë pa investim, por edhe ato investime që merren, shkojnë në qytete të mëdha ose për “Rilindjen” për sheshet brendapërbrenda dhe jo për rrugë, kanale ujitëse, kulluese, e të tjera, sigurisht, shërbimet bëhen, por më pas njerëzit preferojnë të mos jetojnë më atje. Ky është rreth vicioz dhe unë e shikoj që jo, për shkak të reformës, por për shkak të gjithë asaj që ka ndodhur në Shqipëri për 10 vjet, ka filluar tani të plotësojë vetveten. Ikim se jemi të varfër, por nuk ka investime, sepse kemi ikur dhe vazhdon ky cikël me radhë.

Me pak fjalë, për mua, personalisht, është guxim shumë i madh edhe intelektual, e them ndershmërisht, duke hequr dorë nga pjesa politike ku besoj unë, të nxjerrim një përfundim se çdo gjë e vogël është keq dhe, sa më e madhe të bëhet, ne shkojmë drejtë një modeli sukcesi. Kam të dhëna pafund që nuk e vërtetojnë një gjë të tillë. Nuk jam duke thënë që e vogla është e bukur, por jam duke thënë që është tërësia se si reforma ecën; është tërësia e kuadrit rregullator, e investimeve, e taksave që ne i lëmë pushtetit vendor, që përcaktojnë në një mënyrë apo tjetër se sa e suksesshme është një reformë dhe, mbi të gjitha, të mos harrojmë: përfaqësimi dhe ofrimi i shërbimeve atje ku është qytetari ka përparësi absolute nga çdo analizë e ftohtë ekonomike që ne në këtë tryezë mund të marrim dhe të bëjmë. Më mirë të shpenzojmë më shumë para, por ta dimë që qytetarit i jepet shërbimi, se sa të diskutojmë me parimin që të

kursejmë para, duke mos ofruar shërbim. Duke e përmbledhur, kjo ishte më tepër ndërhyrje, por nëse keni komente, mund t'i bëni.

Mendoj se është shumë e rëndësishme që, çfarë ka prodhuar 2015-ta, të shikohet drejt në sy dhe të shihet me realitet. Jam nga ata që besoj se në vitin 2015 duhej bërë një reformë territoriale. Më vjen shumë keq, por e besoj që në fillim se për mënyrën se si u hartua dhe se si procedoi ajo reformë, nuk do të kishte përfundim më të mirë sesa ky sot. Por nëse ne duhet të jemi të ndershëm me njëri-tjetrin, duhet të themi që kemi shumë probleme të trashëguara nga vitit 2015: ofrimi i shërbimeve; mungesa e investimeve; bashki që i fryjnë pozicionet e tyre pafund; kemi bashki, si Bashkia e Burrelit, në mos gaboj (kam një të dhënë), që e kanë 8-fishuar fondin e pagave.

Të gjitha këto duhen trajtuar me shumë seriozitet. Nuk mundet dot të mendojmë se mund të bëjmë një punë të mirë së bashku, nëse nuk e vëmë gishtin në plagë. Gishti në plagë është që ajo reformë ka prodhuar shumë probleme. Mënyra se si kapërcehet kjo, nuk është as të themi që, çfarë është e vogël është e keqe dhe çfarë është e madhe, është e mirë, as të themi të kundërtën, nuk jam për këtë, por të gjithë së bashku të punojmë dhe të prezantojmë një përfaqje 360 gradë, nga të gjitha anët, se si ajo që është e vogël dhe ajo që është e madhe, mund të funksionojnë normalisht; se si ne mund të bëjmë që ekonomia e shkallës të funksionojë, sepse çështja e mosfunksionimit të mbetjeve nuk është problem as i një bashkie të vogël, as i një bashkie të madhe, është problem i inceneratorëve që morën ato fonde që morën dhe sot nuk dihet ku janë, sepse çështja e autonomisë vendore nuk është më problem i një bashkie të madhe apo të vogël, për sa kohë qeveria vendos që në KRRT t'i japë të gjitha lejet mbi 6 kate, sepse çështja e autonomisë vendore, e përfaqësimit vendor, e zgjedhjes vendore, sigurisht...

Arbjan Mazniku – Zoti Bozdo, bëj pyetje, se e kemi thirrur ministrin, ta dëgjojmë! Të na dëgjojë ne ministri, nuk bën shumë sens. Ne flasim sa të duam, por besoj që i flasim në seancë, i flasim me njëri-tjetrin, kemi thirrur ministrin, i bëjmë pyetje, ta dëgjojmë, pastaj të diskutojmë sa të duam. U bënë 15 minuta që po flisni dhe nuk e kam dëgjuar akoma pyetjen.

Enno Bozdo – Pyetje janë të gjitha këto.

Arbjan Mazniku – Ngrini 2-3 pyetje, që t'u përgjigjet...

Enno Bozdo – Nëse nuk arrini t'i kuptoni pyetjet... Këto janë të gjitha çështje për diskutim.

Arbjan Mazniku – Jo, nuk ka rëndësi.

Çështjet për diskutim janë tjetër gjë. Pyetjet zakonisht mbarojnë me pikëpyetje. I bëjmë një seri pyetjesh dhe i themi që këto janë pyetjet, pra 1, 2, 5 dhe e dëgjojmë, se e kemi thirrur ministrin që ta dëgjojmë. 15 minuta rresht keni folur vetëm ju. Nuk kam asnjë problem.

Enno Bozdo – Zoti kryetar, te ministri e mbani kritikën, kur vjen puna te qeveria dhe te Kryeministri, e shoh që nuk e mbani kritikën.

Arbjan Mazniku – Thjesht, për eficiencë të kohës së të gjithëve, bën sens, edhe për eficiencë të kohës së ministrit, ç’është e vërteta.

Enno Bozdo – Patjetër! Ta përfundoj?

A mundet t’i drejtoj pyetjet, ashtu si e mendoj unë?!

Nuk kam pyetje për ministrin, ministri nuk ka qenë pjesëtar i reformës së vitit 2015. Nuk kam pyetje për ministrin, i cili mund të përgjigjet. Kam çështje për të diskutuar me ministrin. Ministri nuk jep përgjigje teknike, të paktën kështu e mendoj unë. Ministri vjen dhe na jep të gjitha njohuritë e tij në nivel makro, *think tank* të thotë që këtë çështje e sheh në këtë mënyrë. Ne mund të bëjmë debat sa të doni, por shifrat janë ato që janë. Dikush mund ta nxjerrë njërën palë të shifrave, çështjet që po ngre, janë shumë të rëndësishme.

Arbjan Mazniku – Janë shumë të rëndësishme, pa dyshim, e kisha tek efienca e kohës. Për shifrat që thatë, i kam edhe unë, patjetër, bëjmë diskutim bashkë gjithë ditën.

Enno Bozdo – Zoti Ministër, a mendoni se kjo histori është më e thellë se çfarë diskutojmë ne sesa argumenti i vogël *versus* i madh? A mendoni që duhet trajtuar për hir të njerëzve, për hir të komuniteteve, për hir të atyre që u shërbejmë, të trajtohet në mënyrë më të ndershme, më gjithëpërfshirëse dhe të shikohet vërtet problemi? Po të jetë puna që këtu vijmë me përjasjen se, çfarë është e vogël, nuk funksionon dhe, çfarë është e madhe funksionon, besoj se kemi gënjyer, mbi të gjitha, veten dhe nuk kemi bërë atë që pritet nga ne si komision.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Po!

Ervin Demo – Faleminderit!

Kur u referohem madhësive të bashkisë, thjesht u referohem gjetjeve të raportit.

Ndërkohë, bie dakord me ju që qasja duhet të jetë 360 gradë dhe besoj se komisioni duhet ta ketë këtë qasje dhe të analizojë. Unë e kam shumë problem, kur diskutohet dhe flitet vetëm për historinë e numrit të bashkive. Duhet folur me më shumë detaje për ato të cilat janë realisht qoftë sfidat, por edhe problemet që kanë sot bashkitë.

Për sa i përket reformës së vitit 2015, besoj se ka qenë një progres i qartë për sa i përket vetëqeverisjes vendore, por, patjetër, me shumë mësim të nxjerra gjatë 10 vjetëve të fundit. Besoj se edhe roli i komisionit duhet të jetë pikërisht për ta përdorur të gjithë atë bagazh, jo thjesht informativ, por, mbi të gjitha, për të kuptuar se çfarë ka ndodhur realisht në territor, sidomos në qasje me qytetarin. Të gjithë ne këtu jemi për të bërë më të mirën për qytetarin, pastaj secili mund të ketë këndvështrime të ndryshme gjatë rrugës, por rrugën duhet ta fillojmë

të gjithë së bashku dhe ne këtu si ministri jemi për ta ndihmuar, me aq sa mundemi, komisionin për të bërë një udhëtim sa më të shëndetshëm.

Luçiano Boçi – Fjalën e ka zoti Malaj.

Agron Malaj – Kam një pyetje. Rreth 70% e legjislacionit të BE-së zbatohet në nivel vendor. Me Shqipërinë drejt anëtarësimit, a janë bashkitë tona të përgatitura që të absorbojnë fonde strukturore europiane, apo kjo kërkon njësi me kapacitete më të mëdha?

Një sugjerim kam për kolegun Bozdo: nuk e di ku i merrni këto të dhëna, por mendoj se i keni të gabuara, të paktën në lidhje me Bashkinë e Matit, se thatë që Bashkia e Burrelit e ka rritur 8 herë fondin e pagave. Kjo nuk është e vërtetë, megjithatë duhet ta rishikoni më shumë dhe mund t'i bëni një kërkesë Bashkisë së Matit që t'ju japë informacione.

Po, ka vetëm një gjë: ka rritur shërbimin në komunitet, pra në të gjithë territorin që mbulon. Reforma e vitit 2015 ishte shumë e suksesshme, sepse u pa në të gjithë bashkitë në mënyrën se si...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, flas edhe si kryetar bashkie që kam qenë...

Duke menduar ish-390 komunat e asaj kohe, ku nuk kishin fonde për pagat e tyre dhe jo më të për t'u bërë shërbim njerëzve në komunitet. Kur mendoj vetëm Bashkinë e Matit me 490 kilometra rrugë rurale, që u zëvendësuan me një administratë dhe performancë shumë të mirë, ku sot kemi 90% të rrugëve të bashkive të asfaltuara....

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mund t'i kesh parë në imagjinatë... I shkelim, i shikojmë edhe nesër bashkë...

Enno Bozdo – I kam parë...

Agron Malaj – Mund ta shikosh të gjithë nivelin arsimor, të investuar apo sa e sa gjëra të tjera.

Luçiano Boçi – Zoti Malaj...

Agron Malaj – Ta mbaroj deri në fund!

Luçiano Boçi – Mbaroje me ministrin, jo me zotin Bozdo. Argumentet kundër jepini në parashtrimet tuaja. Ti e ke me ministrin, zoti Malaj.

Agron Malaj – Bashkitë kanë nevojë të kenë një qasje tjetër për t'i grupuar dhe për t'i zmadhuar që t'i bashkëngjiten...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju kemi dëgjuar 2 orë duke folur, a të flasim dy minuta?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ma heq ti të drejtën! Kemi një orë që dëgjojmë zonjën Tabaku dhe një orë zotin Bozdo, të flas unë tani?

Luçiano Boçi – Do të na dëgjosh edhe disa orë të tjera, durim sot!

Agron Malaj – Nuk ma ndërpret dot ti fjalën...

Luçiano Boçi – Drejtoju ministrit, jo kolegut, sepse nuk t'u referua njeri ty...

Agron Malaj – Ne kemi menduar që bashkitë të jenë të njësuara me bashkitë e Bashkimit Europian, që të jenë të afta për të thithur projekte, fonde dhe të jenë të afta t'i menaxhojnë mirë këto...

Luçiano Boçi – E kemi me ministrin dëgjesën, nuk e kemi me njeri-tjetrin.

Agron Malaj – Ministër, këtë pyetje kisha unë.

Më pas vijoni me ato statistikat, se nuk e di nga i marrin, nga një planet tjetër...

Ervin Demo – Faleminderit, zoti Malaj!

Në fakt, e përmenda edhe më parë, për sa i përket procesit të integritit, i cili, në fakt, rrit ndjeshëm kërkesat ndaj pushtetit vendor dhe kërkon një nivel krejt tjetër për sa u përket kapaciteteve administrative dhe teknike, sepse një pjesë shumë e madhe e legjislacionit, që do të zbatohet në nivel vendor, lidhet ngushtësisht me atë që presim nga procesi i integritit, po ashtu bashkitë, në të njëjtën kohë, përballen me kërkesa gjithnjë e më komplekse që ka vetë territori.

Në qoftë se ne themi se rreth 70% e përafrimit, që është duke ndodhur tashmë, do të afektojë bashkitë në mënyrë direkte dhe indirekte, besoj se cilido institucion, edhe institucionet që kanë kapacitete të konsoliduara, në çfarëdo rasti do ta kishin sfidues këtë realitet, aq më tepër kur flasim për afate kohore relativisht të shkurtra. Çdo ndihmë që mund të marrin bashkitë, qoftë nga pikëpamja strukturore, por jo vetëm, apo edhe nisma të tjera që, ne si Ministri e Pushtetit Vendor, jemi duke ndërtuar, si: akademia e pushtetit vendor, por edhe matja e performancës për të krijuar një lloj lëvizshmërie më të qartë midis bashkive, duke u orientuar kundrejt cilësisë së shërbimeve, besoj se janë të domosdoshme për të arritur në një nivel të kënaqshëm, aq më tepër me ato sfida që na presin si rrjedhojë e procesit të integritit apo më pas kur Shqipëria do të jetë vend anëtar i Bashkimit Europian.

Në fakt, do të shtoja një të dhënë, sepse më ngacmoi ish-kryetari, deputeti Malaj, përpara vitit 2015 70% e buxhetit në nivel vendor ka qenë për paga, ndërsa sot është vetëm 44%. Kështu që, ne mund të flasim për sa i përket rritjes së...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jam gabim?

Të shikojmë të dhënat e tjera, por si peshë specifike zëri i pagave në buxhetin e sotëm zë shumë më pak sesa çfarë zinte para vitit 2014. Po flasim për buxhetet që kishin të alokuara bashkitë në nivel kombëtar përpara vitit 2015. Ky është fakt, gjithsesi mund t'i ballafaqojmë të dhënat.

Arbjan Mazniku – Zoti Mziu, fjala për ju.

Xhelal Mziu – Zoti ministër, ju ndoqa me vëmendje, sepse ju vini si ish-kryetar bashkie, por unë do të jap një koncept tjetër për pushtetin vendor. Ne kemi një reformë territoriale, e cila është bërë në mënyrë të njëanshme në vitin 2014, në dallim nga vendet e Bashkimit Europian, ku nëse 2 njësi vendore apo më shumë duhet të bashkohen apo të ndahen, janë qytetarët ata që vendosin.

Së dyti, ne nuk kishim asnjë lloj arsye për të bërë reformën territoriale në aspektin e centralizimit, sepse në vitin 2014, kur u bë reforma, gjithsej kishim 373 njësi vendore. Pra, nëse i referohemi mesatares, i binte 11 000 banorë për njësi vendore. Theksoj se sot në 27 vendet e Bashkimit Europian kemi një mesatare prej 6 000 banorësh për njësi vendore, që do të thotë se ne kishim gati dy herë më shumë banorë për njësi vendore. Pra, do të thotë se e kishim gati dy herë më larg, duke qenë edhe zonë rurale, qytetarin për të shërbyer. Pra, është një kauzë, e cila nuk është standard i Bashkimit Europian, përkundrazi, është një regres për këtë reformë, që ne tentojmë ta implementojmë deri në vitin 2027, fiks 12 vjet më vonë. Kjo do të thotë që kemi dy qasje të ndryshme. Qasja jonë është që të kemi decentralizim dhe pushteti vendor të jetë sa më afër qytetarëve. Unë prisja nga ju si ish-kryetar bashkie që ta zvogëlonit numrin e bashkive dhe të jemi më afër tyre, ose të jepje një instrument apo një shtet tjetër që e ka këtë qasje, por që, në fakt, nuk ka.

Nëse i referohemi disproporcionalitetit, as sot dhe as atë herë ne nuk kemi vendosur një kornizë se cili do të jetë standardi që ne duhet të përdorim, pra minimumi i banorëve për njësi vendore, dhe cila do të jetë largësia e bashkisë deri te qytetari më në ekstrem i njësisë vendore. Pra, a do të jenë qytetarët ata që do të vendosin për ndarjen, apo për bashkimin? Kështu që, edhe ky ishte një tjetër element që prisja ta konsideronit si shumë të rëndësishëm për këtë reformë.

Ne kemi një reformë disproporcionale. Unë po marr vetëm Dibrën që kishte 17 njësi vendore, 16 komuna dhe 1 bashki. Mesatarja për zgjedhjen e një bashkie ishte afërsisht bashkimi i 6 apo 7 njësive vendore. Unë po flas për Dibrën, por si ajo ka edhe të tjera. Si mundet që nga 17 njësi vendore... Marrim shembull një qytetar nga Lura, nga Kalaja e Dodës, Selishta e të tjerë i duhet një ditë për të shkuar te qendra e bashkisë! Po marr shembull Këlcyrën, që ka një komunë apo një bashki, nuk e di se si ka qenë, krahasojeni me Dibrën; ose qarkun e

Gjirokastrës, e cila ka shtatë njësi vendore, ndërsa qarku i Lezhës, që ka popullsi dy herë më shumë, ka vetëm tri njësi vendore. A nuk është një diskriminim ndaj atyre qytetarëve? Prandaj, kërkoj opinionin tuaj në lidhje me këtë çështje për t'i shkuar qytetarit sa më afër.

Unë po jap disa referenca pse kur bashkia është e madhe... Unë ju kërkoj ndjesë, por duke qenë si kryetar bashkie qendër-qarku, por edhe zoti Mazniku, si nënkryetar bashkie qendër, më shumë keni atë delirin e madhësisë dhe të centralizimit sesa të decentralizimit për të shkuar te qytetari. Kështu që, duhet t'i mirëkuptojmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë ju kërkoja ndjesë paraprakisht për këtë.

Unë ju dhashë disa referenca për të treguar që po bëjmë hapa mbrapa, ose më saktë, kemi bërë hapa mbrapa, por që të arrijmë atje ku duhet që të shkojmë drejt decentralizimit.

Cilat janë pasojat?! Unë po jap disa indikatorë që tregojnë pasojat negative që kanë ndodhur dhe po marr shembull qarkun e Dibrës. Selishta është një njësi që në këta 13 vjet, ose po marr periudhën vetëm nga viti 2015 deri më sot, nuk është bërë asnjë investim; në Reç nuk është bërë asnjë investim; në Dardhë apo Zall-Dardhë nuk është bërë asnjë investim; në Luznie nuk është bërë asnjë investim; në Trebisht nuk është bërë asnjë investim. Pra, janë disa bashki, të cilat, duke qenë periferike, nuk janë bërë investime, për pasojë nuk ka investime publike, tek të cilat jo vetëm që nuk ka ndërtime shkollash, ristrukturime apo qendra shëndetësore, por, përkundrazi, janë mbyllur.

Është rrënuar bujqësia, sepse askush nuk e punon tokën bujqësore dhe, po të shkosh në pazarin e Dibrës, jam i sigurt edhe diku tjetër, konsumon produkt importi. E gjithë kjo ka sjellë largimin e qytetarëve jashtë shteti. Këto janë efektet negative që kanë ndodhur për shkak të centralizimit, sepse ka dhënë efekt të drejtpërdrejtë të bujqësisë, ku ju e dini shumë mirë që ka 7 vjet rresht që bujqësia është në regres. Janë mbyllur shkolla dhe ju e dini shumë mirë që ka mbi 180 000 nxënës më pak sesa 13 vjet më parë, të cilët janë detyruar të ikin. Madje, edhe atje ku ka shkolla, i kanë grupuar nxënësit, i marrin me furgon, ku drejtuesi i mjetit i shtyn me këmbë për t'i ngjeshur sa më shumë për t'i dërguar tek ish-njësia fqinje që të vazhdojnë mësimin, imagjinoni se si mund të bëhet mësimi.

Ka edhe të tjera elemente, por unë do të doja që ju, zoti ministër, influencën tuaj ta ushtroni edhe një herë te qytetarët.

Ju, zoti ministër, na paraqitët disa të dhëna të pavërteta dhe unë ju sfidoj me shifra dhe me argumente. Kam disa nga raportet e emetuara, të dhënat e INSTAT-it dhe të Ministrisë së Financave dhe unë po ju jap disa shifra. Në bashkitë e vogla dhe bashkitë e mëdha, produkt i Ministrisë së Financave dhe i INSTAT-it, në vitin 2015 shpenzimet për paga dhe sigurime

shoqërore kanë qenë 31,1%; bashkitë e mëdha e kishin 45,7%, që do të thotë se në vitin 2024 shpenzimet për paga janë rritur me rreth 14,6%. Kjo ishte nëse u referohemi shpenzimeve kapitale, pra, aty ku kishim të bënim me pagat. Nëse u referohemi investimeve, investimet që ju sapo i thatë kolegut se ishin një shifër minimale, unë dua t'ju them se në vitin 2015 shpenzimet kapitale ose investimet ishin 37,5%. Në vitin 2024, nuk mund t'ju gënjej se sa është shifra e 2025-ës, sepse nuk është e matur, nga 37,5% që ishte në 2015-ën, ka zbritur në 17,5% ose -18%, ose e thënë ndryshe, dy herë më pak investime te qytetarët. Kur flasim për situatën, tendencën, nuk flitet me shifra, por flitet me përqindje. Pra, është dy herë më pak.

Nëse u referohemi shpenzimeve operative, në vitin 2015 kanë qenë 31,4%, flas për 61 bashkitë, të cilat janë rritur në 34,8%. Pra, shohim se kemi rritje të shpenzimeve për paga +14,6%, kemi rritje të shpenzimeve operative 3,4% dhe kemi ulje të investimeve.

Kur kishim 373 njësi, buxheti i shtetit jepte edhe fonde konkurruese dhe i shkonte gjithsecilit, edhe tek ajo komuna e vogël, ndërsa sot kur shkojmë në një bashki të madhe, të gjitha ish-komunat kthehen periferike dhe investimi bëhet pothuajse në qendër.

Po merrem me një tjetër element shumë të rëndësishëm. Kauza për të kursyer 80 milionë euro nga buxheti i shtetit ishte kryefjala në atë kohë, madje ishte edhe rritja e taksave që do të marrë pushteti vendor, sidomos nga fiskalizimi i kadastrës urbane, por unë ju sfidoj me shifra: është rritur ndjeshëm numri i të punësuarve, ku kishim rreth 18 000 të punësuar, ndërsa sot janë më shumë sesa 40 000. Por, nëse i referohemi edhe ekonomisë së shkallës, si ka mundësi që nga 373 njësi të reduktuara në 61, normalisht, kjo e fundit e ul numrin e punonjësve, ndërsa këtu ndodh e kundërta, është rritur më shumë sesa dy herë. Kjo është një tjetër shifër që tregon regresin e këtyre bashkive.

Merremi me një element tjetër. Si ka mundësi që me një administratë, afërsisht me 200 000 të punësuar, kemi eficiencën më të ulët në rang Europe?! Nëse u referohemi bashkive, kemi rekord në rajon dhe në botë, kemi 65 punonjës për 1000 banorë, e cila është 10-15 herë më pak sesa vendet e Bashkimit European. Edhe për këtë shifër ju sfidoj.

Një tjetër element, që përmendi kolegu Bozdo, edhe unë, referuar statistikave të emetuara nga Ministria e Financave dhe INSTAT-i, thuhet në vitin 2024, pa marrë 2025-ën, vetëm 9 vjet, kemi tri bashki që u është dyfishuar fondi i pagave; kemi 18 bashki që u është trefishuar fondi i pagave; kemi 29 bashki që u është katërfishuar fondi i pagave; kemi 8 bashki që u është katërfishuar fondi i pagave; kemi 2 bashki që u është pesëfishuar fondi i pagave dhe kemi 1 bashki që i është tetëfishuar fondi i pagave. Si ka mundësi që ne pretendonim të kursenim 80 milionë euro dhe tani kemi këtë lloj reference? Përsëri ju sfidoj me dokumente zyrtare për shifrat që unë përmend.

Po marrim edhe dy indikatorë të tjerë që tregojnë se Shqipëria nuk ka asnjë lloj standardi për të shkuar drejt vendeve të Bashkimit European. Të paktën, sa herë që mbledhesh shoqata, ku ne kemi qenë bashkë me kolegët e majtë, dhe diskutohej për të rritur përqindjen ndaj pushtetit vendor, kemi qenë pothuajse të fundit në rajon.

Ne kemi ngelur në vend, madje është ulur përqindja në bashkive, megjithatë, unë po jap disa të dhëna të tjera, të cilat janë zyrtare. Të ardhurat lokale në raport me të ardhurat publike: Shqipëria i ka 11,7%, ndërkohë që OECD-ja i ka 38,3% dhe 27 vendet e Bashkimit European i kanë 22,6%. Kjo do të thotë që jemi të paktën dy herë më pak sesa mesatarja e vendeve të Bashkimit European dhe mbi tri herë më pak sesa OECD-ja. Nëse marrim të ardhurat, në raport me prodhimin e brendshëm, Shqipëria ka vetëm 3,4%, kur vetëm vendet e rajonit e kanë të paktën dy herë më shumë se ne; OECD-ja e ka 16,1% dhe vendet e Bashkimit European e kanë 11,1%. Pra, nuk e kuptoj cili ka qenë progresi që keni arritur?

Po shkoj te çështja tjetër: ju keni qenë kryetar bashkie, ashtu siç kam qenë unë dhe disa kolegë të tjerë këtu. E di ti që një kryetar bashkie kur do të ndërtojë një shkollë apo të bëjë një investim publik, duhet të shkojë të marrë leje te Ministria e Financave apo te Ministria e Ekonomisë për të ndërtuar një objekt publik, sepse nuk ka asnjë lloj pronësie, në dallim nga vendet e tjera të rajonit dhe të Bashkimit European?!

Nëse shkojmë tek ajo sfidë që ishte, pra përveç 80 milionë eurove që do të kursenim, ishte edhe një tjetër element që pretendonim për ta arritur, sepse jemi të fundit, por jo të fundit, por, në diferencë me vendin më të keq të rajonit, jemi të paktën dy deri në tri herë më pak të mbledhja e taksës së pasurisë, të cilën mund ta mbledhë pushteti vendor.

Sot ti nuk ke asnjë lloj kompetence, nuk ke zyra, përkundrazi, janë centralizuar zyrat dhe nuk ka asnjë lloj shansi që dikush të vijë dhe të marrë aktin e pronësisë së tokës dhe të grumbullojë të ardhurat. Pra, është një tjetër element, që dua që ta keni kryefjalë për t'i dhënë autoritetin e nevojshëm pushtetit vendor. Po shkoj te një qasje tjetër, zoti Ministër...

Arbjan Mazniku – Zoti Mziu, me gjithë respektin...

Xhelal Mziu – Ja, sa ta mbaroj.

Arbjan Mazniku – T'i japim mundësi që të kthejë përgjigje, pastaj bëjmë përsëri pyetje, siç i bëri zonja Tabaku.

Xhelal Mziu – Se i mban mend.

Arbjan Mazniku – Në rregull.

Xhelal Mziu – Në vitin 2015 u deleguan shtatë kompetenca dhe, midis këtyre shtatë kompetencave, asgjë nuk u delegua. U deleguan vetëm kosto për pushtetin vendor, por një gjë

pozitive, ishte që ujësjellës-kanalizimet kaluan në pronësi të pushtetit vendor. Sot e di ti që është hequr?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e ka më pushteti vendor, madje jo vetëm që nuk e ka pushteti vendor, por unë po them përsëri një tjetër reformë që bëri qeveria: kishim 58 ujësjellës-kanalizime në të gjithë Shqipërinë, më pas shkuan në 15 ujësjellës rajonalë dhe, kur shkon nga 58-ta tek 15-ta, për shkak të ekonomisë së shkallës, të paktën ulet numri i të punësuarve. Shih çfarë ka ndodhur: u rritën tarifat pothuajse në të gjithë ujësjellësit e Shqipërisë; u rrit numri i administratës, për pasojë u rritën edhe kostot, por pati më pak shërbime ndaj qytetarëve. Madje, nuk u mjaftua vetëm me këta 15, por sot e kemi në rang kombëtar, e ka marrë ministria. A e pranoni, a do të jetë pjesë e qasjes ndryshe nga ajo çfarë ka sot qeveria?!

Një tjetër element, që besoj se edhe ju e keni vuajtur dhe duhet ta thoni në fakt, është bërë reformë dhe thanë që do t'i ndajnë qartë kompetencat e pushtetit vendor me atë qendror. Po marr vetëm një rast për ta ilustruar: te ndërtimet pa leje janë Policia e Shtetit, IMT-ja, IKMT-ja, tani kanë futur edhe AZHT-në. Për shembull, ua kanë hequr bashkive kush ndërton mbi pesë kate dhe ia kanë dhënë kompetencë, ia kanë kaluar me ligj AZHT-së. Pra, kemi katër struktura që shkojnë te pallati: njëri shkon në mëngjes, tjetri në drekë, tjetri rreth darkës, tjetri në orët e vona. Ku e keni parë këtë? Më gjeni një vend të botës. Madje, thonë: “Ne kontrollojmë”. Bëje ligjin dhe ta kontrollojë ai që ka autoritet. Kjo do të ishte një qasje që të paktën si kryetar bashkie ta vendosje në binarë, sepse nuk mundet që katër struktura të shkojnë e të merren me një ndërtues, që përsëri më duket absurde.

Unë mund të them edhe disa gjëra të tjera, por, ndoshta, bëhem i bezdisshëm, mbase do të lë një pjesë tjetër që t'i konsumojmë me aktorët e tjerë që do t'i kem përballë. Pra, bëra një narrativë të asaj që ju thatë dhe që kundërshtova, edhe për shkak të funksionit që keni pasur, për të treguar problematikën që ka sot pushteti vendor dhe zgjidhjet në themel.

Edhe një gjë po them, sepse konsiderohet pushteti vendor si një sh.p.k që do të prodhojë, ku e keni parë?! Në asnjë vend të botës!

E para, jepi kompetencë dhe, e dyta, jepi financa, si vendet e Bashkimit Europian, ku ne duhet të aderojmë në vitet 2027 apo 2030 apo '37, nuk e di, por ne, për sa kohë bëjmë çdo ditë ligje, le ta bëjmë edhe këtë, që të shkojmë tek standardet që ata kërkojnë.

E ka zgjidhur Europa. Kur një bashki nuk ka kapacitete, bie fjala, si mund të kërkojë kapacitete? Për shembull, nuk mund të krahasoj një qytet bregdetar me një qytet, i cili nuk ka resurse dhe, normalisht, ka një disproporcion të të ardhurave. Për shembull, Himara, në raport me banorët, ka të ardhura shumë të mëdha. Për shembull, një bashki tjetër që nuk ka resurse,

siç është Kukësi, sepse edhe atë tokë, që e ka pasur, ia ka zënë ai hidrocentrali, i cili nuk merr taksë kombëtare për zënie e tokës, për hapësirën. Si e ka zgjidhur Europa?! Bën një mesatarizim sa janë të ardhurat për 61 bashki, ose për 120 bashkitë, nëse do të bëhen. Sa janë të ardhurat për banor? Të gjitha bashkive, të cilat janë poshtë mesatares, u jepet një fond. Ne japim vetëm 1%. Po si ka mundësi një banor i Tiranës të marrë 1% si një banor, për shembull, në zonat më të larta, ose në një bashki që nuk ka resurse? Të gjitha vendet e Bashkimit Europian japin fondin e balancimit, por me një kusht që këto bashki të zbatojnë paketën fiskale dhe për diferencën që nuk e ka mbledhur, nuk i jepet, kurse pjesa tjetër të kompensohet nga buxheti i shtetit. Pra, siç i kemi paraqitur edhe akte ligjore, të cilat janë rrëzuar me forcën e kartonit, të mos jepet 1%, por të jepet 2% në fillim të vitit. Ky 1%-shi të jetë unik dhe 1%-shi tjetër të jetë për bashkitë, të cilat kanë nivel të ardhurash për frymë poshtë mesatares kombëtare.

Faleminderit!

Ervin Demo – Faleminderit!

Nuk dua t'i komentoj qëndrimet, edhe për shkak se ju keni qenë vetë ish-kryetar, dhe është normale që disa problematika i njihni me detaje, por mua më duhet të përsëris, dhe besoj se është e rëndësishme që, sidomos kur u referohemi të dhënave, shtrati që duhet të kemi këtu në komision, të jetë një shtrat unik dhe t'u referohemi gjithmonë të njëjtat burimeve. Besoj se me fillimin e punës, dhe unë do doja t'ju uroja suksese si komision, meqenëse është hera e parë që ka një dëgjese publike nga vetë komisioni, të gjitha materialet që do të vijnë, të jenë më të strukturuar për sa i përket referimit që gjithsecili bën në diskurs.

Më ngacmove pak me taksën e pronësisë. Unë jam totalisht dakord që taksa e pronësisë duhet të jetë, ndoshta, e ardhura kryesore në nivel vendor. Patjetër, këtu bashkitë kanë shumë hapësirë për t'u përmirësuar.

Besoj se gjatë vitit 2026 do të ketë një përmirësim të dukshëm. Është ndryshuar metodologjia e mbledhjes së kësaj takse nga ana e bashkive, ku ka një bashkëpunim më të ngushtë midis bashkive dhe drejtorive rajonale të tatim-taksave, po ashtu është mundësuar ndërthurja e sistemeve bashkë me ASHK-në, sepse kjo e lehtëson punën e bashkisë, për t'i evidentuar të gjitha pronat në territor. Besoj se kjo do të ketë një efekt, dhe është kalkuluar se efekti së paku për vitin 2026 do të jetë midis 2 deri në 4 miliardë lekë (vetëm për këtë vit) për të ardhurat lokale. Por do ta shohim, sepse kuptohet jemi akoma herët për 2026-ën, duhet parë deri në fund.

Për sa u përket kompetencave, aq më shumë qartësimi të kompetencave po ashtu, bie dakord me ju. Absolutisht, kjo është një mundësi shumë pozitive për pushtetin vendor për ta përdorur këtë platformë dhe për të adresuar disa prej shqetësimeve, të cilat janë ngritur gjatë

këtyre viteve të fundit. Nuk kemi arsye pse t'u fshihemi këtyre diskutimeve, as ne si ministri nuk e kemi këtë problematikë. Besoj se sa më i shëndetshëm të jetë procesi në komision, sa më gjithëpërfshirës të jetë (po ashtu, ju e përmendët vetë të dëgjohen kryetarët dhe jo vetëm, por edhe aktorë të tjerë lokalë), jam i bindur se më shumë do të kristalizohet nevoja që ka territori për sa u përket ndërhyrjeve, që mund të bëhen në kuadër të reformës. Unë e përsëris, dhe duhet ta nënvizoj këtë fakt, reforma nuk mund të perceptohet si një reformë që ka të bëjë vetëm me numrin, dhe këtu bie dakord me zotin Bozdo, që nuk është problemi bashki e madhe, bashki e vogël, sepse edhe në Europë kemi modele të ndryshme. Domethënë, ka vende të Bashkimit European që i kanë bashkitë më të mëdha; ka vende që kanë bashki shumë të vogla, por një gjë është e sigurt: trendi sot në Bashkimin European, në qoftë se merr 10 vjetët e fundit, çdo vend që i ka hyrë rrugës së reformës, ka qenë gjithmonë në ulje të numrit të bashkive, nuk janë shtuar bashkitë. Por, ky është diskutim që, për mua, është vetëm një pjesë e asaj çfarë duhet të diskutojmë në komisionin e posaçëm, dhe jam totalisht dakord që një pjesë e mirë e atyre shqetësimeve që ju ngritët, patjetër që do të adresohen gjatë komisionit.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Zoti ministër, po bëj një pyetje si anëtar komisioni tani.

Ju kërkoi ndjesë, por do t'i rikthehem një moment detyrës suaj të mëparshme si kryetar bashkie dhe besoj se ndoshta 2-3 prej çështjeve, që janë ngritur, do t'u jepte përgjigje pyetja.

Bashkia e Beratit gjatë kohës që ju e keni drejtuar, ka bërë një reformë të jashtëzakonshme me pastrimin. Berati, pa dyshim, ka qenë një qytet, i cili pas reformës që ju bëtë, ka qenë një ndër qytetet më të pastra në vend, në mënyrë të jashtëzakonshme. Domethënë, është një gjë që dallohet me sy qartësisht kur dikush e viziton qytetin. Nëse nuk gaboj, ju vendosët që ta kaloni shërbimin e pastrimit nga një shërbim i kontraktuar në një shërbim bashkiak. Dua të di si e ka impaktuar kjo numrin e stafit dhe logjikën e shpenzimeve operacionale, apo jo? Si reflektohet kjo në diskursin që ne po bëjmë deri diku, në raportin midis stafit, shpenzimeve operacionale dhe cilësisë së shërbimit?

Ervin Demo – Ju, me të drejtë, përmendët shërbimin e pastrimit, por jo vetëm, në fakt, ka disa bashki që shërbimin e pastrimit tashmë e kanë absorbuar si pjesë të strukturës bashkiake. Me thënë të drejtën, nuk diskutohet që unë mund flas gjatë për Beratin, por ka disa bashki në vend që, në fakt, kanë zgjedhur këtë rrugë për sa i përket menaxhimit të mbetjeve dhe, të jemi i sigurtë, ka rezultuar i suksesshëm në të gjitha bashkitë. Kur bashkitë e kanë marrë përgjegjësinë përsipër për ta vetadministruar këtë shërbim me burimet e brendshme, kuptohet që, rrjedhimisht, ka një impakt për sa i përket numrit të punonjësve, kostove që duhen mbuluar, qoftë edhe shpenzimeve operative e tjera me radhë. Çfarë mund të evidentojmë në

territor: dhe unë këtu nuk dua të ndalem vetëm te shërbimi i pastrimit, për shembull, një ndër shërbimet e para, që ne e absorbuam brenda strukturave të bashkisë, ka qenë shërbimi i trajtimit ushqimor, që bëhet për sistemin parashkollor. Ishte një proces i deleguar te palë të treta, ndërkohë që me të njëjtën kosto të kontratave që bashkia kishte me palë të treta, unë besoj se niveli i shërbimit dhe i cilësisë së ushqimit, sidomos për fëmijët, është shumë herë më i lartë. Ka modele të ndryshme, që mund të kenë implementuar bashki të ndryshme. Kuptohet, kjo vjen me një bar në letra, jo realisht sa i përket buxhetit të bashkisë, dhe në letra duket sikur bashkitë i kanë fryrë strukturat. Tani, unë nuk mund ta përgjithësoj këtë për të gjitha bashkitë, sepse duhet shikuar si kanë lëvizur stafet, ku kanë vajtur, ku janë alokuar, ka qenë shërbim pastrimi, ka qenë agjenci e shërbimeve publike e të tjera me radhë.

Megjithatë, në parim, unë mund të flas për disa raste. Berati është një prej këtyre rasteve, por jo vetëm. Bashkitë kanë observuar shërbime parësore që kanë ofruar në territor, siç mund të jetë pastrimi, por jo vetëm, duke marrë përsipër deridiku fryrjen ose rritjen e numrit të punonjësve në listëpagesat e bashkive, duke marrë përgjegjësinë direkte të shërbimit dhe të cilësisë së shërbimit që ofrojnë. Unë besoj se ky është modeli më i qëndrueshëm për sa u përket bashkive.

Këtu u përmend ideja e bashkisë qendër qarku, e bashkive më të vogla apo e bashkive më të mëdha. Unë besoj se një pjesë e sfidave që hasin bashkitë, janë të ngjashme. Në momentin që ne i kalojmë në një kategori më poshtë, ato mund të kategorizohen edhe sipas madhësisë, por ka disa sfida që janë strukturore, e këtu mund të flasim për kompetencat apo funksionet që mund të kenë bashkitë, por gjithashtu mund të ketë edhe elementë të veçantë, që lidhen sipas vetë specifikave që kanë bashkitë.

Arbjan Mazniku – Një pyetje të dytë, në lidhje me të njëjtën pikë, nëse mund të na ndihmoni me tabelën e shërbimeve.

Në raportin e fundit të performancës pashë se në lidhje me disa shërbime, si arsimi parashkollor, çerdhet, shërbimet sociale, mbrojtja nga zjarri, disa nga bashkitë kanë një raport të ulët të stafit e të mbulimit me njerëz. Fjala vjen, raportin fëmijë-mësues Bashkimi European e ka 12, 2, ndërsa disa nga bashkitë tona, veçanërisht bashkitë më të mëdha, e kanë të ulët këtë raport. Nëse ne do ta kapim këtë raport, për t'ia shpjeguar edhe publikut, pra nëse do t'i afroshim standardit european, kjo do të sillte rritje apo ulje të stafeve respektive të bashkive. Kjo vlen edhe për zjarrfikësit, vlen edhe për edukatorët e çerdheve, për ofrimin e shërbimeve sociale e kështu me radhë.

Ervin Demo – Në fakt, ka disa shërbime, nëse u referohemi standardeve të Bashkimit European, ku numri i njerëzve që kemi përgjithësisht në territor është më i ulët ose shumë më i

ulët. Rrjedhimisht, kuptohet se kjo afekton në dy drejtime. Së pari, mund të flasim për cilësinë e shërbimit, e së dyti mund të flasim për shtrirjen e shërbimit. Kur flasim për arsimin parashkollor, niveli i mbulimit të territorit, e aq më shumë përqindja e fëmijëve që shkojnë nëpërmjet shkollave publike, përsëri përqindja në BE është më e lartë se sa në realitetin tonë territorial. Gjithsesi, nëse i referohemi pyetjes së parë, unë besoj se disa prej shërbimeve, në rastin kur bashkitë i marrin vetë përgjegjësitë për t'i ofruar, ka rezultuar në territor se impakti ka qenë shumë pozitiv sa i përket cilësisë dhe shtrirjes së shërbimit në territor.

Kur flasim për standardet e BE-së, kemi shumë për të bërë. Kuptohet, unë nuk do të doja ta ngushtoja sfidën e kapjes së standardeve të BE-së vetëm në lidhje me stafin, por stafi është një ndër elementët që duhen përmirësuar.

Arbjan Mazniku – Faleminderit!

Nëse s'gabohem, zoti Dule ka një pyetje.

Vangjel Dule – Faleminderit, zoti bashkëkryetar!

Faleminderit, zoti Ministër!

Nuk doja t'ju zhgënjeja duke thënë se jam i zhgënjyer me prezantimin tuaj. E prisja ndryshe, dhe e prisja si ndërveprim. E konsideroja dhe e kisha konceptuar si një takim nxitjeje për një debat, i cili do të kërkonte disa seanca, që të mund të konkludonim bashkërisht e në mënyrë konstruktive. Por prezantimi juaj ishte shumë larg kësaj. Ishte verbalist, pa esencë, në linjë qeveritare dhe jo shtetërore. Sidoqoftë, besoj se të gjithë mund të korrigjohemi rrugës.

Nga ana tjetër, do të dëshiroja të shprehja edhe një zhgënjim tjetër në lidhje me të gjithë debatin. Me sa duket jemi shndërruar të gjithë në shumë monetaristë, në konceptimin tonë të gjërave. Më lejoni të përpiqem të bëj përjashtimin, duke u përqendruar në disa parime. Sipas këndvështrimit tim, një nga aspektet që ka dëmtuar reforma territoriale e vitit 2014, e implementuar në zgjedhjet e vitit 2015, e që shkakton cenimin e një të drejte themelore në shtetin e së drejtës e të demokracisë funksionale, është ajo e përfaqësimit.

Po prisja të dëgjoja ndonjë vlerësim apo studim në lidhje me përfaqësimin gjeografik, me përfaqësimin komunitar, pas reformës më të fundit territoriale. Në një masë të konsiderueshme empirike, përshtypja ime është se janë përjashtuar komunitete të tëra nga përfaqësimi qoftë edhe me një këshilltar të vetëm. Një rast që më vjen ndërmend, është se sa i përfaqësuar ndjehet komuniteti i ish-njësisë administrative të Paskuqanit, në këshillin e ri bashkiak të përbërë prej 61 anëtarësh të bashkisë së Tiranës.

Pse e them këtë? Ne nuk mund të ndryshojmë natyrën e politikës, pasi politika shkon pas votës, dhe hartohet duke pasur si kriter atë. Çdo kryetar bashkie shkon aty ku është numri

më i madh i votuesve. Aty jepen angazhimet më të mëdha, aty alokohen edhe fondet më të mëdha.

Pra, pyetja e parë: cenimi i kësaj të drejte themelore, që është ajo e përfaqësimit të qytetarit e të komunitetit, a e ka preokupuar në analizë Ministrinë e Pushtetit Vendor të Reformës Territoriale Administrative 2014? A ka propozime konkrete se si mund të korrigjohen këto në rastin e një reforme të re të mundshme, ose në tentativë, meqenëse kemi Komisionin e Posaçëm të një reforme të re territoriale administrative.

Pyetja e dytë: ju, zoti Ministër, vini nga radhët e pushtetit vendor. A e keni ndjerë veten autonom në ushtrimin e detyrës tuaj si kryetar i Bashkisë së Beratit? A e keni ndjerë se kolegët apo ish-kolegët tuaj janë autonomë në ushtrimin e detyrës së tyre, kur keni qenë dëshmitarë okularë i ultimatimit të prerë të kreut të qeverisë, në të cilën bëni pjesë, se duhej të ndryshonin kryetarët e bashkive në limitet kohore të përcaktuara rreptësisht prej tij? A e kanë respektuar këtë ultimatum kryetarët e bashkive? A keni ndonjë statistikë?

Pyetja e fundit: në raportin e Këshillit të Europës për Shqipërinë, në lidhje me respektimin e konventës kuadër për respektimin e të drejtave të pjesëtarëve të minoriteteve etnike, në vitin 2019, në ciklin e katërt të monitorimit, në opinion shprehet keqardhja për moskushtim të vëmendjes ndaj të drejtave të pjesëtarëve të minoriteteve në ndarjen territoriale administrative. Në rezolutën e vitit 2021 thekson se qeveria duhet të ulet me përfaqësuesit e minoriteteve etnike, që të shikojnë bashkërisht se cilat kanë qenë pasojat e reformës së vitit 2014 në lidhje me respektimin e të drejtave të tyre, e të ndërmarrin veprime korrigjuese.

Në ciklin e pestë monitorues, në qershor të vitit 2023, me opinion, dhe në tetor të vitit 2023 me rezolutë, shpreh keqardhjen se rekomandimet e Këshillit të Europës nuk janë marrë parasysh. Nëse i riktheheni rekomandimit, uluni me përfaqësuesit e minoriteteve, shikoni reformën territoriale 2014, se cilat kanë qenë pasojat negative dhe merrni urgjentisht masat korrigjuese. A e keni ndërmarrë një veprim të tillë konsultativ me minoritetet? A keni konkluduar se cilat janë aspektet dhe pasojat negative të reformës së vitit 2014? Nëse po, a do të na i bëni publike? Nëse jo, a keni ndërmend të ndërmerrni një cikël të tillë konsultativ në prag të reformës territoriale administrative, pavarësisht se çfarë do të bëjmë ne si Komision i Posaçëm Parlamentar?

Ju faleminderit

Arbjan Mazniku – Faleminderit!

Zoti Ministër, përpara se të jepni përgjigje, besoj se mund të bëjmë një pushim të shkurtër dhjetëminutësh, e më pas të rikthehemi për përgjigjet.

Dhjetë minuta pushim!

(Pas pushimit)

Arbjan Mazniku – Zoti Ministër, fjala për ju, në vijim të pyetjeve që bëri zoti Dule.

Ervin Demo – Pyetja e parë kishte të bënte në përfaqësimin në këshillat bashkiakë. Në fakt, modeli që ne përdorim në realitetin tonë ka të bëjë me vetë përgjegjësinë që kanë subjektet politike për të përfaqësuar zona të ndryshme elektorale gjatë procesit të zgjedhjeve vendore. Që të jem i sinqertë, në lidhje me ato zona për të cilat unë jam në dijeni, është në interesin e subjekteve politike për të pasur përfaqësim të territorit gjatë proceseve zgjedhore. Sepse është krejt e logjikshme që një pjesë e territorit, në momentin që nuk e gjen veten të përfaqësuar, nuk ka pse të votojë një prej anëtarëve të këshillit bashkiak. Gjithsesi, kjo mbetet ende në diskrecion të partive politike. Në lidhje me pyetjen, që është relativisht personale, se sa jam ndierë unë autonom në kryerjen e detyrës sime si kryetar i Bashkisë së Beratit për një periudhë 6-vjeçare, që të jem i sinqertë, patjetër, në terma të përgjithshëm ne e kemi pasur të gjithë lirinë për t'i drejtuar këto institucione sipas interesit publik dhe ashtu siç e gjykon vetë struktura ose subjekti politik që është zgjedhur për të drejtuar një bashki e gjykon. Po ashtu, unë jam dëshmitar që ka elemente që duhen përmirësuar si pasojë e një periudhe 10-vjeçare, ku të gjithë ne kemi nxjerrë mësim nga reforma që u implementua në vitin 2015, dhe disa prej tyre prekëm edhe më parë.

Për sa i përket respektimit të të drejtave të minoriteteve, që të jem i sinqertë, të paktën me informacionin që kam unë, dhe këtu duhet të jem shumë i kujdesshëm, jemi të gjithë në dijeni që ne kemi tre bashki në vend që janë bashki minoritare, Bashkia Finiq, Bashkia Dropull dhe Bashkia Pustec, ku, patjetër, aty respektohen të gjitha të drejtat, duke përfshirë edhe procesin mësimdhënës në gjuhën përkatëse. Por, gjithsesi, ne jemi të hapur për të qenë të kujdesshëm, për të lexuar çdo raport dhe për të ndjekur atë çfarë është e rëndësishme për sa i përket garantimit të të drejtave të gjithë qytetarëve shqiptarë.

Ndërkohë, jam po ashtu i bindur që vetë komisioni do të jetë absolutisht i vëmendshëm për sa i përket marrjes në konsideratë të shqetësimeve që vijnë nga të gjitha grupet e interesit dhe, patjetër, minoritetet në Shqipëri janë një grup interesi shumë i rëndësishëm për të gjithë ne. Këto ishin katër pyetjet.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Faleminderit, zoti ministër!

Fjala për zonjën Bylykbashi.

Aulona Bylykbashi – I nderuar zoti ministër, unë kam disa pyetje.

E para, si ka ndryshuar performanca financiare e bashkive në krahasim me vitin 2015 dhe vitin 2024, duke e marrë këtë vit si referencë për raportet financiare? Kjo duke u bazuar në aspektin e detyrimeve të bashkive në raport me të ardhurat. Në këtë pikë: a keni ju të dhëna që

tregojnë se detyrimet e bashkive në vitin 2015 nga cilat zëra vinin? Pra, ishin ato të ndikuara në masë nga detyrimet e mbartura dhe nga ish-komunat?

Pyetja tjetër: si ka ndryshuar shtrirja e shërbimeve dhe investimeve kapitale në zonat periferike, apo në pjesën më të madhe të territorit, përfshirë zonat rurale? Në opinionin tuaj, cilat janë ato funksione që ju i cilësoni sot si më të domosdoshme për t'u mbajtur nga njësitë administrative?

Faleminderit!

Ervin Demo – Unë përmenda disa prej treguesve financiarë, që qartazi tregojnë përmirësim të situatës në nivel vendor. Nëse i referohemi pikës së fundit që ngritët për sa i përket borxhit ose detyrimeve të prapambetura që bashkitë kanë, ato janë ulur nga vlera që ishte në 2015-ën, prej 12 miliardë lekësh, në rreth 3 miliardë lekë. Qartazi ka një konsolidim financiar për sa u përket buxheteve vendore.

Në të njëjtën kohë do të më duhet të përmend që për sa u përket të ardhurave vendore ndaj të ardhurave publike, po ashtu janë rritur nga 3% në 6%. Të ardhurat vendore në raport me prodhimin e brendshëm bruto janë rritur nga 1% në 2%. Gjithashtu, është e rëndësishme të nënvizoj këtë fakt: një ndër treguesit, që gjithmonë është përmendur si pjesë e barrës financiare që sjellin burimet njerëzore në nivel vendor, është ulur nga 70% në 44% në rang vendi. Patjetër, mund të kemi raste specifike, bashki më bashki, por si mesatare në rang kombëtar, nëse krahasojmë të dhënat e 2015-ës me ato të 2025-ës, kjo shifër është ulur nga 70% në 44%.

Për sa i përket shtrirjes së investimeve kapitale, që të jem i sigurtë, edhe në këtë këndvështrim bashkitë kanë bërë shumë, sidomos kur flasim për infrastrukturën bujqësore. Ne sot në territor, edhe sipas statistikave që janë grumbulluar, sidomos për kanalet dytësore dhe të treta në nivel vendor, bashkitë kanë kapacitete të shtuara për t'i mbuluar këto lloj shërbimesh për sa i përket infrastrukturës bujqësore.

Po ashtu edhe investimet e qeverisë qendrore, që kanë sjellë përfitime për bashkitë dhe qytetarët në nivel lokal, janë shtuar në mënyrë të ndjeshme.

Do të doja përsëri të nënvizoja faktin, që e përmenda pak në fjalën hapëse: se për sa i përket rolit të njësive administrative, unë besoj se ka ende hapësira për mënyrën se si vetë bashkitë organizohen brenda strukturës së tyre. Njësitë administrative mund të kenë një peshë më të madhe në territor, ku edhe një pjesë e shërbimeve brenda bashkive mund të delegohen te njësitë administrative. Nëse kjo do të bëhej dhe do të ishte pjesë e reformës territoriale, duke e parë edhe nga një këndvështrim rregullativ, patjetër, do të ishte e mirëpritur, sepse ne besojmë që, aty ku është e mundur, patjetër, shërbimet duhet të jenë sa më pranë qytetarit.

Faleminderit!

Aulona Bylykbashi – Në raport me këtë të fundit, mendoni se janë kryesisht funksione planifikuese, apo shërbime të drejtpërdrejta?

Ervin Demo – Gjithmonë bëhet fjalë për shërbime të drejtpërdrejta. Planifikimi, patjetër, do të jetë i unifikuar në nivel bashkie, ndërsa ekzekutimi, për të qenë më pranë qytetarit, mund të jetë një mekanizëm që mund të studiohet edhe duke parë kapacitetet që kanë sot bashkitë, por pse jo, edhe nga pikëpamja rregullative, që mund ta shikojë komisioni.

Arbjan Mazniku – Zoti Nallbati.

Bledjon Nallbati – Faleminderit!

Atëherë, zoti ministër, dëgjova parashtrimin tuaj në lidhje me sukseset që pati reforma e 2014-ës, po ashtu edhe sukseset që do të prodhojë reforma e re, sidomos në qoftë se ecim në drejtim të zmadhimit të bashkive dhe uljes së numrit të njësisive të vetëqeverisjes vendore.

E pashë atë librin e kuq të bukur, dhe me thënë të drejtën, edhe këto pamjet që na nxirrni këtu në këto ekrane se si qeveria e një piktori, për të bërë kështu fasada të bukura jeni mjeshtër, i qani domethënë. Jeni mjeshtër për të bërë të bardhën të kuqe dhe të zezën mavi, por realiteti është krejt ndryshe nga ato që paraqiten këtu dhe nga ato që ju parashtruat.

Unë kam një pyetje të thjeshtë, duke pasur parasysh që synimi dhe objektivi ynë, i udhëheqësit të padiskutueshëm, është Europa, Bashkimi European. More, kaq budallenj janë këta europeanët?! Kaq budallenj janë këta gjermanët, francezët, zviceranët, italianët, si nuk e kanë kuptuar këta që t'i zmadhojnë ato bashkitë e tyre, t'i shkrijnë ato njësitë vendore që i kanë me mijëra e me mijëra, dhe t'i bëjnë me modelin që i sugjerojmë ne?! Se ne do të shkojmë tek ata, por në qoftë se këta qenkan kaq budallenj dhe nuk dinë, çfarë duam ne në Europë?! Le t'i thërrasim ata të vijnë te ne!

Po nuk ka nevojë që ju të shpikni rrotën dhe as ne bashkë të shpikim rrotën; ka nevojë të marrim modelet, të përshtatim modele të suksesshme, ato të Bashkimit European, për të cilat ne aspirojmë dhe në çdo dalje publike apo në çdo takim, apo në çdo diskutim, e kemi retorikën: “Europa, Europa, Europa, Bashkimi European, Bashkimi European”. Hajdeni të shkojmë te standardet e Bashkimit European, të marrim modelet e Bashkimit European. Cilat janë modelet që ju u referoheni kur thoni që bashki më të mëdha janë më të suksesshme? Cilat janë këto vende të Bashkimit European, që e kanë këtë model? A të marrim, për shembull, Francën? Ka njësi me 700 banorë. Të marrim Italinë, Zvicrën? Po flasim për vendet më të përparuara në Europë, vende model të zhvilluara ekonomikisht, me shërbime shumë cilësore dhe trajtime shumë të mira ndaj qytetarëve. Si ka mundësi që për këta nuk funksionon, kurse te ne do të funksionojë? Kur dihet që garancitë në këto vende janë shumë më të mëdha, e megjithatë ato e

mbajnë shërbimin sa më pranë qytetarit dhe e mbajnë të zgjedhurin sa më të prekshëm nga votuesi i tij, në mënyrë që problematikat dhe shërbimet të jenë më të zgjidhshme.

Ne do t'ia çojmë kryetarin e bashkisë, po them, ku di unë, një bashkëqytetarit tim të Nikolicës në Korçë. Ai ka vështirësi sot në Bilisht, në Devoll, ta takojë dhe të gjejë zgjidhje për problematikat e veta. Po t'ia çojmë në Korçë e ka zero mundësinë që ta adresojë atje ku duhet.

Ju keni qenë kryetar bashkie dhe e dini mirë që për një problematikë, sidomos kur bëhet fjalë për çështje infrastrukturore, po nuk i shkeli këmba kryetarit të bashkisë, nëse ajo problematikë nuk bëhet shqetësim i kryetarit të bashkisë, le të jetë shqetësim i kryeplakut, i administratorit, i punonjësve, i kujtdo, nuk gjen kurrë zgjidhje. Kur bëhet shqetësim i kryetarit të bashkisë, dhe përsëri është e vështirë, sepse do të duhet të garantojë fondet, që në shumë raste nuk i ka në bashki, dhe do të duhet t'i garantojë në qeverisjen qendrore, por po nuk u bë shqetësimi i kryetarit të bashkisë, nuk ka shanse që të gjejë zgjidhje. Dhe ne po themi që këtë kryetarin e bashkisë ta çojmë sa më larg, t'ia zgjerojmë territorin dhe t'ia bëjmë sa më të pamundur për ta prekur në mënyrë konstante dhe periodike, dhe do të gjejmë zgjidhje.

Unë kam një pyetje të drejtpërdrejtë për ju: sa herë gjatë mandatit tuaj 6-vjeçar keni vizituar fshatin Dardhë, ish-komunën Roshnik apo Malinat? A keni pasur ju të njëjtën vëmendje për këto fshatra, apo për banorët e këtyre fshatrave, njësoj si për qytetin, apo për njësitë që keni pasur rreth e rrotull? Doni t'ju flas edhe unë si ish-kryetar bashkie? Jo, unë nuk kam pasur mundësi ta kem të njëjtën vëmendje, të njëjtin interes për të zgjidhur problematikat e qytetit, njësoj me ato që kisha për dy fshatrat që përmenda, të Sinicës dhe të Vidohovës, se nuk kisha mundësi ta kisha të njëjtë.

Të gjithë ata që kanë qenë kryetar bashkie, e dinë mirë se kjo është e vërteta. Nëse nuk e pranojmë, kjo pastaj është histori tjetër, por e vërteta është kjo. Nuk ka shans të kesh të njëjtën vëmendje për të zgjidhur problematikat e zonave rurale.

Çfarë ka prodhuar kjo reformë? Ne jemi të gjithë dëshmitarë se çfarë efekti...

Kam edhe një pyetje tjetër. Pra, po e bëj diskutimin, por njëkohësisht do të bëj edhe pyetje herë pas here, ndaj mbajini shënim dhe më ktheni përgjigje.

A keni ndonjë analizë se çfarë efekti prodhoi reforma territoriale e vitit 2014, në shpopullimin e zonave rurale të Shqipërisë? Unë e kam parë me sytë e mi dhe e kam përjetuar shpopullimin në zonën time. Edhe pse nuk është ndonjë bashki shumë e madhe, shpopullimin e fshatrave e të zonave rurale e kam përjetuar dhe sot diferenca është shumë e madhe.

Ju thonë se janë rritur me 166% të ardhurat vendore. Po në kurriz të kujt? Sa për qind janë rritur taksat, para se të bëhej reforma e vitit 2014 e deri më sot? Ne e kemi kollaj, mund të

çojmë edhe 1 milion për qind rritjen e të ardhurave të bashkive! Nëse ua kërcasim kurrizit (se nuk do të flas me shumë diplomaci apo me fjalë të mëdha, por do të flas popullorçe, që të na dëgjojnë qytetarët, se, në fund të fundit, kjo mbledhje bëhet për ata) taksat dhe tarifat qytetarëve dhe nga iks lekë i bëjmë me herë 1 milion, patjetër që rriten të ardhurat për institucionin, por ua marrim shpirtin qytetarëve!

Ju thoni se janë rritur dhe shumëfishuar të ardhurat e njërive vendore, por, kur kemi pasur kaq bollëk të ardhurash, pse nuk janë përkthyer në investime në zonat rurale, në ekonomi më të mirë për këto zona, në qëndrueshmëri dhe në popullim?! Përkundrazi, ato janë përkthyer në shpopullim dhe në largim masiv.

Shoh këtu një tabelë në të cilën flitet për ujësjellës-kanalizimet dhe se Tirana është më e avancuara në furnizimin me ujë. Po Tirana është pa ujë e gjitha! Çfarë i keni këto?! A ka ndonjë qytetarë të Tiranës që nuk e di se furnizimit me ujë të pijshëm është katastrofë?! Ju thoni se Bashkia e Tiranës është bashkia më e madhe dhe më e fuqishme e Shqipërisë, por Tirana nuk ka ujë, është katastrofë për sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm! Ja, pra, ky është modeli i bashkive të mëdha!

Ndërkohë që në bashkitë e vogla, kryetarët e bashkive apo kryetarët e komunave nuk i zinte gjumi, nuk i linin njerëzit rehat, se u rrinin te dera dhe u thoshin: kryetar, nuk kemi ujë, këtu nuk ke shans të trokasësh, nuk ke shans ta gjesh kryetarin e bashkisë dhe nuk ke shans ta adresosh problematikën.

Sa shkolla janë mbyllur, jo në zonat periferike të Shqipërisë, por në fshatrat e Tiranës? Në sa shkolla në fshatrat e Tiranës bëhet mësim kolektiv?

Arbjan Mazniku – Ju kërkoi shumë ndjesë, por...

Bledjon Nallbati – Pyetje po bëj.

Arbjan Mazniku – Është shumë normale që çdonjëri të ketë regjistrin e vet, por ne mund të bëjmë një seancë, kur të doni ju, nesër ose pasnesër, ku çdonjëri të shprehë mendimin e tij, por nëse kemi thirrur ministrin, do të ishte e arsyeshme që të gjenim një proporcion të kohës kur bëjmë pyetje dhe retorikës së diskutimit të përgjithshëm. Nuk ka problem, kur të doni mund të bëjmë një mbledhje, ku të mbajmë referate me 3, 4 apo 5 orë dhe çdonjëri...

Bledjon Nallbati – Më shumë kohë më more ti me diskutimin sesa fola unë.

Arbjan Mazniku – Jo, se e kam matur, janë bërë 16 minuta që jeni duke folur. Gjëja më e arsyeshme është të bëjmë pyetjet, siç bëri 5 pyetje zonja Jorida dhe mori përgjigje, pastaj bëri 5 pyetje të tjera, nuk ka problem, mund të bëni 25 pyetje...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, të bëhen pyetje dhe të merren përgjigje. Por, nëse duam të bëjmë fjalime, më mirë të lëmë një seancë tjetër...

Bledjon Nallbati – Dakord.

Edhe një gjë të fundit dhe po e mbyll, pastaj do të pres përgjigje.

U bë një reformë në lidhje me ujësjellës-kanalizimet (po i referohem asaj bashkie që e njoh më mirë, e cila më dhemb më shumë se çdo gjë tjetër), dhe ndërmarrja e ujësjellës-kanalizimeve të Devollit iu bashkua ndërmarrjes së madhe e të fuqishme rajonale të Korçës, edhe pse ndërmarrja e asaj bashkie performonte, dilte me fitim dhe nuk kishte pse tarifa e ujit, që paguajnë qytetarët e Devollit, të shkonte në buxhetin e sh.a.-së së madhe rajonale, sepse sot, nëse ndodh një defekt në një fshat të Devollit, duhet një javë, me shkresa, të merret vesh institucioni me institucionin dhe pastaj të fillohet të mendohet për zgjidhjen, ndërkohë që e kishin zgjidhjen emergjente.

Nëse këto njësi administrative do të shkrihen, taksat dhe tarifat që paguajnë sot devollinjtë, do të shkojnë në buxhetin e Bashkisë së madhe të Korçës.

Dhe ju po më thoni se Raqi, apo kushdo tjetër që është pas tij, kur të bëjë shpërndarjen e buxhetit, do të ketë prioritet Sinicën apo Vidohovën e Devollit?! Jo, zero!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ti je Raqi?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të mbaroj unë dhe pastaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mendova se mos ishe mëkëmbësja e Raqit.

Pra, ju po më thoni...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A ta mbaroj unë apo...?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Faleminderit!

Pra, ju po më thoni se Raqi, apo kushdo që vjen pas tij, do të shqetësohet për këtë dhe taksat që kanë paguar qytetarët e Devollit do t'ua kthejë?! Jo, jo, do të kenë përparësi problematikat që ka qyteti i Korçës, problematikat që kanë njësitë rreth qytetit, se ata do t'i qëndrojnë te dera dhe nga ata e ka presionin më të madh. Pra, atje do të shkojnë ato taksa. Kjo do të thotë t'ua vjedhësh paratë atyre, t'ia çosh dikujt tjetër, duke i shpërndarë ashtu si do ai, dhe t'ua largosh njëherë e mirë shërbimet këtyre njerëzve, duke u thënë: ikni me vrap nga këto

zona dhe shkoni të jetoni në Korçë! Pra, Shqipëria do të përbëhet nga Korça (deri diku, se edhe ajo po shpopullohet), Elbasani, Tirana, Fieri, Durrësi dhe kaq.

Këto kisha për momentin, meqë kemi të ndaluar të zgjatemi shumë. Në fazën tjetër, do të vazhdojmë përsëri.

Arbjan Mazniku – Fjala për ju, zoti Demo.

Ervin Demo – Nuk dua të komentoj qëndrimet, por do të përpiqem të nxjerr disa pyetje nga diskutimi.

Së pari, kur flasim për modelet, dua të them se ka modele të ndryshme në Bashkimin Europian, ndaj nuk duhet të ngatërrohemi, edhe kur flasim për sisteme që kanë disa nivele në territor.

Bashkitë e vogla, me disa qindra banorë, që ju i përmendni, nuk i kanë funksionet që ne po diskutojmë, të paktën në realitetin tonë. E para.

E dyta, nëse doni t'u referohemi rasteve në Bashkimin Europian, për shembull, Danimarka, në reformën e fundit, nga 271 kaloi në 98...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, meqenëse do raste.

Kemi Estoninë, që nga 213, kaloi në...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Arbjan Mazniku – Të lutem, zoti Nallbati!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo, të lutem, zoti Nallbati! Fole...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka rëndësi, por ti fole gjatë gjithë kohës...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ta bëjmë me radhë, të flasë ministri, ta mbarojë fjalën që ka për të thënë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A e dini se sa herë mund të kisha ndërhyrë gjatë fjalës suaj, se kam opinion të ndryshëm nga ai që thatë ju? Ministri nisi të thotë një argument, se ka një opinion, ndaj lëreni të mbarojë, se edhe ju folët sa deshët...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po flasim për çështje procedure dhe për të respektuar njëri-tjetrin kur flasim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Folët sa menduat se ishte e arsyeshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër, thjesht të mos e bëjmë më dhe ta vendosim si rregull.

Fjala për ju, zoti ministër. Ju kërkoj ndjesë!

Ervin Demo – Nuk do të doja të ishim absolutisht në qasje...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

U mundova të isha shumë i kujdesshëm, kur iu referova disa treguesve që janë gjetje në raport, konstatime...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ke edhe një të bardhë, varet se cilën ngjyrë preferoni, por kjo e kuqja është e 25-s.

Pra, dua t'u qëndroj gjetjeve. Që në fillim e bëra të qartë se nuk do të doja të mbaja qëndrim sot, se nuk po flasim për modele. Unë nuk kam ardhur këtu, si përfaqësues i qeverisë, për të thënë: ky është modeli që duhet të bëjmë; jo. Besoj se, si partnerët tuaj në këtë proces, ne do të bëjmë çmos, me aq sa kemi mundësi dhe me aq kapacitete sa ka mundësi ministria, duke përfshirë edhe gjetjet, edhe raportet e ndryshme që janë prodhuar, të ndihmojmë komisionin në këtë proces, gjatë rrugëtimit të vet, që të dalë me një produkt, i cili i referohet realitetit, bazuar në këto studime.

Arsyeja pse nuk dua t'u referohem modeleve të ndryshme është se Europa ka modele nga më të ndryshmet dhe secili prej nesh mund të marrë si shembull një vend dhe të thotë: ky është modeli që dua unë. Por nuk besoj se kjo është aq e lehtë, sepse modelet kanë shumë specifika dhe lidhen ngushtë edhe me territorin. Nëse themi se bashkitë të mëdha nuk funksionojnë, po ato bashki, në Europë, që kanë disa miliona banorë, si ia bëjnë? Pra, nuk duhet të diskutojmë nëse është bashki e vogël apo e madhe.

Meqenëse më bëtë një pyetje personale për Qafë Dardhën, dua t'ju them se, jo vetëm kam qenë, por ne kemi përfunduar rrugën e Qafë Dardhës, e cila është një zonë e jashtëzakonshme, kur isha kryetar bashkie.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Rrugën që shkon në Qafë Dardhë, meqenëse më pyetët nëse kam qenë në Qafë Dardhë apo jo. Më vjen mirë që e keni evidentuar, sepse është një zonë e jashtëzakonshme.

Në mbyllje, zoti Nallbati, dua t'ju them se patjetër që censusi ka bërë një analizë të situatës demografike, se si është gjendja në territor sot dhe censusi atë e tregon më së miri. Nëse duam, patjetër ne mund të nxjerrim edhe krahasime me censusin e fundit, të bërë në vitin 2011. Kjo është arsyeja pse censuset bëhen çdo 10 vjet. Besoj se patjetër është shumë e vlefshme për Komisionin që të dhënat e censusit apo të dhënat e ndryshme demografike që mund të merren qoftë edhe nga Instat-i janë shumë të rëndësishme për punën e Komisionit. Po ashtu, ne jemi të gatshëm t'i vendosim në dispozicion të dhënat që kemi nga rrugë të tjera, por

besoj se censusi është absolutisht fotografia më reale e asaj që ne kemi sot në territor, aq më shumë që ne mund të bëjmë një krahasim për një periudhë 10-vjeçare, pak a shumë.

Ndërkohë, sa u përket ndërmarrjeve të ujësjellësve, po, ka ndodhur një reformë në territor. Bashkitë vazhdojnë të jenë pjesëmarrëse në kompanitë rajonale me një përqindje të caktuar të aksioneve. Kuptohet që qasja, sa i përket reformës në këtë sektor, ka qenë përsëri për të krijuar shkallë në të gjitha institucionet ose më saktë në të gjitha sh.a.-të që ekzistojnë në territor dhe kaluan në skemën nga 50 kompani, nëse nuk gaboj, në 15 kompani në nivel kombëtar që janë tani, të bazuara përgjithësisht në nivel qarku, ku dhe vetë bashkitë janë përsëri pjesë e tavolinës vendimmarrëse, ku caktohen investimet e të tjera me radhë, në secilën prej ndërmarrjeve të ujësjellësve rajonale ose atyre të qarqeve.

Ndërkohë, sa i përket rritjes së të ardhurave, patjetër nuk mund të mohohet që një nga arsyet pse rriten të ardhurat është edhe rritja e tarifave në nivel lokal, por kjo nuk do të thotë që është e vetmja, ka edhe arsye të tjera. Nuk mund të themi që kjo është arsyeja kryesore, do ta marrim bashki për bashki, sepse panorama ndryshon shumë nga një bashki në një tjetër, por e sigurt është që nuk është e vetmja.

Faleminderit!

Bledion Nallbati – Dua të bëj një ndërhyrje të vogël, meqë më ndërhyre nja dy herë.

Arbjan Mazniku – Jo, unë nuk të ndërhyra.

Bledion Nallbati – Atëherë, zoti Ministër, në Europë more për referencë vetëm vendet nordike që janë komplet tjetër gjë në standard. Nëse ne pretendojmë që jemi në ato nivele, nuk kemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nëse themi se do të shkojmë në Europë, atëherë të shikojmë se sa vende anëtare ka Europa dhe sa për qind e këtyre vendeve janë kështu siç themi ne dhe sa për qind janë ashtu siç thoni ju. The që nuk erdhët këtu të mbani qëndrim për një model dhe kështu, siç ka thënë Pjetri i shkretë, nuk jeni socialistë, por specialistë, sepse me të vërtetë nuk mbajte qëndrim për një model, por erdhe dhe na folë për faktin se sa mirë e sa bukur performojnë bashkitë e mëdha, nuk na the asgjë tjetër, as se sa problematika kanë bashkitë e mëdha. Meqë e kishe bërë këtë rrugën, kam një pyetje: sa mban nga ky fshati deri në Berat?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po. Sa larg është me rrugën e re?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, 38 minuta. Ky ishte kuriozitet personal.

Arbjan Mazniku – Këtë mund ta gjejmë edhe në *Google*.

Zonja Budini, keni fjalën.

Etleva Budini – Në fakt, unë nuk kam pyetje, por thjesht një koment. Për të disatën herë në këtë Komision kam dëgjuar diskutime të ish-kryetarëve të bashkive. Kam respekt maksimal për punën e tuaj, sepse nuk është e lehtë të ulesh në karrigen e një kryetari bashkie. Unë nuk e kam bërë këtë dhe nuk mund të flas dot për punën tuaj, por mua më bën përshtypje që në këtë epokë të digjitalizimit, për të cilën po flasim përditë, apo të zhvillimit galopant të teknologjisë, ne vazhdojmë të themi: ke shkuar ti atje; unë nuk kam shkuar dot në dy fshatra me 30 banorë. Kështu që, në gjykimin tim, unë nuk kam qenë kryetare bashkie, por kam qenë drejtuese ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Arbjan Mazniku – Të lutem, zoti Nallbati, të mos flasim mbi njerëzit e tjerë! Të lutem, mos flisni kur flasin anëtarët e Komisionit!

Etleva Budini – A mund ta mbaroj gjykimin tim? Unë do të flas për kultin e individit. Pa dashje, ne kemi krijuar kult të individit.

Arbjan Mazniku – Ju folët sa deshët. Tani që e mbaruat fjalimin, të flasë tjetri. Mbani shënime dhe, kur të mbarojë, flisni ju sa të doni.

Etleva Budini – Unë jam në pozita të barabarta me të gjithë ju, deputetë ju, deputete unë. Gjykimi im është që kemi ngritur kult individit dhe kjo nuk ka ndodhur vetëm me bashkitë e vogla. Ndodh edhe me një bashki të madhe, jo si Tirana, në të cilën, pa shkuar kryetari i Bashkisë, nuk zgjidhet asgjë. Është krijuar perceptim te qytetarët që duhet të shkojnë të trokasin te dera e kryetarit të Bashkisë. Kemi ngritur kult individit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.) në vitin 2026 sot

Mendimi im, gjykimi im, është që nuk ka delegim funksionesh, nuk funksionon struktura. Nuk e kam shpikur unë digjitalizimin, por e shoh si mungesë organizimi dhe sot jemi pa *email*-e. Mua nuk më pëlqen që në epokën e digjitalizimit, në vitin 2026, ne diskutojmë akoma: nuk ka shkuar kryetari i Bashkisë, nuk trokita dot, nuk ma hapi derën, nuk më priti. Pra, kemi ngritur kult individit. Kjo epokë duhet të mbarojë dhe kjo mbaron me bashkitë e mëdha, ose rajone, ose si të doni ju. Ky është gjykimi im.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo, kjo nuk është vijë politike, madje është “*regione*” si në Itali. Ky është gjykimi im.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Po.

Ramadan Likaj – Përshëndetje të gjithëve!

U bënë më shumë se 4 orë dhe sigurisht letra e shifra kemi sa të duash këtu, nëse do t'i hapim, fakte po ashtu, për dështimin real të kësaj reforme. Bashkohem 100% me ministrin, me fjalën e tij hapëse, ku iu shmang totalisht faktit që kjo është një reformë e dështuar. Të falënderoj shumë! The: jam këtu për të lexuar raportin e këtyre viteve, se si janë monitoruar dhe si janë rritur shpenzimet në mënyrë të jashtëzakonshme, duke e krahasuar me periudhën përpara vitit 2014.

Si ish-kryetar bashkie, kolege, të falënderoj për ato që the, por një kryetar bashkie është shumë më i qartë, shumë më i qetë dhe shumë më reflektues në fjalën e vet në këtë Komision, në një kohë kur shqiptarët na dëgjojnë të gjithëve. Unë nuk mund të tregohem joracional për të bërë retorikë politike në një moment të caktuar, sepse ne kemi përgjegjësi për ato që themi. Sigurisht, përgjegjësinë më të madhe e kemi ndaj qytetarëve që na dëgjojnë.

Unë do të jem shumë konkret, zoti Ministër, si ish-kryetar bashkie. Në zonën time ka pasur 5 komuna dhe 1 bashki. Ne duhet t'i themi gjërat ashtu siç janë, nëse duam të jemi racionalë me veten dhe nëse ky Komision është serioz në punën e tij. Shërbimet duhet të shkojnë te qytetari. Unë kam qenë kryetar bashkie deri në vitin 2015. Përpara vitit 2014 ka pasur një performancë komplet tjetër zona ime, ka pasur investime edhe në komuna dhe ka pasur një konkurrencë të jashtëzakonshme. Çdo kryetar komune ishte real dhe kërkonte me çdo kusht investime për zonën e tij. Në atë kohë mund të them që fshatrat ishin të populluara. Pas kësaj reforme ndodhi ajo që ndodhi, pra shpopullim i jashtëzakonshëm, fshatra të braktisura dhe, më e rëndësishmja, vetëm në zonën time mund të jenë mbyllur mbi 23 shkolla. Pyetja ime e parë për ju është: a mendoni ju, si kryetar bashkie, se kjo reformë ka dështuar? Gjithashtu, a mendoni se sot duhet të krijojmë shumë më shumë bashki për t'u shërbyer qytetarëve? Besoj se këto janë pyetje efikase, të prekshme. Nëse ne do t'i çojmë shërbimet te qytetari, kjo gjë duhet të bëhet sa më shpejt. Sot nuk duhet të jenë 61 bashki, por të paktën 100 bashki, për ta bërë efikase një gjë të tillë.

Pyetja tjetër është: si Ministër, si e mendoni ju riorganizimin rajonal, pra me rajone? Cili është mendimi juaj, sepse është e rëndësishme edhe kjo pyetje?

Sa për mbyllje, pa diskutim bashkëkryetarët duhet të falënderojnë të gjithë ekspertët e të dyja palëve dhe mendoj që, nëse e kemi seriozisht, ne duhet t'u japim rëndësi atyre. Duhet të bashkëpunojmë me njëri-tjetrin, të jemi të gjithë së bashku në terren dhe t'u japim shqiptarëve një reformë të cilën e presin realisht të gjithë.

Sa i përket mendimit tim personal, si ish-kryetar bashkie, unë jam për bashki më të vogla për t'u shërbyer qytetarëve. Ne duhet të jemi të gjithë bashkë në terren, për të parë se sa do të jetë ky numër, të marrim edhe mendimet e qytetarëve, edhe të ish-kryetarëve të bashkive,

edhe ish-kryetarëve të komunave, sepse është shumë e rëndësishme, edhe ish-këshilltarëve në komuna dhe pastaj ekspertët e të dyja palëve, së bashku me këtë Komision, t'i mbledhin të gjitha këto mendime së bashku, të ulemi dhe të arrijmë në pikën përfundimtare për t'u dhënë shqiptarëve një ndarje të re territoriale reale, në shërbim të qytetarëve.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Faleminderit!

Ervin Demo – Faleminderit!

Po jap përgjigje shumë të drejtpërdrejta, absolutisht jo, reforma e vitit 2014, e cila është implementuar në vitin 2015, është shumë larg të përdorurit të shprehjes: ka dështuar.

Unë mendoj se ajo reformë ka dhënë rezultatet e veta. Kjo është mjaftueshëm e dukshme në rezultat që ne kemi sot. A është kjo e mjaftueshme për atë që ne presim për nesër? Kjo është një pyetje që ne duhet ta analizojmë të gjithë me shumë kujdes.

Unë besoj që komisioni është shumë i përqendruar për të ndërtuar ose për të pasur modele në tavolinë, të cilat adresojnë jo thjesht problemet e së shkuarës, por, mbi të gjitha, të së ardhmes. Prandaj, unë jam i bindur që, kur ne flasim për reformën e vitit 2015, kemi shumë mësim për të nxjerrë, por ajo ka qenë absolutisht një reformë që i ka dhënë një hov tjetër organizimit në territor.

E thashë dhe më parë, nuk ka reformë perfekte, sepse nuk ka njerëz perfektë. Prapë ky do të jetë një produkt i të gjithëve. Ne duhet të bëjmë më të mirën, që të kemi një reformë e cila realisht adreson edhe shqetësimet tuaja, si ish-kryetarë bashkie. Ky është roli i komisionit ,dhe ne do të jemi këtu për të bërë çfarë na takon, për të ndihmuar komisionin në një produkt, por, mbi të gjitha, për ta përkthyer dhe implementuar atë, ashtu siç është menduar gjatë produktit final.

Për sa u përket shërbimeve, nuk duhet detyrimisht ta lidhim ofrimin e një shërbimi me territorin e një bashkie, sepse bashkia mund të ketë forma organizimi të ndryshme brenda territorit të saj. Në ndarjen territoriale që ne kemi sot, njësi administrative ka edhe një lidhje tradicionale me atë çfarë është, ka qenë edhe tradita në territor, edhe fshatrat që kanë të bëjnë me njëri -tjetrin dhe me radhë. Unë përmenda dhe më parë që ka vend për të parë mundësinë si ne duhet të kemi një riorganizim të brendshëm të bashkive, për të pasur shërbime sa më pranë qytetarit. Kjo është e saktë, dhe nuk ka kryetar bashkie që do të thoshte të kundërtën, sepse unë besoj se çdo njeri që ka qenë atje, e nje terrenin, dhe aq më shumë kontaktet me banorët, e di shumë mirë që sa më e shpejtë të jetë përgjigjja, sa më në kohë të jetë përgjigjja kundrejt qytetarit, është ajo që ne të gjithë duam dhe, mbi të gjitha, qytetarët kërkojnë. Por, duhet të

jemi të kujdesshëm kur flasim për mënyrën se si ne duhet të krijojmë një qasje, që të jetë e qëndrueshme në kohë. Këtu përsëri ka shumë modele, që mund të merren në konsideratë.

Unë me shumë respekt po mundohem të jem shumë i kujdesshëm, për të mos mbajtur një qëndrim. Do të ishte jonjerëzore nëse unë nuk do të kisha një preferencë si ish- kryetar bashkie, qoftë edhe si Ervin, por unë këtu jam si ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor. Besoj se edhe kjo marrëdhënie bashkëpunimi, që ne duhet të kemi me njëri- tjetrin, duhet të bazohet në atë që ne mund të ofrojmë si ministri dhe rrugën që do të ndiqni si komision.

Jam i bindur që do të vijë koha dhe momenti gjatë këtij rrugëtimi që secili prej nesh do të ketë një qasje shumë herë më të definuar për sa i përket produktit final. Ky nuk është momenti, sepse ju vetë e thatë, ky është takimi i parë që ne po bëjmë.

Nëse ne do të kishim zgjidhje në tavolinë sot, për çfarë do të ishin takimet që ju i keni shumë intensive në vazhdim.

Arbjan Mazniku - Zoti Haxhinasto.

Edmond Haxhinasto - Faleminderit!

Faleminderit, zoti ministër, për prezencën e gjatë në komision! Sigurisht, rëndësia e kësaj reforme është e domosdoshme.

Në fakt, është e vështirë të flasësh i fundit, sepse detyrimisht do të përsërisësh disa nga shqetësimet. Unë që në fillim të këtij komisioni kam menduar se mënyra më solide për të vlerësuar atë që është bërë dhe ato që do të bëhet në të ardhmen, është që të vendosim një sërë kriteresh, të cilat do të na udhëzonin se ku do të shkonim.

Nuk mjafton vetëm të kemi kritere, por është e rëndësishme që kritereve t'u japim edhe një rend prioritar, do të thotë cilat nga kriteret janë më të rëndësishme për ne në fazën aktuale të zhvillimit që kalon vendi. Në gjykimin tim, mendoj se çështja e shpopullimit të vendit është një emergjencë kombëtare dhe një kriter, i cili duhet të ishte në krye të listës së çdo veprimi që do të ndërmerrem. Fakti është që disa nga kriteret flasin me shifra, disa nga kriteret flasin me racionalitet, me qëllime të mira. Për shembull, çështja e shpopullimit është një realitet që flet me shifra, zbrazja e vendit është një realitet që nuk ka nevojë ta komentojmë apo të mbajmë qëndrime të ndryshme. Kështu që, edhe për këtë reformë, nëse ne do të arrijmë, përmes asaj që duam të bëjmë, të mbajmë njerëzit në territor, unë mendoj se është një themel i rëndësishëm.

Fakti që reforma e vitit 2015 nuk arriti ta bënte këtë, është një tregues që duhet të reflektojmë për atë reformë dhe ta riparojmë. Një nga çështjet e rëndësishme është ajo e distancave, që u përmend këtu, apo distanca nga shërbimi. Pa diskutim Shqipëria nuk është një vend fushor, 2/3- at është malor, ka thyerje në strukturën e territorit, kështu që mendoj se është shumë e rëndësishme që kjo të merret në konsideratë. Vende shumë më të përparuara se ne dhe

më të pasura se ne, si Zvicra, për shembull, i subvencionojnë që të rrinë në territor. Ne as në aspektin e shërbimeve dhe të organizmit, që e kemi në dorë ta bëjmë, nuk arrijmë dot ta bëjmë këtë gjë. Kështu që, është shumë e rëndësishme që ne të arrijmë t'i angazhojmë njerëzit qoftë për zhvillimin vendor, qoftë kombëtar, nëse arrijmë të krijojmë zhvillim të qëndrueshëm në zona të caktuara.

Struktura jonë nuk është strukturë e një industrie intensive, që kërkon krahë pune të kualifikuar në industri dhe rrjedhimisht i drejton njerëzit drejt qendrave urbane. Jo, ne kemi strukturë tjetër të zhvillimit ekonomik, që është turizmi, bujqësia, ku ruhet edhe unikaliteti kulturor, tradicional, si kontribut ekonomik. Prandaj, teza e ekonomisë së shkallës nuk është ajo që ka relevancë dhe nuk është ajo që është prioritar, mendoj unë. Pra, duke njohur problemet, mendoj se gjejmë dhe zgjidhjet, dhe duke injoruar problemet, nuk mund t'i gjejmë zgjidhjet.

Pra, qëllimi i reformës përcakton edhe modelin që ne duhet të bëjmë, si e thashë, prioritet duhet t'i vendosim sipas radhës së rëndësisë së tyre. Unë mendoj që edhe qëndrimi elektoral është një nga motivimet. Për këtë nuk mund të fshihemi prapa gishtit. pa diskutim.

Edhe ajo, zoti ministër, që ju e pranuat në performancën e administratës vendore, që thate se ka rritje, por mund të jetë ulje si përqindje e GDP-së në buxhet, është e vërtetë, sepse është rritur GDP-ja, por pagat nuk janë rritur aq shumë si përqindje të rritjes, pra fondi i pagave, ndërkohë që numri i të punësuarve vendor është rritur në mënyrë të jashtëzakonshme, dhe nuk mund ta mohojmë që është bërë edhe për qëllime elektorale. Ndërkohë që performanca nuk është rritur. Kam raste pafund, në dijeninë time personale, që njerëzit futen në punë dhe vetëm të marrin pagë. Ka raste që njerëzit futen në punë, marrin gjysmë page. Pse? Për të qenë të angazhuar për qëllime elektorale. Ky është një realitet që e them me përgjegjësi.

Ju vërtet, zoti ministër, nuk konkluduat një model siç e mendoni ju, as me më shumë bashki, as më me më pak, por konkluzionet që ishin arritur për performancën ishin shumë të qarta, ishte e zeza mbi të bardhën, që bashkitë më të mëdha performojnë më mirë. Pra, ky është një paragjykim për këtë reformë, është një qëndrim që ju mbani. Ndërkohë që ju vetë na dhatë një shembull, që e hodhët poshtë konkluzionin që ishte paraqitur.

Unë jam dakord me konkluzionin tuaj, në fakt. Konkluzioni juaj ishte që kur ka kapacitete menaxheriale cilësore, bëhet një ndryshim, dhe ju dhatë shembullin e Beratit, të cilin edhe unë e mbështes. Çfarë tregon kjo? Kjo tregon që kur ka kapacitete vendore, shërbimet rriten në cilësi, performanca e tyre rritet, patjetër, dhe i shërbehet komunitetit. Komuniteti identifikohet me atë lokalitet ku jeton, lidhet më shumë me të, performon më mirë ekonomikisht dhe nuk e ka mendjen për të shpëpulluar vendin.

Tani, unë mendoj se po të kishte qenë ky prioritet që nga viti 2015, mund të ishin bërë disa përpjekje serioze për të rritur kapacitetet vendore. Kështu dëgjova një shprehje këtu, që pushteti vendor ka kompetenca, por nuk i ushtron dot. Mendoj se barriera kryesore është ajo e burimeve njerëzore. Kështu që, në qoftë se do të kishte qenë prioritet, dhe po u rikthehem prioritetëve që përmenda në fillim, mënyra se si i trajton problemet dhe nëse trajtimi i tyre vendoset në mënyrë prioritare, gjatë 12 vjetëve mund të ishte investuar pa këto kapacitete. Kjo është diçka e përgjithshme. Fatkeqësisht, këto kapacitete janë lënë pas dore dhe, për pasojë, ka ardhur centralizimi i kompetencave. Nuk është vetëm trendi i pushtetit vendor, është e përgjithshme, shihen edhe institucionet, sepse edhe institucionet qendrore i humbasin kompetencat, shkojnë drejt nivelit superqendror, drejt Kryeministrisë apo institucioneve të varura nga Kryeministri. Arsytet dihen, vendimmarrja centralizohet; mund të jetë e vërtetë se kapacitetet nuk ekzistojnë, mund të jetë e vërtetë se njerëzit me vlera dhe kapacitetet e mirëfillta largohen nga vendi, por mendoj se këtu qëndron thelbi i problemit. Në qoftë se ne duam vërtet t'u shërbejmë njerëzve, t'i mbajmë njerëzit në territor dhe të rrisim cilësinë e shërbimeve, kjo është një sfidë e madhe me rritjen e kapaciteteve të tyre për t'u shërbyer njerëzve, por ky duhet të jetë qëllimi i reformës, sepse, nëse ky nuk është qëllimi i reformës, në qoftë se njerëzit do të shihen me matrica, ku u rrit, ku ul e të tjera, nuk mendoj se do ta arrijmë.

Zoti ministër, ju kërkoj ndjesë që nuk bëra shumë pyetje, por këtë koment e bëra mbi bazën e të gjitha përgjigjeve që u dhanë dhe të pyetjeve që bënë kolegët para meje!

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Zoti ministër, fjala për ju.

Ervin Demo – Faleminderit, zoti Haxhinasto!

Unë nuk kam komentuar qëndrimet. Jam dakord që disa prej prioritetëve janë ato që ju renditët dhe besoj se ato ndahen nga komisioni, por, patjetër, edhe nga ne. Mendoj se krijimi i kushteve të duhura në territor, për të krijuar modele të qëndrueshme, është absolutisht rruga për të zgjidhur shumë problematika të tjera. Që kjo të ndodhë, ne duhet të krijojmë institucione që kanë qëndrueshmëri dhe kapacitetet e duhura. Se cila është rruga, do ta eksplorojmë së bashku.

Në fillim të fjalës, ju përmenda se si ishte transformuar qeverisja vendore gjatë pothuajse 100 vjetëve, që në kohën e vilajeteve, me prefekturat, me bashkitë, me rrethet, me qarqet dhe më pas me reformën e vitit 2015. Besoj se secila prej tyre, përveçse ka pasur arsye, ka pasur edhe mësim të nxjerra nga një reformë te një tjetër. Këtë po jua them me shumë sinqeritet, sepse besoj se ka shumë mësim për të nxjerrë nga reforma e vitit 2015 dhe do të ishte anormale nëse ne nuk do ta prananim, sepse unë besoj se çdo gjë që është bërë apo që ne

bëjmë ka vend për përmirësim. Se cila është rruga dhe qasja sa u përket përmirësimeve që ne mund t'i bëjmë reformës së vitit 2015, patjetër, këtu mund të ketë modele dhe qasje të ndryshme, kjo është për t'u eksploruar në vazhdim, aq më tepër kur ne duhet t'i dëgjojmë të gjithë aktorët që janë të përfshirë dhe që preken nga reforma, duke filluar nga qytetari, por edhe institucionet e përfshira, bashkitë, qarqet e të tjera me radhë.

Mendoj se këtë proces duhet ta çojmë përpara bashkërisht. Nuk dua të ndalem sa u përket limitimeve kohore apo, le të themi, një lloj kalendari që duhet ndjekur, sepse ai i takon komisionit, por ju garantoj se, si ministri, ne do të bëjmë çfarë është e mundur që ta lehtësojmë punën e komisionit dhe, pse jo, të kemi produktin më të mirë të mundshëm, i cili jam i bindur se nuk do të jetë perfekt, sepse asnjëherë nuk ka reformë perfekte.

Faleminderit!

Luçiano Boçi – Zoti Likaj, fjala për ju.

Ramadan Likaj – Zoti ministër, ju kam bërë një pyetje, por nuk mora përgjigje.

Ervin Demo – Përderisa nuk po shprehem për reformën, nuk do të shprehem as për rajonet, por patjetër që rajonet janë një ndër gjërat që mund të diskutohen. Nuk dua të mbaj një qëndrim. Ka alternativa të ndryshme që mund të merren në konsideratë, dhe rajonet mund të jenë një ndër to, por sa mund të jenë dhe se si mund të jenë, ku mund të vendosen dhe sa nivele do të jenë, kjo është shumë e gjerë për t'u eksploruar, ndaj besoj se do të ishte shumë sipërfaqësore po të jepja përgjigje me një numër.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Fjala për zonjën Tabaku, për një ndërhyrje.

Jorida Tabaku – Zoti ministër, dua të di, nëse është e mundur, prezantimi juaj është ky?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po pati mundësi, te *slide*-i i fundit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në të gjithë diskutimin që u bë këtu (edhe pse ju nuk donit të mbanit një qëndrim, e keni mbajtur këtu), thatë se të gjitha të dhënat sigurojnë që duhet një konsolidim territorial, standarde të njëjta dhe efikasitet, sikur po flasim për prodhim makinash! Mendoj se ne kemi nevojë për një sërë të dhënash, nga ato që ju propozuat këtu, për t'i parë në nivel njësisish administrative. Po patët mundësi ta bëni këtë, do të na ndihmonit, sepse informacioni që ju keni nuk i ka në nivel njësisish administrative, por në nivel bashkish, dhe unë, por edhe kolegët e mi të opozitës do të donim të bënim një analizë që na çon në rezultatet dhe në konkluzionet tona, jo në atë që na keni sjellë ju. E para.

E dyta, ju dëgjova me shumë interes sa i përket eficiencës dhe diskutimeve në lidhje me kapacitetet e bashkive. Për shembull, sot Bashkia e Shkodrës i ka zbatuar investimet e veta në 35% (po flas për vitin që u mbyll). Çfarë do të thotë kjo, që duhet ta mbyllim Bashkinë e Shkodrës se nuk kanë kapacitete?!

Dëgjuam disa raste, nga ato që ju përmendët këtu, për bashki të vogla dhe të mëdha, që janë apo nuk janë eficiente. Ka bashki të vogla, që janë shembull shumë i mirë, pra nuk ka rëndësi numri i banorëve, por modeli që ato kanë ndërtuar, komunikimi me qytetarët dhe përfaqësimi i demokracisë lokale në secilën prej tyre. Nga eksperiencia ime, por edhe ju duhet ta dini, ka bashki të vogla që i kanë përthithur fondet e BE-së më mirë sesa bashkitë e mëdha, për shembull, Bashkia e Mirditës, Bashkia e Kavajës dhe Bashkia e Përmetit, pra edhe me përkatësi të ndryshme politike.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Por ndoshta është rast që këta të PD-së qenkan pak më të aftë për t'i përthithur fondet e BE-së.

Mendoj se ne kemi nevojë për një set të dhënash, që të kemi, nuk po them konkluzione të njëjta, por që të na ndihmojnë të arrijmë në konkluzione. Kjo është një kërkesë edhe për zotin kryetar.

Zoti kryetar, besoj se ju deri më sot keni mbledhur informacione, por unë, si anëtare e këtij komisioni, nuk kam asnjë informacion për komunikimet që keni pasur si komision. Mendoj se të gjithë komisionit duhet t'i vendoset e njëjta bazë të dhënash, së pari, bashkëkryetarit dhe të gjithë kolegëve këtu, që gjithsecili të flasë me të njëjtin informacion. Ne përdorim informacionet e INSTAT-it dhe të qeverisë, nuk përdorim bazë tjetër të dhënash, sepse nuk i prodhojmë dot vetë, edhe po të duam. Besoj se jemi në fazën ku do të konsolidojmë raportin e gjetjeve, por, përpara kësaj, shpresoj që qeveria shqiptare të na sjellë të dhënat që ne kërkojmë, që të bëjmë krahasime me bazë të njëjtë, se nuk themi dot që e ka bërë më mirë Tirana se Shkodra (unë nuk e di se çfarë keni me Benetin, për shembull, sepse me Erionin e di çfarë keni), që edhe ne ta dimë dhe të krahasojmë të njëjtin informacion në të njëjtin nivel administrativ, sepse nuk e krahasojmë dot Tiranën me Shkodrën, dhe të përpiqemi të kemi të njëjtat konkluzione si komision, sepse mua do të më duket shumë keq që t'i ndajmë rrugët që tani, pra që te gjetjet, pasi nuk e kemi filluar ende analizën.

Një sërë informacionesh dhe pyetjesh që iu ngritën ministrit këtu, nuk kanë ato konkluzione që nxori ministri. Nuk e di se nga doli konkluzioni se duhet konsolidim territori, ku duhen standarde të njëjta apo rritje kapacitetesh. "Rritje kapacitetesh" është një shprehje e përhershme. Për shembull, mund t'ju jap disa shembuj nga përthithja e fondeve të BE-së, ku

ka disa bashki që e kanë 50%; (zoti Mziu nuk është këtu) Kamza ka qenë ndër më të mirat, e ka pasur 90% historikisht, pavarësisht kryetarit të bashkisë. Për aplikimin për fondet, po i referohem IPA II, meqenëse po flisni për Kapitullin 22.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Besoj se të gjithë kemi nevojë të kemi të njëjtën bazë të dhënash, sepse ndodhemi në fazën në të cilën mund të fillojmë ta unifikojmë bazën e të dhënave, pa arritur në konkluzione.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Kam një koment të shkurtër.

Së pari, dua të falënderoj ministrin për kohën, për dedikimin dhe për të gjithë prezantimin!

Mund t'ju them se, nga biseda që kam bërë paraprakisht me ministrin, ai ka gatishmërinë maksimale për të lehtësuar jo vetëm mbledhjen e të dhënave që ka vetë ministria, por edhe për të lehtësuar komisionin në mbledhjen e të dhënave që sektorë të tjerë të qeverisë mund të kenë, pra për të qenë një portë përmes së cilës mund të mbledhim të dhënat, ato që janë në linja specifike.

Do t'ju kisha sugjeruar, për çështje praktikiteti, që grupet e ekspertëve, të cilat tashmë janë të strukturuar dhe kanë filluar punën (secili prej grupeve të mbledhet sipas tri temave kryesore që kemi), të na listojnë tipologjinë e dokumenteve dhe informacionet që duan të mbledhin, dhe ne më pas, me gjithë dakordësinë e bashkëkryetarit, të çojmë kërkesat specifike për të dhënat formalisht, që t'i marrin ato më pas. Diskutimi i përgjithshëm: duam të dhëna, na çon më pas te diskutimi se cilën të dhënë duam. Në qoftë se grupi i ekspertëve apo i financës na thonë: këto janë të dhënat që duam në këtë rend dhe për këto vite duam këtë tipologji të dhënash; grupi i funksioneve thotë: duam këto; grupi i territorit na thotë: duam këto të dhëna, secili prej grupeve të na listojë të dhënat dhe ne më pas t'ua përcjellim për anën procedurale ministrit ose drejtpërdrejt institucioneve respektive, si INSTAT-it, që janë institucione autonome, apo institucioneve të tjera, në mënyrë që të sigurojmë që komisioni t'i ketë të dhënat dhe të funksionojë me një koncept dhe një logjikë të dhënash, sepse ky ishte një problem që faktikisht e hasëm sot. Unë nuk kam dashur të ndërhyj për çështjet e etikës së komunikimit, se besoj shumë fort që do të ishte shumë e shëndetshme që ne të krijojmë një etikë ku secili prej njerëzve që ka diçka për të thënë, ta thotë atë deri në fund, pavarësisht nëse unë bie dakord apo jo, dhe më pas të kemi mundësi ta bëjmë diskutimin në mënyrë civile. Sot janë cituar të dhëna që janë plotësisht të pasakta, por nuk po i hyj diskutimit, sepse pastaj nuk i dalim dot në fund. Secili prej nesh ka të drejtën të dëgjojë të dhënat. Unë besoj që ne mund të kemi opinione të ndryshme, por s'duhet të kemi fakte të ndryshme, faktet duhet t'i kemi njësoj. Opinionet mbi

faktet mund t'i kemi ndryshe dhe është shumë legjitime t'i kemi ndryshe, por faktet duhet t'i kemi njësoj.

Në këtë kuadër, unë besoj shumë te proceset. Nëse ndërtojmë procese të shëndetshme, mund të dalim në konkluzione të dakordësuara ose të paktën të mirëkuptuara. Në këtë moment kemi kaluar nga faza e parë e diskutimit. Për t'ia kujtuar edhe publikut që na ndjek, ramë dakord që të fillojmë dëgjesat. Kërkuam që dëgjesën e parë ta bëjmë me ministrin, i cili mori të gjithë kohën e nevojshme për të qenë këtu dhe, në fakt, për fat të keq, më shumë për të na dëgjuar sesa për të na thënë, sepse morëm një kohë të jashtëzakonshme për të thënë opinionet tona, që mund t'i kishim thënë gjatë muajve në vijim, që do të kemi kohë për të punuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, e di, e di, por e kam thjesht shqetësim parimor për publikun dhe për ekonomi kohe, por ky është diskutim tjetër.

Së dyti, kemi ngritur grupet e punës, të cilët janë në punë, që është prapë një hap tjetër i rëndësishëm, dhe mendoj që tani ka ardhur momenti që grupet të fillojnë të sjellin produkt, dhe pa dyshim produkti i parë është mbledhja e të dhënave, analizimi i këtyre të dhënave dhe më pas të bëjmë një diskutim specifik.

Luçiano Boçi - Zoti Bozdo, apo keni ndërhyrje?

Jorida Tabaku - Unë i referohesha kalendarit të punës, në fakt, dhe ne duhet të kishim përfunduar mbledhjen e të dhënave në muajin shkurt. Duke qenë se sekretari është përfaqësues i palës suaj, kisha menduar që ishte kryer kjo fazë. Edhe sipas informacionit që keni ndarë, ne duhet të kishim vlerësuar kornizën ligjore, parimet, analizën e të dhënave, sfidat, gjetjet e reformës së parë.

Arbjan Mazniku - Ajo agjendë ishte kur ju duhet të vinit në komision tre muajt e parë, por kur nuk erdhët, ajo agjendë ka rënë.

Jorida Tabaku - Jo, kjo ishte pasi erdhëm ne në komision, kur u miratua.

Arbjan Mazniku - Po të kishit qenë tre muajt e parë në komision, do të kishim qenë shumë përpara këtu. Kështu që, nëse do t'i hyjmë diskutimit te kërkesa e llogarisë për afatet kohore, po mos të kishim humbur tre muaj kohë me mosprezencë sistematike të opozitës, do të kishim bërë shumë punë. E para kjo.

E dyta, edhe pasi ramë dakord, ramë dakord për një agjendë dhe më pas u mbledhëm pas dy muajsh, se jam treguar tej mase i mirëkuptueshëm në çdo hap. Ne ndamë një dokument, ramë dakord për një dokument, e votuam dokumentin dhe pas dy mbledhjesh doli që se kishin lexuar një pjesë e madhe e komisionit dhe donit ta bënim nga fillimi. Ramë përsëri dakord që ta ribëjmë nga fillimi. Por ama sa herë që opozita ka një shqetësim dhe do që të ndërrojmë

agjendën, nuk mund të themi pse nuk u bënë ato hapat e të shkuarës. Nuk u bënë se opozita nuk ra dakord që të bëjmë takimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, pra, edhe të dhënat. Edhe të dhënat janë pjesë e të njëjtit proces, sepse në qoftë se nuk ndodh hapi, s'ka si të vijë të dhënat. Të dhënat nuk do të gjenerohen në asnjë moment, nuk do vijë nga eteri dhe të fanepsen në komision, por duhet të kishim bërë një seri hapash, siç ishte mbledhja e komisionit, miratimi nga ana e komisionit e grupit të ekspertëve, miratimi nga Byroja e grupit të ekspertëve dhe të fillonin punë ekspertët. Të gjithë i duam të dhënat, por nuk do të fanepsen në një moment të caktuar as në dosjet tona as në *inbox*-et tona. Do të duhet dikush që të kërkojë një të dhënë specifike, ta mbledhë, ta analizojë e të na e sjellë. Për këtë punë i kemi ekspertët. Arsyeja pse s'ka ndodhur kjo është se opozita ka munguar tre muaj në punë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Meqë po kërkohej llogari, këtë po them.

Luçiano Boçi - Dakord, se u zgjat shumë ky argument, zoti Mazniku, por për hir të së vërtetës, ka një gjë: që mbledhja e të dhënave do të bëhej nga ekspertët. Në fakt, miratimi i ekspertëve, pavarësisht qëndrimit të opozitës, u bë me vonesë nga Byroja, se këtë gjë e kemi insistuar në mbledhjen e parë.

Arbjan Mazniku - U bë një javë me vonesë nga Byroja, pasi u vonua katër muaj nga opozita.

Luçiano Boçi - Tani fjalën e ka zoti Bozdo, që të mos futemi në të tilla gjëra.

Enno Bozdo - Zoti Ministër, kam një ndërhyrje të shkurtër, por besoj të rëndësishme, që ka lidhje me zhvillimin rajonal.

Shumë i rëndësishëm koncepti, shumë të rëndësishme edhe detyrimet që ka Shqipëria, sipas kapitullit 22, në procesin e integritimit. Në vitin 2022 është miratuar një ligj shumë i rëndësishëm, ligji "Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin". Ligji ka lënë disa detyra, pothuajse prej katër vitesh tashmë, të cilat kanë qenë të domosdoshme për t'u ndjekur, në mënyrë që edhe Shqipëria të futej në konceptin e zhvillimit rajonal të balancuar, me fokusin tek ulja e pabarazisë midis rajoneve. Shumë e ndjeshme për Shqipërinë kjo, veçanërisht rajoni i veriut kundrejt dy rajoneve të tjera, të qendrës dhe të jugut.

VKM-të diktonin ngritjen, në mos gaboj, të komitetit rajonal të zhvillimeve, që do të menaxhonte edhe fondet që jepte Bashkimi Europian dhe qeveria shqiptare për ulje të pabarazisë, por detyronte pastaj edhe ngritjen e bordeve rajonalë, me detyrë monitoruese për

të kuptuar cilat ishin prioritetet, financimin e prioriteteve dhe avancimin drejt këtyre prioriteteve.

Në dijeni time, qofsha unë i gabuar, VKM nuk ka. Pra, ligji është miratuar në vitin 2022 dhe nuk ka asnjë akt tjetër nënligjor që e bën këtë ligj të zbatueshëm, ndërkohë që ne e kemi të detyrueshme të ecim në këtë politikë. Dhe kam përshtypjen se kemi humbur katër vjet kohë të mira. Për më tepër, mund të kemi humbur dhe shanset për të barazuar pak edhe zhvillimin e rajoneve, veçanërisht kur shikon se si është katandisur veriu, jo vetëm në fushë financimi, por edhe me zbrazjen njerëzore. Kështu që, a mund të më jepni një shpjegim pse ka ndodhur kjo, por nëse nuk më jepni dot shpjegim, se e kuptoj që nuk është përgjegjësia juaj personale, dua të di çfarë do ndodhë me këtë gjë, do të rrëzohet ky ligj, do të kemi një ligj tjetër, do të ecim në mënyrë tjetër apo çfarë do ndodhë? Kjo më intereson.

Ervin Demo – Faleminderit, zoti Bozdo!

Edhe një herë do të doja të nënvizoja faktin që ne do të vëmë në dispozicion të punës së komisionit jo vetëm informacionet që disponon ministria, por do të mundohemi në të njëjtën kohë që të grumbullojmë të dhëna të tjera, që mbase komisionit do t'i duhen në një moment të caktuar. Por deri në këtë moment nuk kemi asnjë kërkesë specifike për informacion, që të jemi korrekt.

Ndërkohë, zoti Bozdo, që të jem i sigurtë, patjetër, jam në dijeni të ligjit që ju përmendët. Është e vërtetë që nuk ka gjetur zbatim të plotë tani që flasim, por, të lutem, edhe një herë, unë besoj që në këtë moment që ne jemi, qoftë në negociatat që kemi për kapitullin 22, por patjetër edhe për reformën territoriale, duhen parë dhe analizuar të dyja në mënyrë të kujdesshme, për të pasur një qëndrim shumë herë më të qëndrueshëm edhe se si do jetë qasja që do kemi ne si vend për sa u përket fondeve të kohezionit, aq më tepër pastaj zhvillimit rajonal.

Luçiano Boçi – Faleminderit!

Zoti Ministër, në hyrje të fjalës sime, unë përcaktova që reforma territoriale nuk është një çështje thjesht teknike, ajo lidhet në radhë të parë me përfaqësimin e qytetarit, si përfaqësohet ai në pushtetin lokal, si shërbehet ai, si arrihen diferencat apo distancat midis bashkive, si realizohet autonomia vendore. Dhe, në fakt, për të parë nëse një reformë ka dështuar apo është e suksesshme, nuk mund të nisemi thjesht nga parametrat teknikë, financiarë, treguesish, sepse dëgjohen argumente që përplasen me njëra-tjetrën. Në qoftë se e nisim nga ky thelb, atëherë dalim në konkluzionin, përndryshe nga sa e thatë ju, që kjo reformë e vitit 2015 ka dështuar.

Unë kërkoja të di mbi çfarë analizë është shtyrë qeveria apo edhe Parlamenti të ndër marrin një reformë tjetër territoriale. Në qoftë se ne themi që ishte e suksesshme, atëherë me disa modifikime të karakterit të ndërhyrjes ligjore kjo reformë mund të çohet përpara, apo jo, por në qoftë se themi që ajo ka dështuar, atëherë duhet ta pranojmë që ka dështuar. Këtu kemi një ndërhyrje politike, në fakt, e cila ka përcaktuar që dështimi nuk është për shkak të keqkeqverisjes, është për shkak të arkitekturës. Në fakt, është lojë fjalësh, sepse për cilën arkitekturë bëhet fjalë: arkitekturën e territorit, arkitekturën e kompetencave, arkitekturën e funksioneve, arkitekturën financiare, sepse këto, përveç territorit, varen nga mënyra si sillet pushteti qendror në raport me pushtetin lokal? Në qoftë se pushtetit qendror i merr funksionet, i merr kompetencat, i merr financat, autonominë, i merr qeverisjen, atëherë si mos të themi ne që është pasojë e keqkeqverisjes. Prandaj them është lojë fjalësh, tautologji, dhe pak me filozofi.

Ekspertët tanë kanë bërë një analizë ligjore shumë të qartë dhe shumë të saktë. Në Shqipëri ka një ligj thelbësor, organik, për pushtetin vendor, është edhe bashkëkohor, madje reforma e vitit 2015 u atashoi 42 funksione autoriteteve vendore, bashkive, që ishin të mjaftueshme. Por ç'ndodhi pastaj në vazhdimësinë e këtyre ligjeve? Dolën ligje të tjera, të cilat binin ndesh me ligjin themelor, të cilët unë i kam listuar (i kanë listuar specialistët, në fakt); është ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", ligji nr. 93/2015 "Për turizmin", ligji nr. 55/2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 24/17 "Për administrimin e ujitjes dhe kullimit", ligji nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura", ligji nr. 57/2020 "Për pyjet", ligji nr. 107 "Për bashkëqeverisjen", ligji nr. 29/2024 "Për burimet ujore. Ja ku është një pjesë e madhe e keqkeqverisjes, e përplasjes dhe e marrjes së kompetencave të pushtetit vendor nga pushteti qendror. Në qoftë se do të ishte e suksesshme, qeveria do të mjaftohej që ta hiqte këtë përplasje ligjore, ta modifikonte, me shumicën e votave që ka në Parlament, të gjithë kornizën ligjore që bie ndesh dhe të realizonte harmonizimin midis pushtetit lokal dhe pushtetit qendror. Nuk shikoj asnjë arsye që të kemi një reformë territoriale, sepse është në kompetencën e qeverisë. Kush e pengoi qeverinë tuaj për 13 vjet që t'i bënte këto ndërhyrje, që kompetencat t'i kishte pushteti vendor?! Kush e pengoi që funksionet t'i kishte të plota pushteti vendor?! Kush e pengoi që pushteti vendor të kishte autonomi financiare?! Askush nuk e ka penguar, gjë që mund ta bëjë edhe tani, por ne duhet të gjejmë arsyen e vërtetë. Sigurisht, ka dështim dhe lidhet me atë nëse përfaqësohet sot qytetari shqiptar në pushtetin vendor aktual. Siç e tha zoti Dule, i cili morri shembullin e Paskuqanit, nuk është vetëm ajo zonë, ka plot zona në Shqipëri, që kanë qenë pjesë e njësive administrative, komuna të dikurshme, që sot nuk kanë përfaqësuesin e tyre politik të atij niveli që duhet ta kenë.

Që do të thotë: sot qytetari nuk ka një derë, ku të trokasë që të shfaqë problematikën e tij dhe jo më të marrë shërbimin që i takon, nuk i shkon as në mendje. Pra, kjo mungesë e këtij përfaqësimi e ka shkëputur hallkën e lidhjes së shërbimit dhe llogaridhënies, sepse ne e harrojmë llogaridhënien, por ajo na mban të drejtë si politikanë, si drejtues vendorë, si deputetë. Në qoftë se shkëput llogaridhënien, lidhjen e ngushtë me qytetarin, atëherë abuzimi me pushtetin është për inerci, i vazhdueshëm.

A është shërbyer qytetari?! E drejtova si pyetje në fillim, sepse në këto konkluzione duhet të dalim për të parë se sa e suksesshme ishte reforma. Jo, nuk është shërbyer qytetari, sepse Shqipëria ka njohur shpopullimin më të madh përgjatë këtyre viteve.

Në fakt, kam marrë një mesazh nga një qytetar, të cilin e kam lexuar në një takim, dhe nuk do të doja të kaloja në përsëritje, por jam habitur nga saktësia dhe mënyra se si e ka ndërtuar, sepse shpesh, për t'u treguar të ditur, u referohemi figurave politike dhe i citojmë ato, por ky është qytetar i thjeshtë dhe, midis të tjerave, shkruante: “Shqipëria po zbrazet, jo gradualisht, por me shpejtësi alarmante, po zbrazet jashtë kufijve, por më keq akoma po zbrazet brenda vetes. Zona të tëra janë shndërruar në territore pa zë, pa shërbime, pa shpresë dhe kjo nuk është fatkeqësi natyrore, është produkt i vendimeve politike. Ndërtimi i reformës territoriale mbi parimin e thjeshtë të numrit të popullsisë dhe efikasitetit financiar ka prodhuar pasoja shkatërrimtare: largim institucionesh, humbje shërbimesh, izolim territorial dhe në fund braktisje të plotë. Pushteti largohet qytetari largohet dhe, kur qytetari largohet, territori vdes. Nëse kjo logjikë vazhdon, nesër nuk do të mbetemi vetëm pa popullsi, por do të mbetemi pa histori, pa toponime të gjalla, pa trashëgimi, pa kujtesë kolektive; territore që kanë mbajtur peshën e shtetit dhe kombit do të kthehen në harta bosh.”. Nuk ka alarm më të saktë të thënë nga origjinaliteti i mendimit të një qytetari, jashtë performancës së gjuhës sonë politike. Kjo është kambanë alarmi për të gjithë ne që jemi këtu për të bërë një reformë territoriale. A do t'i kthehen shërbimet këtij qytetari, që të mos largohet?

Meqenëse jemi në ligjërimin e thjeshtë, rastësisht, siç ulemi ne deputetë që jemi në komisione, një përfaqësues i së majtës dha një arsye shumë të bukur: kam ardhur në Tiranë nga X zonë, për një arsye shumë të thjeshtë, për arsimim. Babai dëshironte të më arsimonte në Tiranë, sepse cilësia e arsimit është më e lart se në vendet e tjera, pra për cilësinë. Po sot ky qytetar, që nuk shërbehet në arsim, në shëndetësi, në shërbime sociale, çfarë do të bëjë? Pse duhet të vazhdoj të rrijë atje? Largimet e shumta, të imigrimit dhe emigrimit, janë për këto arsye, sepse asnjë prind nuk dëshiron që fëmija e tij të jetë në klasë kolektive; nuk dëshiron që shkolla të jetë larg, sepse ai ka dëshirë shumë të madhe që ta arsimojë, asnjë nuk dëshiron që të mos ketë shërbim shëndetësor dhe të udhëtojë me mjete të ndryshme, ndonjëherë edhe të

pamenduara, për të arritur qendrën më të afërt shëndetësore apo spitalore, ndaj them se duhet të fokusohemi në këtë pjesë.

Pra, kemi shpopullim jo si trend global, por për arsye të keqqeverisjes vendore, ka edhe arsye të tjera, këtë nuk mund ta mohojmë, por ky është një nga faktorët kryesorë.

Zoti Sokoli ka paraqitur një hartë të shpopullimit dhe, nëse bëjmë një raport, qartazi, sipas të dhënave të INSTAT-it, shpopullimi është më i madh në Veri sesa në Jug. Në Veri kemi më pak bashki, pra është gjysma e territorit të Shqipërisë, bashkitë janë me territor më të madh; shërbimet janë më të vështira për t'u dhënë dhe shpopullimi është më i madh. Pra, dashur, pa dashur, dolëm tek ai modeli, sepse këtu po luajmë pak edhe kukafshehtas që nuk duhet të flasim për model, jo duhet të flasim për model. Ju tashmë keni folur për model dhe e keni edhe në materialin tuaj, konsolidim territorial, që do të thotë: zmadhim i bashkive, sepse ashtu përkthehet. Në grupin tuaj parlamentar janë hedhur 4 variante, për të cilat ka dijeni edhe publiku. Pse të mos flasim për modele, kush tha? Keni folur ju dhe e keni përcaktuar modelin, i cili është zvogëlimi i numrit të bashkive. Janë tri variante dhe varianti i fundit është ruajtja e numrit të bashkive aktuale, pra nuk lejoni asnjë opSION tjetër, që ka të bëjë me argumentet, të cilat u paraqitën këtu në mënyrë teknike, financiare dhe politike. Të gjitha argumentet që parashtron opozita, të gjitha argumente që jepen, të gjitha faktet që paraqiten, shkojnë në favor të asaj që po themi: bashkitë duhet të jenë më të vogla, në numër banorësh, dhe duhet të ofrojnë shërbime bazike themelore, më pas duke shtuar performancën financiare, siç e tha zoti Haxhinasto, pra nuk është e nevojshme që çdo bashki të jetë ndërmarrje rentabël, ajo mund të subvencionohet, sepse ka karakteristika identitare, kulturore që duhen ruajtur si të tilla dhe duhen mbrojtur. Ky model i hedhur nga ju, patjetër që ka edhe përgjigjen e ndryshme, jo të kundërt domosdoshmërisht. Ne kërkojmë qartazi një model që i shërben qytetarit, përfaqëson qytetarin, nuk rrit diskriminimin. Pse nuk pranohet që kemi diskriminim të bashkive?! Bashki që nuk kanë kompetenca, nuk kanë nivel ekonomik, nuk kanë as shërbime, ndërkohë kemi bashki të tjera që janë të favorizuar me investime, me mbështetje qeveritare, kanë resurset e tyre dhe sot kemi një diferencë shumë të madhe të zhvillimit ekonomik në gjithë Shqipërinë, jo vetëm të përqendrimit të popullsisë në 5 apo 6 bashki! 1/3-ta e popullsisë jeton në Tiranë, që është bashki më vete, dhe kjo ka krijuar diskriminim që dikur qytetarët e shprehnin në mënyrë shumë inteligjente: ndryshonin targat e makinave. Për shembull, qytetari nga Lushnja e merrte targën e makinës sikur ishte nga Tirana, ndërkohë sot nuk është me targë makine, por me zhvendosje, ikin nga territoret e tyre, ikin nga vendet që kanë jetuar për shekuj e shekuj, vetëm për arsye të mungesës së këtyre shërbimeve.

Pra, një pushtet vendor që të ketë thelb dhe kuptim, patjetër që duhet të ofrojë shërbime, sigurisht që duhet të ketë edhe elemente të tjera, si kompetenca, funksionaliteti që e bëjnë një pushtet vendor të tillë. Përpos parashtrimeve, kam edhe disa pyetje reale, që lidhen me pasojat që unë i përmenda.

Në fakt, duhet të durojmë, sepse ne kemi disfavorin që duhet të flasim në fund, pasi i durojmë të gjithë pa lëvizur, ndaj mendoj se, moralisht, kam të drejtë të bëj edhe disa pyetje.

Reforma e vitit 2015 pretendon se bashkitë e reja me kapacitet më të madh administrativ dhe financiar do të shërbenin si magnet për zhvillimin e komuniteteve rurale. Si shpjegohet fakti që 10 vjet pas kësaj reforme, 55 nga 61 bashki, pra 90% e territorit, regjistruan një rënie të popullsisë, sipas censit të vitit 2023?

Reforma krijoi bashki, ku komunitetet periferike ndodhen 2, 3 orë larg qendrës bashkiake, pa transport publik funksional, a nuk ishte parashikimi i aksesueshmërisë territoriale një kusht minimal i reformës sipas standardeve europiane? Kam evolucionin e zvogëlimit apo zmadhimit të njësive administrative në shtete të ndryshme, të cilave ju referuat edhe ju. Sigurisht, ju i referoheni shpesh si model suksesi Suedisë. Suedia nga viti 1990 ka një rritje shumë të lehtë të numrit të njësive administrativ. Në vitin 2014 e ka rritur, por nuk është ky argument. Argumenti është largësia, sepse është shumë e rëndësishme që të kesh akses në kohë të caktuar. Standardi europian është 60 minuta, ndërkohë që argumentohet qartazi që ky standard në Shqipëri nuk është 60 minuta, pak bashki e kanë 60 minuta, por është 90 minuta, ose 2 orë, sidomos në ato bashki që kanë karakteristika malore specifike, që nuk janë pak në territorin e Shqipërisë.

Qeveria pretendoi se bashkitë e mëdha do të ndalonin migracionin e brendshëm dhe do të krijonin zhvillim lokal. Pse sot 52% e popullsisë shqiptare jeton vetëm në 7 bashki: Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Fier, Kamzë dhe Vorë, ndërkohë që 54 bashki të tjera marrin vetëm 48%? A nuk dëshmon kjo një dështim të potë të objektivit të zhvillimit të balancuar territorial? Për shembull, Bashkia e Dibrës, meqenëse është dhe Xhelali, ka 12 njësi administrative dhe kohë udhëtimi 2-3 orë, që e ngrita si shqetësim, nga periferitë drejt Peshkopisë (edhe Xhelali e ngriti këtë gjë). Bashkia e Kukësit ka njësi administrative periferike mbi 90 minuta larg. A nuk janë këto dy bashki prova e hartë se reforma u hartua mbi hartën politike dhe jo mbi hartën e aksesit dhe të shërbimeve? Realiteti është ky. Po ashtu, bashki, si Shkodra, Tropoja, Elbasani, Malësia e Madhe kanë të njëjtat problematika, rreth 40% e komuniteteve periferike janë në këtë distancë mbi 60 minuta larg. Nëse realizohet konsolidimi territorial, nëse bashkitë bëhen më të mëdha sesa janë, si do të mundet të shkurtohet kjo distancë e arritjes së qendrave të bashkive, kur bashkimi i bashkive dhe krijimi i bashkive të mëdha, do ta rriste edhe disafish

largësinë e shërbimit të këtyre qytetarëve? Si do të zgjidhet ky problem, se flasim në këtë rast për shërbime, jo vetëm për çështje teknike?

Reforma e vitit 2014 bashkoi komuna të vogla malore nën bashki të mëdha, duke argumentuar efikasitetin administrativ, por studimi i Bankës Botërore për Shqipërinë tregon se aksesimi ndaj shërbimeve është faktor i dytë pas punësimit, që nxit emigracionin në zonat rurale. Duke i shkëputur komunat periferike nga qendrat e tyre historike të shërbimit dhe duke i vendosur 60-180 minuta larg qendrës së re bashkiake, reforma nuk shkurtoi distancat, por i rriti ato. A ka qenë vetë reforma faktor kontribuues në mënyrë të drejtpërdrejtë i këtij shpopullimi që përmenda pak më parë?

Reforma e vitit 2014 propozoi qendra shërbimi të integruara, si zgjidhje për distancat, sepse kjo është gjetur si zgjidhje teorike. 10 vjet më vonë, sa qendra shërbimi funksionale ekzistojnë në njësitë administrative periferike malore? A ka, apo nuk ekzistojnë fare? Nëse qeveria nuk ka financuar as stafin minimal, as pajisjet, as lokalet, a nuk janë këto qendra vetëm fasadë burokratike, ndërkohë që qytetarët e largët nuk marrin asnjë shërbim real?

Qeveria qendrore në vitin 2014 transferoi kompetencën e ujësjellës-kanalizimeve te bashkitë e reja, por pa transferuar burimet financiare adekuate, ndërkohë në vitin 2022, në kundërshtim me ligjin “Për vetëqeverisjen vendore” shërbimi i ujësjellës-kanalizimeve u qendërzua nën kompetencën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, duke formuar shoqëri aksionere të ujësjellës-kanalizimeve në nivel qarku. A nuk është kjo dëshmi e një decentralizimi të mangët, transferim të detyrave, pa transferim të mjeteve dhe më pas përsëri qendërzim i shërbimit të këtij sektori, sikurse edhe sektorët e tjerë (i referohem këtu ligjit të fundit “Për mbetjet” që krijon një centralizim të këtij shërbimi), duke ua hequr si të drejtë dhe si kompetencë bashkive dhe pushtetit lokal?

KLSH-ja zbuloi se Bashkia e Durrësit shpenzon 15 mijë e 300 lekë për ton mbetjesh, 3 herë më shumë se Shkodra, që e ka 5 mijë e 207 lekë dhe 30% e buxhetit total të bashkisë shkon vetëm për mbetjet, kur rekomandohet që ky nivel duhet të jetë 3-15%. Kjo kosto e paarsyeshme u krijua drejtpërdrejt nga mbyllja e landfillit të Porto Romanos, vendim qeveritar, pra e kam fjalën se si ndërhyr qeveria me vendimet e saj. Si justifikohet fakti që një vendim qendror të shkatërrojë buxhetin e bashkisë, pa një kompensim financiar?

Për çështjen e arsimit: këtu u tha edhe nga parafolësit që nga viti 2012 janë mbyllur 295 shkolla 9-vjeçare publike, gati 22% e totalit të shkollave në rang kombëtar, numri i nxënësve ka rënë me 30% nga 370 mijë në 267 mijë. Nëse bashkitë e reja supozoheshin të ishin administratoret më të mirë të arsimit lokal, pse ritmi i mbylljes së shkollave nuk u ul pas vitit 2014, por u rrit, u intensifikua?

Reforma e vitit 2014 premtoi se bashkitë e mëdha do të menaxhonin më mirë infrastrukturën shkollore, por sot bashkitë nuk kanë as buxhet për ngrohje dhe as për mirëmbajtje themelore. Si shpjegohet që arsimi parauniversitar financohet me vetëm 3% të buxhetit kundrejt 4%-5% të normës europiane dhe reformës iu dha vetëm strukturë burokratike, pa investime reale, që sot bashkitë e vuajnë, dhe në drejtim të shërbimit që është themelor, që e përcaktova si një nga arsyet kryesore dhe të shpopullimit?

Për çështjet e autonomisë fiskale folën kolegët e mi dhe nuk dua ta përsëris zonjën Tabaku, meqenëse padurimi ka arritur nivele të tilla që duket edhe në qëndrim.

Zoti ministër, mund të më jepni përgjigje për të gjitha pyetjet që parashtrova.

Faleminderit!

Ervin Demo – Faleminderit, zoti Boçi!

Besoj se patëm një përmbledhje të të gjitha pyetjeve që bëmë gjatë ditës së sotme. Jam munduar t'i mbaj shënim.

Të lutem, më korrigjo, nëse më ka shpëtuar ndonjë gjë, sepse besoj që disa pyetje janë edhe për vetë komisionin që duhet t'i trajtojë në vazhdimësi, se do të ishte e tepërt të kisha përgjigje për të gjitha këto!

Si shpjegohet fakti që në 55 bashki ka rënie të popullsisë? Do të më duhet ta nënvizoj faktin se do të ishte e tepër që, për sa u përket ndryshimeve demografike, reforma territoriale të jetë arsyeja. Nëse i referohemi rajonit, nuk dua të zgjatem shumë, por ne kemi një fenomen të tillë në të gjithë rajonin e Ballkanit. Besoj se do të ishte një analizë shumë sipërfaqësore të themi që vetëm reforma sjell impakte në territor.

Për sa i përket pyetjes që u krijuan bashki me 2-3 orë largësi nga qendra, gjatë këtyre 10 vjetëve, të jem i sigurtë, ne kemi pasur përmirësime të dukshme në infrastrukturë dhe lidhje të zonave të thella me qendrat e bashkive. Gjithsesi, do të na duhet ta hartëzojmë të gjithë territorin për të parë se si janë të ndara njësitë administrative dhe largësia, që kanë me qendrat e bashkive. Fakt është që në territor sot zonat janë shumë herë më të komunikueshme brenda territorit të një bashkie, dhe kjo vjen si rrjedhojë e përmirësimit të infrastrukturës.

Për sa i përket imigrimit të brendshëm, ju përmendët që gati gjysma e popullsisë është e përqendruar në 7 bashki, duke filluar me Bashkinë e Tiranës. Në fakt, përqendrimi i popullsisë në qendra të mëdha urbane, nuk është një problem, fenomen shqiptar. Nëse u referohemi jo vetëm rajonit, por edhe më gjerë, edhe vendeve të Bashkimit European qendrat urbane, gjatë gjithë, të paktën dekadave të fundit, kanë marrë një peshë specifike më të madhe, si rrjedhojë e përqendrimit të numrit të popullsisë, por, duke thënë këtë, absolutisht jam dakord dhe me atë që tha zoti Bozdo pak më parë që ne duhet të jemi të kujdesshëm për sa u përket politikave

rajonale, për të krijuar një kohezion më të qartë në territor. Kjo është shumë e rëndësishme edhe për sa i përket qasjes që duhet të kemi për reformën territoriale.

Për sa u përket ujësjellës-kanalizimeve, e përmenda edhe pak më parë që reforma e fundit e uli numrin e ndërmarrjeve ose sh.a-ve të ujësjellësve në 15, përgjithësisht të përqendruara në nivel qarku, ku bashkitë vazhdojnë të jenë pjesë e këtyre ndërmarrjeve, duke pasur përqindjet e tyre të kontrollit në bordet përkatëse.

Për sa i përket Bashkisë së Durrësit që 30% e buxhetit shkon për mbetjet, do të më duhet ta verifikoj këtë të dhënë, të jem i sigurtë, nëse është e saktë apo jo. Bashkia Durrësit ka pasur një specifikë të caktuar për sa i përket transferimit të mbetjeve nga Durrësi në Sharrë.

Për sa i përket arsimit, u përmendën që rreth 200 shkolla janë mbyllur, në mos gaboje, zoti Boçi? Dakord.

Unë e përmenda edhe pak më parë, ne kemi ndryshime demografike në territor..

Luçiano Boçi – Ministër, të bëj një ndërhyrje?

Nuk i kam pyetje të karakterit teknik, sepse po i parashtroni sikur unë ju kam pyetur: pse ka ndodhur ky fenomen dhe a keni informacion për këtë fenomen. Pyetja ime është në raport me suksesin apo dështimin e reformës, pra këto janë pasoja dhe unë dua të shpjegosh pasojën në raport me dështimin e reformës së vitit 2014, jo duke verifikuar: ka ndodhur kjo, sepse është trend apo është fenomen europian.

Ervin Demo - Të lutem, është e rëndësishme që ne të kuptojmë arsyet, do të ishte shumë sipërfaqësore që ne çdo gjë që ka ndodhur të themi: reforma, reforma, reforma. Nëse do një përgjigje gjysmëpolitike, patjetër, mund t'ju jap. Unë tentova gjatë gjithë kohës sot të bazohesha, sepse bashkëpunimi do të vazhdojë, vetëm tek të dhënat që ne disponojmë si ministri. Nëse doni që unë të bëj njëllorjasje politike për sa i përket edhe reformës së vitit 2014, por, mbi të gjitha, edhe çfarë ishte para saj, ne e dimë që në territor kemi pasur kryetar komunash, që rrinin me vulë në xhep në Tiranë dhe nuk rrinin në territor. Domethënë, ai fragmentizimi i territorit që ne po themi... Ne po bëjmë sikur erdhëm nga një situatë si në Zvicër dhe e prishëm me reformën territoriale të vitit 2015. Të jemi me këmbë në tokë dhe të vërtetë me njëri-tjetrin. Unë nuk dua t'i futem retorikës politike, ndaj tentova të mos mbaj qëndrim politik, nuk dua t'i hyj asaj rruge, por një gjë dua ta them: reforma territoriale e vitit 2015 e konsolidoi qasjen që ne kemi me territorin. Duke marrë parasysh sot gjendjen që kemi në territor, si dhe duke iu referuar fenomeneve që ne kishim para vitit 2014, unë besoj se ajo, në fakt, ka mitiguar disa risqe, që do të ishin edhe më të mëdha nëse nuk do të kishim reformën e vitit 2015...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, nuk po e bëjmë për debat. Më kërkua një qëndrim dhe po të jap një qëndrim.

Luçiano Boçi - Sepse më thatë edhe çështjen e kryetarit me vulën në xhep, që vinte në Tiranë dhe nuk shërbente...

Ervin Demo - Hera e parë që unë fillova të jap një mendim, ju nuk më lini ta jap.

Luçiano Boçi - Për ballafaqim, zoti ministër...

Ervin Demo – Ballafaqim nuk bëjmë dot, sepse këtu u përmendën të dhëna që ishin totalisht të gabuara dhe unë nuk bëra ballafaqim.

Luçiano Boçi - Janë 40 kryetarë apo ish-kryetarë bashkish që sot hetohen për korrupsion.

Ervin Demo – Çfarë lidhje ka kjo?

Luçiano Boçi – Ka lidhje me atë që thatë ju, që ai vinte me vulë, që nuk shërben dhe e ka mendjen të marrin interesat e tyre.

Ervin Demo – Nuk e kuptova lidhjen, por unë di të them edhe që në këtë tavolinë unë nuk e përcaktova përkatësitë politike...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Arbjan Mazniku – Folëm sa deshëm, tani ta lëmë ta mbarojë fjalinë!

Ervin Demo - Në këtë tavolinë, me sa shoh unë, janë 5 ish-kryetarë bashkie dhe 3 ish-nënkryetarë, që i bie që mazhoranca këtu vjen nga qeverisja vendore. Unë jam i bindur që të gjithë ne e dimë shumë mirë se cilat kanë qenë problematikat në territor, pavarësisht se një pjesë e mirë kanë qenë kryetarë bashkish të mëdha, përfshirë Tiranën apo bashki qendër-qarku. Unë kam një qëndrim shumë të thjeshtë: ne mund të mbajmë konsiderata politike, por edhe personale, madje mund ta vazhdojmë diskutimin me orë të tëra, sepse jam i bindur që secili nga ne e ka të kristalizuar qëndrimin dhe qasjen e tij, por doja të nënvijëzoja që, duke qenë se është dëgjesa e parë në komision, ne kemi gatishmërinë si ministri, mbi të gjitha, për t'ju vënë juve në dispozicion informacionet e domosdoshme, që do t'ju shërbejnë për të vazhduar më pas me të gjitha hapat që keni për të ndjekur, jo vetëm informacionet që ne, si ministri, disponojmë, por mund të krijojmë një ndërveprim proaktiv për të ndërtuar një databazë me të gjitha të dhënat që ju duhen nga cilado ministri apo institucion tjetër, që ju gjykoni se i bën mirë procesit që duhet të ndiqni.

Për sa i përket vazhdimësisë së punës së komisionit, unë jam shumë i gatshëm të vij përsëri në momentin që komisioni do të ketë pyetje të tjera apo ka kristalizuar ndonjë model apo cilat modele do të diskutohen. Unë nuk besoj se kjo është hera e parë dhe e fundit. Në të njëjtën kohë, jam gatshëm që edhe me anëtarët e komisionit të bëjmë mbledhje jashtë tryezës

së komisionit për të diskutuar elemente më teknike, mbase në një kohë edhe më të gjatë, për të trajtuar, zoti Haxhinasto e përmendi në fillim, prioritetet që duhet të ketë komisioni i posaçëm.

Faleminderit!

Luçiano Boçi – Jam dakord me gatishmërinë tuaj për të ardhur në një moment tjetër dhe për të ndjekur procesin, por po shpreh përsëri shqetësimin tim: ky poçes nuk mund të jetë i mbyllur, si, le të themi, një favor i qeverisë për të marrë vendime apo proces i paracaktuar politikisht. Duhet patjetër që konkluzioni të ndjekë procesin, por të ndjekë edhe modelet, të mos shmangemi nga modelet.

Po, zoti Nallbati.

Bledjon Nallbati – Nuk po e gjejmë dot, kemi kaç kohë që po i vijmë vërdallë të tërës. Shpopullimi masiv i Shqipërisë, duam apo nuk duam ne, doni apo nuk doni ju, ka ndodhur në këta 10 vjet me ritme të frikshme.

E thanë në fillim që e ka fajin qeverisja, ju thatë jo, sepse Shqipëria po zhvillohet, ekonomia po ecën. Nuk e ka fajin ajo. Pastaj thamë mos e ka fajin reforma dhe t'ua lehtësonim pak qeverisë, Kryeministrit, por ju as këtë nuk e pranoni. Atëherë, kush e ka fajin? Pse nuk ikin shqiptarët masivisht 10 vjet më parë, por ktheheshin nga vendet e Bashkimit Europian për të investuar në Shqipëri, si fermerë, blegtorë, bujq? Pse kanë ikur në këta 10 vjet, a keni një përgjigje për këtë? Ose e ka reforma, ose e ka Edi Rama, ose e ka mënyra e qeverisjes. Nuk besoj se e ka Saliu prapë, sepse është në opozitë prej 13 vjetësh, ose na thoni që e ka fajin Saliu dhe ta flemë mendjen, se nuk po e gjejmë dot. Pranoni një gjë more! Këtë jo, atë jo, reforma ka shkëlqyer, qeveria ka shkëlqyer, ndërkohë shqiptarët rrëmbejnë opingat në dorë, nuk i veshin fare, dhe ikin, zhduken, kurse ju po të njëjtin avaz. Na jepni një përgjigje, more burrë!

Arbjan Mazniku – Duke besuar se pjesa më e madhe e problemeve u diskutuan, duke vlerësuar edhe gatishmërinë e ministrit, unë mendoj se kjo dëgjese e parë është një ogur i mirë, veçanërisht me ministrin në nivel personal, nga eksperiencia që ka, me të cilin, edhe nga ana institucionale, kemi një marrëdhënie që nuk është tipike, si me çdo institucion tjetër, por është institucioni kryesor partner yni, si komision, në qeveri për të ndërvepruar për të dhënat, për analizat, për vlerësimet dhe për diskutimet.

Besoj se do të kemi një seri takimesh të tjera, jo vetëm si takime të formatit të dëgjese, por dhe takime pune teknike, ku kanë mundësi të flasim edhe grupet e ekspertëve. Jam i bindur se do të kemi një kohë të gjatë që t'u japim përgjigje një sërë pyetjesh, që kanë vlerë të diskutohen nga shumë këndvështrime.

Po tentoj shumë fort që ta mbaj këtë diskutim pa shkuar në linja politike, sepse do të kemi momente kur do ta bëjmë atë diskutim politik. Por jam dakord me argumentin që nuk bën

fare sens, besoj se qytetarët janë të qartë, që po tentojmë të krijojmë një reminishencë të një të shkuare a thua se njerëzve, në një moment të caktuar, nëpër komuna u shkonin shërbimet, u riparoheshin shkollat, u pastroheshin kanalet kulluese dhe vaditëse apo u bëheshin rrugë. Kjo është absolutisht e pavërtetë, nuk ka asnjë të dhënë teke, që tregon se një shërbim, si, për shembull, pastrim të kanaleve kulluese dhe vaditëse, apo mirëmbajtje shkollash, çerdhesh, kopshtesh, riparim rrugësh, ndërtim rrugësh të reja, pastrim dhe përpunim mbetjesh, nuk ka qenë më mirë para vitit 2014, asnjë tek. A jemi përpara nevojës që të shohim si t’i përmirësojmë shërbimet? Pa dyshim që po. E bëra këtë pyetje meqë patëm një fjalim emocional pak më parë, ku vetë parafolësi në mbledhjen e kaluar tha: “Unë nuk dua të kthehem te 373-i”, 373-i nuk bën sens...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, e the, sepse e kemi te minutat the: “Devolli nuk duhet të ishte 5, por duhet të ishte 2”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ma thuaj prapë!

Ti e njeh zonën tënde shumë mirë, pyetja që kam është: sa duhet të ishte Devolli, sipas teje?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

3? Pra më pak se 5, që ishte.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nëse të njëjtin rregull e aplikojmë gjithandej nga 373-i do të zbresim. Le të fillojmë me këtë një herë! Thelbi është të biem dakord të gjithë që kemi qenë në rrugën e duhur, tani këtë do ta ndajmë në kategori dhe në numra.

Unë kam vetëm një kërkesë të fundit para se ta mbyll: do t’i kërkoja grupit të ekspertëve që të ndërveprojnë dhe të bashkëpunojnë dhe, sipas grupeve specifike, të bëjnë listën me informacione, që do të na duhet të kërkojmë nga institucionet përkatëse, sepse prapë mendoj se ne duhet dhe do të kemi opinione të ndryshme, por duhet të kemi fakte të njëjta.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA